

**PERMBAJTJA**

Hyrje.....	fq.4
<b>KAPITULLI I</b> Prioritetet e Vitit 2023.....	fq.5
<b>KAPITULLI II</b> Buxheti i Bashkisë Patos për Vitin 2023.....	fq.7
II.1 Të Ardhurat e Bashkisë Patos për vitin 2023.....	fq.10
II.2 Transfertat e Pakushtezuar 2023.....	fq.37
II.3 Transferta e pakushtëzuar sektoriale 2023.....	fq.37
II.4 Burime të tjera financimi .....	fq.39
II.5 Transfertë e kushtëzuar.....	fq.41
<b>KAPITULLI III</b> Parashikimi i shpenzimeve për vitin 2023.....	fq.41
<b>KAPITULLI IV</b> Programet e Zhvillimit të Qytetit .....	fq.49
<b>1.Programi i Menaxhimi i Mbetjeve (A.SH.P ) .....</b>	fq.49
2.Programi i Sherbimet Publike Vendore (A.SH.P).....	fq.53
<b>3.Programi Rrugë Rurale( A.SH.P ).....</b>	fq.61
4.Programi Shërbimet Rekreative dhe Sportive.....	fq.62
5.Programi i Administratës Vendore .....	fq.65
6.Shërbimet e Policisë Vendore.....	fq.70
7.Programi Sherbimet Sociale dhe Kujdesi Parësor.....	fq.73
8.Programi Përkujdesi Social.....	fq.74
9.Programi Strehimi Social.....	fq.78
10.Programi Arsimi dhe Shërbimet Kulturore.....	fq.80
11.Programi Arsimi Bazë dhe Parashkollar.....	fq.87
12.Programi Arsimi i Mesëm Parauniversitar.....	fq.91
13.Programi i Bujqësisë, Blegtorisë.....	fq.94
<b>14.Programi i Menaxhimit të Mbetjeve , Mbrojtës se Mjedisit Bashkia .....</b>	fq.97
15.Programi Administrim Pyje.....	fq.104
16.Programi i Ujitje Kullim.....	fq.106
<b>17.Programi Rrugë Rurale Bashkia.....</b>	fq.108
18.Programi Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime.....	fq.124
19.Programi i Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile.....	fq.125
Lista Prioritare Objekteve te Investimeve .....	fq.127

## TABELAT DHE GRAFIKËT

Tabela nr.1 Të ardhurat sipas burimeve.....	fq.8
Tabela nr.2 Planifikimi i buxhetit sipas klasifikimit funksional.....	fq.8
Tabela nr.3 Realizimi i të ardhurave për vitin 2022 sipas buxhetit.....	fq.12
Tabela nr.4 Parashikimi i të ardhurave për taksën e ndërtesës për vitin 2023.....	fq.15
Grafiku nr.1 Taksa e Ndërtesës.....	fq.15
Tabela nr.5 Toka bujqësore sipas zyrës kadastrës Njësia Administrative Patos.....	fq.17
Tabela nr.6 Toka bujqësore sipas zyrës kadastrës Njësia Administrative Zharëz.....	fq.17
Tabela nr.7 Toka bujqësore sipas zyrës kadastrës Njësia Administrative Ruzhdie.....	fq.18
Grafiku nr.2 Paraqitja grafike e Taksës së Tokës Bujqësore.....	fq.19
Tabela nr.8 Të ardhura nga Taksa e Truallit.....	fq.20
Grafiku nr.3 Taksa mbi Truallin.....	fq.20
Tabela nr.9 Të ardhura nga Taksa e Rregjistrimit.....	fq.21
Grafiku nr.4 Taksa e Rregjistrimit të Mjeteve.....	fq.22
Grafiku nr.5 Taksa e Tabelës.....	fq.23
Tabela nr.10 Taksa e Tregut.....	fq.24
Grafiku nr.6 Taksa e Tregut.....	fq.24
Grafiku nr.7 Taksa e Rentës Minerare.....	fq.26
Tabela nr.11 Të ardhurat nga tarifat e transporti dhe çertifikat mjeti dhe autorizimet.....	fq.27
Grafiku nr.8 Të ardhurat nga liçënsimi i mjeteve dhe autorizim për tregtim karburanti.....	fq.28
Grafiku nr.9 Të ardhurat nga nga tarifa e parkimit të mjeteve.....	fq.28
Tabela nr.12 Tarifa e Pastrimit për Familjet.....	fq.29
Tabela nr.13 Tarifa për Shërbimin Komunitar.....	fq.30
Tabela nr.14 Tarifa e Pastrimit për Biznesin.....	fq.31
Grafiku nr.10 Tarifa e Pastrimit.....	fq.31
Tabela nr.15 Tarifa e Ndotjes së Mjedisit.....	fq.32
Grafiku nr.11 Tarifa e Ndotjes së Mjedisit.....	fq.32
Tabela nr.16 Tarifa e Gjelbërimit dhe Ndriçimit.....	fq.33
Grafiku nr.12 Tarifa e Gjelbërimit dhe Ndriçimit.....	fq.33
Tabela nr.17 Tarifa e tjera.....	fq.34
Tabela nr.18 Tabela e të Ardhurave.....	fq.35
Tabela nr.19 Transferta e pakushtëuar 2022 dhe 2023.....	fq.37
Grafiku nr.13 Transferta e pakushtëuar 2022 dhe 2023.....	fq.37
Tabela nr.20 Transferta e pakushtëuar sektoriale 2022 dhe 2023.....	fq.38
Tabela nr.21 Pasqyra e pwmledhwse me projekteve me financim nga Donatorë 2022-2024.....	fq.40
Tabela nr.22 Planifikimi i buxhetit 2023 sipas klasifikimit ekonomik.....	fq.43
Tabela nr.23 Tabela e shpenzimeve për investimeve 2023 krahasuar me vitin 2022.....	fq.44
Tabela nr.24 Shpenzimet korente sipas programeve.....	fq.46
Tabela nr.25 Shpenzimet e personelit.....	fq.47
Tabela nr.26 Totali i shpenzimeve të Bashkisë Patos.....	fq.48
Tabela Lista Prioritare Objekteve te Investimeve .....	fq.127

## ***Hyrje***

Buxheti i vitit 2023 është hartuar në fryshtën e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 si dhe të Planit të Investimeve Kapitale.

Buxheti i vitit 2023 është hartuar duke ruajtur traditën e krijuar tashmë dhe duke marrë në konsideratë të gjithë mekanizmat e buxhetimit me pjesëmarje siç janë, përcaktim i qartë i objektivave sektoriale, vendosje e prioriteteve mbështetur në nevojat dhe kërkesat që vijnë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët si dhe mbajtja në nivele optimale e raportit kosto/rezultat duke u mbështetur në kosto reale të ofrimit të shërbimeve.

## ***Zëri i qytetarëve në hartimin e buxhetit 2023.***

Dhe gjatë këtij viti qytetarët u përfshinë në procesin e hartimit të buxhetit, mendimi dhe propozimet qytetare në lidhje me punën e ndjekur nga Bashkia Patos na shërbjen si bazë e mirë për hartimin e buxhetit.

Opinionet, propozimet e qytetarëve janë marrë gjatë kontakteve të drejtpërdrejta me ta, degjesës publike të zhvilluara në Pallatin e Kulturës Patos dhe në njësitë Administrative. Ato janë marrë edhe nëpërmjet komenteve, kritikave e kërkesave të adresuara pranë administratës së Bashkisë Patos dhe institucioneve të vartësisë të cilat janë publikuar në faqën zyrtare të Bashkisë në internet. Gjithashtu nëpërmjet faqes së internetit të bashkisë janë zhvilluar anketa lidhur me buxhetin dhe çfarë prioritetesh kanë qytetarët, ku duan te investohet më shumë etj.

Buxheti i vitit 2023, instrument i përpjekjeve vendore për të bërrë realitet të prekshëm

## **VIZIONIN:**

Qeverisje vendore e hapur, e drejtë dhe e përgjegjshme ndaj nevojave të komunitetit, sigurimi që të gjithë njerëzit të trajtohen në mënyrë të barabartë, me dinjitet dhe respekt, të lirë nga diskriminimi si parim bazë për ndryshime pozitive, orientim per zhvillimin e ardhshëm bashkëjetesën e industrisë me bujqësinë, duke rritur cilësinë e jetës.

## **KAPITULLI I**

### **PRIORITET PËR VITIN 2023**

#### **1- Zhvillim Urban**

- *Përmirësimi i aksesit rrugor.*
- *Zhvillimi i zonave periferike të qytetit.*
- *Krijimi i hapsirave publike dhe të gjelbëruara në qendër dhe periferi.*

#### **2- Zhvillim Social –Ekonomik**

- *Mbështetja e biznesit me politika fiskale për hapjen e vendeve të reja të punës.*
- *Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore.*
- *Mbështetja për krijimin e tregjeve rjonale për shitje.*

#### **3- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi**

- *Menaxhimi i mbetjeve urbane*
- *Menaxhimi i gjelbërimit të qytetit*
- *Eleminimin e ndotjes nga ujrat e zeza*
- *Mbështetje për rehabilitimin e shesheve nga facilitetet e abandonuara të industrisë së naftës ndër vite.*

#### **4- Zhvillimi i infrastrukturës dhe shërbimeve**

- *Mbështetje për rehabilitimin dhe krijimin e infrastrukturës së ujit*
- *Ndërtimi dhe mirëmbajtja e kanaleve të ujrave të zeza*
- *Mirëmbajtja urbane*
- *Ndërtim të një tregu bujqësor*
- *Ndërryrjen në sisitemin e kullimit, vadirjet, sistemimin e rrugëve të parcelave,*
- *Shtimin e sipërfaqeve të pyjeve nepërmjet mbjelljes së sipërfaqeve të zhveshura*
- *Garantimin e shërbimit zjarrëfikës ne nivel lokal dhe administrimi i strukturave përkatëse.*

#### **5- Zhvillimi i filialeve bujqësore e blegtorelle**

- *Përmirësimi i infrastrukturës së ujites*
- *Organizimi i grupeve të prodhimit bujqësor e blektoral, industrial dhe ofrimit të shërbimeve.*
- *Mbështetje e biznesit e fermereve për promovimin e produkteve bujqësore e blegtorelle të zonës.*
- *Mbështetja e bashkëpunimit ndërmjet sektorit turistik dhe sektorit bujqësor e blegtoral.*
- *Paketa fiskale për thithjen e investitorëve të rendësishëm dhe punëdhënësve të mëdhenj, për zhvillimin e filialeve apo tregjeve bujqësore.*

## ***ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË***

*Në zhvillimin e ardhshëm të territorit janë përcaktuar 3 drejtime kryesore të zhvillimit.*

- *Zhvillimi ekonomik*
- *Strukturimi dhe gjallërimi i vendbanimeve*
- *Aspektet kulturore, rekreative, sportive dhe ambientale*

*Këto drejtime përkojnë me disa objektiva strategjike:*

### *A. Zhvillimi ekonomik*

***Objktivi 1*** *Një ekonomi e balancuar që krijon vende punë të kualifikuara dhe një mjedis tëpërshtatshëm për zhvillimin e sektorit primar, industrisë dhe shërbimeve.*

***Objktivi 2*** *Pushteti vendor bashkëpunues dhe transparent, nxitës i zhvillimit ekonomik me anë të politikave fiskale, nismave, promovimit dhe marketingut.*

### *B. Strukturimi dhe gjallërimi i vendbanimeve*

***Objktivi 1.*** *Lagje dhe fshatra që sigurojnë një mjedis të sigurtë, mundësi ndërveprimi social dheshërbime të orientuara drejt mirëqenies së banorëve*

***Objktivi 2.*** *Sigurimi i një varieteti tipologjish strehimi për të gjitha nivelet e të ardhurave, në të gjithë territorin, ofrimi i një larmie alternativash në zgjedhjen e mënyrës të jetesës dhe vendbanimit si përgjigje e ndryshimeve demografike.*

***Objktivi 3.*** *Sigurimi i një rrjeti transporti dhe mobiliteti të sigurtë, të aksesueshëm, të qendrueshëm.*

***Objktivi 4.*** *Sigurimi i rrjeteve dhe struktura inxhinjerike që sigurojnë një ambient të shëndetshëm duke ulur impaktin mjedisor.*

### *C. Aspektet kulturore, rekreative, sportive dhe Mjedisore*

***Objktivi 1.*** *Ruajtja dhe rivlerësimi i elementeve të trashigimisë që janë themelë e qytetërimit dhe konfirmojnë të shkuarën.*

***Objktivi 2.*** *Ruajtja e mjedisit natyror duke e integruar në aspektet argëtuese dhe sportive, me anë të krijuimit të aksosit dhe mundësive për argëtim dhe shijim të natyrës.*

***Objktivi 3.*** *Integrimi i elementeve natyrore dhe kulturorë në jetën kulturore dhe artistike të bashkisë për të promovuar më tej territorin.*

## **KAPITULLI II**

### **BUXHETI I BASHKISË PATOS PËR VITIN 2023**

Hartimi i Buxhetit për vitin 2023, vijon në rrugën e nisur të të qenit pjesë e Programit Buxhetor Afatmesëm, me një përfshirje të gjitha institucioneve të vartësisë së Bashkisë në këtë proces. Bashkia Patos ka respektuar të gjitha kërkesat ligjore për hartimin dhe paraqitjen në Këshillin Bashiak të të gjithë dokumentave strategjikë dhe buxhetorë, duke ndjekur të gjitha hapat dhe afatet e përcaktuara në ligj, për të siguruar një proces të plotë buxhetor.

Buxheti i vitit 2023 do të ketë në konsideratë:

- Reflektimin e politikave fiskale të aplikuara gjatë vitit 2023 dhe ndikimin e tyre në përbushjen e objektivave,
- Alokimin e të ardhurave për vitet në vazhdim,
- Prioritizimin e shpenzimeve kapitale sipas programeve të zhvillimit të qytetit,
- Realizimin e shpenzimeve për përbushjen e funksioneve.

Programi finansiar për vitin 2023 bazohet në analizën e kostove të programeve dhe shërbimeve shoqëruar me preventivat përkates në vite dhe në objektivin përritjen e standardeve dhe cilësisë së tyre.

Teknikat e përdorura për hartimin e buxhtit janë:

- Përgatitja e buxhetit bazuar në programe. Kjo formë kërkon një klasifikim të ri të aktiviteteve (detyrave);
- Përgatitja e buxhetit të balancuar. Kjo formë detyron formulimin e qartë të prioriteteve në çdo nivel organizativ.

***Buxhetit i vitit 2023*** konkretizon dhe konsolidon në terma financiare hapat e ndërmarrë për zbatimin e politikave të mbajtjes të pandryshuar dhe te shkuarjes drejt uljes së shpenzimeve administrative dhe të personelit në funksion të rritjes së investimeve dhe shpenzimeve përfunkcionet bazë për përbushjen e kërkesave dhe prioriteteve të qytetarëve.

Bashkisë Patos për vitin 2023 parashikon të përdorë për të gjitha funksionet **543,737,000** lekë, nga **505,762,000** lekë qe ka qenë në vitin 2022 me një rritje në masën **37,975,000** lekë ose 7 % më shumë.

Tabela e mëposhtme paraqet të Ardhurat nga burimet e veta sipas çdo burimi, dhe peshën specifike për çdo burim ndaj totalit.

**Të Ardhurat e Veta për Buxhetin 2023**

**Tabela nr.1** Të ardhurat sipas burimeve. në lekë

Nr	Emërtimi I Burimeve	Vlera	Pesha specifike ne %
1	Te Ardhurat Lokale	287,999,000	53%
2	Transferta e pakushtezuar	154,219,000	28%
3	Transferta Specifike	101,519,000	19%
		<b>543,737,000</b>	<b>100%</b>

Tabela e mëposhtme paraqet planifikimin e buxhetit sipas klasifikimit funksional. **Tabela nr.2**

**Tabela nr.2**

Nr	Programi	Planifikimi i buxhetit sipas klsifikimit funksional	Total 2023
1	Administrata Vendore	Funksioni i administratës vendore	89,206,785
	Administrata Vendore	Publikim i broshurave informative, krijimit te portaleve me profil ekonomik etj.	1,155,000
	Administrata Vendore	Mbeshtetja per zhvillimin e binzesit te vogel nepermjet veprimatrive nxite se , te tilla si panaire e reklama ne vende publike	300,000
2	Sherbimet e Policise Vendore	Planifikimi, adminsitrimi dhe kontrolli I territorit sipas menyres se percaktuar me ligj	4,076,000
3	Rruge Rurale Bashkia	Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.	81,438,518
4	Furnizimi me Uje dhe Kanalizime	Prodhimi, trajtimi, transmertimi dhe furnizimi me uje te pijshem.	454,000
5	Bujqesia	Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj., sipas mënyrës së percaktuar me ligj.	9,750,089
6	Mjedisi Menaxhimi i Mbetjeve Bashkia	Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja	1,218,796
7	Pyjet	Administrimin e fondit pyjor dhe kulloso publik, sipas legjisacionit në fuqi.	3,845,809

	Arsim Kultura	Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe promovimi i identitetit kombtar dhe lokal si dhe administrimi i objekteve qe lidhen me ushtrimin e ketyre funksioneve	20,139,836
	Arsim Kultura	Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i bibliotekave dhe ambienteve per lexim me qellim edukimin e per gjithshem te qytetareve	3,500,000
	Arsim Kultura	Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave dhe trashegimise kulturore me interes lokal si dhe administrimi i objekteve qe lidhen me ushtrimin e ketyre funksioneve.	1,800,000
8	Arsim Kultura	Zhvillimi i turizmit	1,947,600
	Arsim Kultura	Programet/projektet rinore	100,000
9	Menaxhimi i Mbetjeve ASHP	Mbledhja , largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane	41,167,487
	Sherbimet Publike Vendore	Ndertimi, rehabilitimi dhe mirembajtja e rrugeve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore	106,098,277
	Sherbimet Publike Vendore	Ndricimi i mjediseve publike	14,300,000
	Sherbimet Publike Vendore	Parqet, lulishtet dhe hapesirat e gjelberta publike.	2,919,595
	Sherbimet Publike Vendore	Ndertimi, rehabilitimi dhe mirembajtja e varrezave publike si dhe garantimi sherbimit publik të varrimit	1,517,875
10	Sherbimet Publike Vendore	Dekori	1,000,000
	Rinia sporti	Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreacionale, zhvillimi dhe administrimi i institucioneve dhe objekteve qe lidhen me ushtrimin e ketyre funksioneve	9,172,175
11	Arsimi/Baze:	Funksioni i arsimit parauniversitar	76,618,702
12	Arsimi/Mesem	Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përashtim të shkollave profesionale.	7,292,709
13	MZSH dhe Mbrojtja Civile	Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.	19,822,000
14	UJITJE KULLIMI	Administrimi i Infrastrukturës vendore te ujites dhe kullimi te tokave si dhe menaxhimi i institucioneve ne sherbim te ketij funksioni, sipas menyre se percaktuar me ligj.	16,088,000
15	RRUG RURALE ASHP	Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.	2,788,747
16	Shërbimet Sociale	Ne bashkepunim me ministrinë per gjegjese per mireqenien sociale, krijojnë fondin social per financimin e sherbimeve, sipas mënyrës se percaktuar me ligj.	1,209,000

18	Perkujdesi Social	Krijimi dhe administrimi sherbimeve sociale per shtresat ne nevoje personat me aftesi te kufizuar, femijet, grata,te moshuarit etj,.sipas menyres se percaktuar me ligj.	9,710,000
19	Strehimi Social	Ndertimi dhe administrimi I qendrave per ofrimin e sherbimeve sociale lokale	3,100,000
19	Strehimi Social	Ndertimi dhe administrimi banesave per strehimin social, sipas menyres se percaktuar me ligj.	3,000,000
20	Fondi Rezerv/kontigjenc	Fondi Rezerv/kontigjenc	6,000,000
21	. Fond Emergence	Emergjencat civile	3,000,000
	<b>totali</b>	<b>totali</b>	<b>543,737,000</b>

**Modeli i Parashikimit Financiar** për vitin 2023 mbështetet në :

- *Parashikimin e Shpenzimeve;* parashikimi i shpenzimeve bëhet për çdo kategori të shpenzimeve aktuale. Çdo shpenzim parashikohet në bazë të parashikimit të personelit, operimit dhe mirëmbajtjes dhe shpenzime të tjera;
- *Parashikimin e të Ardhurave;* parashikimi i të ardhuarave bëhet në të njëjtën mënyrë si parashikimi i shpenzimeve duke ju referuar çdo takse dhe tarifë, të cilat analizohen në hollësi;
- *Treguesit e Buxhetit Total;* paraqesin një gërshtetim të të gjitha burimeve të financimit dhe shpenzimeve gjatë një viti buxhetor.

## **II.1 TË ARDHURAT E BASHKISË PATOS PËR VITIN 2023.**

Veprimtaria e Bashkisë Patos në fushën e sistemit fiskal vendor funksionon mbështetur në bazën ligjore, si më poshtë:

- Ligjin nr.139,datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”,
- Ligjin nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”,
- Ligjin nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar,
- Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar,
- Ligjin nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”.
- Vendimi e Këshillit të Ministrave nr. 319 datë 31.05.2018 “Për Miratimin e Masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”.
- Në aspektin fiskal, Bashkia me këtë buxhet synon mbajtjen e pandryshuar të taksave dhe tarifave vendore ose me rritje të lehtë për të përmirësuar cilësinë e shërbimit, si dhe

vazhdimin e politikave lehtësuese ose përjashtuese nga pagesa e taksave për kategoritë në nevojë.

- Synon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore duke forcuar strukturat dhe mirëadministrimin duke rritur bazën e taksapaguesve.

Bashkia Patos garanton funksionimin e saj duke përfituar burime financimi kryesisht nga taksat vendore, të miratuara sipas akteve ligjore në fuqi dhe nga taksat dhe tarifat vendore të miratuara me Vendime të Këshillit Bashkiak, më konkretisht:

## **STRUKTURA E TAKSAVE VENDORE**

### **I. Taksat Vendore:**

1. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme
2. Taksa e fjetjes në hotel
3. Taksa e ndikimit në infrastrukturë
4. Taksa e Tabelës

### **II. Taksat Kombëtare ose taksa të ndara:**

Taksë kombëtare ku një % të caktuar të saj e përfitojnë edhe njësitë e qeverisjes vendore ndryshe quhet taksë ose tatim i ndarë :

1. Taksa e rregjistrimit të përvitshëm të mjeteve
2. Taksa nga renta minerare
3. Tatimi mbi të ardhurat personelle
4. Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë

### **III. Taksa e përkohshme e tregut.**

## **STRUKTURA E TARIFAVE VENDORE**

1. Tarifa e Pastrimit për Familjet
2. Tarifa për Shërbimin Komunitar
3. Tarifa e Pastrimit për Biznesin
4. Tarifa e Gjelbërimit për Biznesin
5. Tarifa e Ndriçimit për Biznesin
6. Tarifa për mjetet e transportit
7. Tarifa për dhënie Leje ushtrim aktiviteti
8. Tarifa për Shërbime Administrative dhe urbanistike
9. Tarifa e Zënies së Hapësirës Publike
10. Tarifa të ndryshme në funksion të Drejtiveve dhe Ndërmarrjeve vartëse.
11. Tarifa për dhënie/marrje me qira të pronave të Bashkisë Patos

Në zbatim të ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar,Vendimit Këshillit Bashkiak ,struktura kryesore e ndjekjes dhe arkëtimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është caktuar Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Patos, Njësia Administrative Zharëz , Njësia Administrative Ruzhdie.

Për planifikimin e të ardhurave për vitin 2023 jemi mbështetur në realizimin si 9//mujor të 2022 si dhe në realitetin e sotëm ekonomik me të cilin përballemi çdo ditë , por sigurisht dhe në legjslacionin fiskal në fuqi.

<b>TABELA E REALIZIMIT TË TË ARDHURAVE PËR VITIN 2022</b>				
<b>SIPAS BUXHETIT</b> Tabela Nr.3				
<b>NR.</b>	<b>Kategorizimi sipas të ardhurave</b>	<b>I pritshmi I vitit 2022</b>	<b>Të realizuara si 9/mujor</b>	<b>% Realizuar</b>
	<b>Të ardhura nga taksat</b>	<b>178,538,000</b>	<b>127,640,000</b>	<b>72 %</b>
	<b>Të ardhura nga tarifat</b>	<b>89,444,000</b>	<b>30,605,000</b>	<b>34 %</b>
	<b>Pagesat dhe sponsorizimet</b>	<b>5,600,000</b>	<b>2,962,000</b>	<b>53 %</b>
	<b>SHUMA</b>	<b>273,582,000</b>	<b>161,207,000</b>	<b>59 %</b>

Nga të dhënat e mësipërme si 9/mujor për vitin 2022 kemi realizuar afërsisht 59 % të planit vjetor.

### **Parashikimi për vitin 2023**

Për vitin 2023 të ardhurat nga taksat e tarifat vendore, janë parashikuar në shumën 287,999,000 lekë, duke e krahasuar me vitin 2022 kemi parashikuar 14,417,000 lekë më shumë.

Parashikimi i të ardhurave me një rritje prej 5.2 % vjen si rezultat:

- Rritjen e arkëtimit të të ardhurave nga subjektet që ushtrojnë aktivitet privat,
- Uljen e evazionit fiskal duke ulur numrin e debitorëve,
- Normën e inflacionit ,
- Efektet e ndryshimit të politikës në lidhje me disa taksa,
- Efektet e përmirësimeve administrative,
- Përmirësimin e kushteve të biznesit dhe thjeshtimin e procedurave tatimore,
- Përsosja e sistemit informatik në programin e taksave.

Të ndara sipas grupimeve dhe klasifikimeve buxhetore të ardhurat ndahen në:

**I      Të ardhurat nga taksat**

- Të ardhurat nga taksat për vitin 2023 parashikohen të arrijnë në shumën 184,282,000 lekë ose 5,744,000 lekë më shumë duke e krahasuar me vitin 2022.
- Të ardhurat nga taksat vijojnë të mbeten burimi kryesor i të ardhurave pasi përbëjnë rrëth 64% të tyre. Ato financojnë jo vetëm shpenzimet kapitale të qytetit por edhe një pjesë të mirë të shërbimeve publike lokale pasi këto të fundit nuk arrijnë të optimizojnë të ardhurat e gjeneruara nga tarifat e shërbimit.

**II      Të ardhurat nga tarifat**

Të ardhurat nga tarifat për vitin 2023 parashikohen në shumën 98,117,000 lekë ose 8,673,000 lekë më shumë se viti 2022.

**III     Të ardhura nga dhënia me qera e pronës**

- Për vitin 2023 të ardhurat nga dhënia me qera e pronës parashikohet në shumën 2,300,000 lekë.

**IV     Të ardhura te tjera**

Në grupin të ardhura të tjera përfshihen të ardhurat nga gjobat, pagesat për kopshte dhe çerdhe dhe sponsorizimet e ndryshme. Për vitin 2023 parashikojmë të realizojmë 3,300,000 lekë.

Në vijim të këtij materiali po prezantojmë një analizë më të detajuar mbi parashikimin e të ardhurave sipas çdo takse e tarife vendore, duke bërë edhe analizën e realizimit të pritshëm të të ardhurave për vitin 2023.

**Të ardhurat nga Taksat për vitin 2023**

**Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël**

Në zbatim të ligjit nr. 122/2020” Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar bëhen këto ndryshime:

“Neni 11 shkalla tatimore”

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatushëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 0 (zero). ”Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2023 nuk do të parashikohen.

## **Taksa mbi Ndërtesat**

Për parashikimin e të ardhurave nga kjo taksë jemi mbështetur ne ligjin nr. 106/2017 Për dissa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore ” të ndryshuar.

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Nr.132 date 07.03.2018. i ndryshuar.

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimitari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktua në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2023 parashikohen të realizohen në shumën 21,424,000 lekë e cila është e përbërë nga taksa e pasurisë për qëllim banimi dhe veprimitari ekonomike .

Ky parashikim mbështetet në:

- të dhënat për taksën e ndërtesës janë marrë nga rregjistri i taksës së ndërtesës.
  - realizimin e të ardhurave si 9/mujor të vitit 2022.
  - evidentimin e subjekteve ekzistuese, saktësimin e sipërfaqeve.
  - mbledhjen e detyrimeve të prapambetura.
- 
- Duke u mbështetur përsa thamë më sipër kemi këte tabele të llogaritjes të vlerës vjetore për taksën për  $m^2$ :
- Sipërfaqe e ndërtesës x çmimi për  $m^2$  sipas Vendimit Këshillit Bashkiak.


Parashikimi i të ardhurave për taksën e ndërtesës për vitin 2023 paraqitet si më poshtë:

Tabela Nr.4

Nr.	Emërtimi	Sip/m <sup>2</sup>	Niveli i taksës për m <sup>2</sup>	Shuma në lekë
I.	Ndërtesa për biznesin	79,446		<b>8,346,032</b>
	Bashkia Patos	61,000	10	6,649,000
	Njësia Administrative Zharëz	16,660	92	1,532,720
	Njësia Administrative Ruzhdie	1,786	9	164,312
II	Ndërtesa për popullatën	779,228		<b>11,352,763</b>
	Bashkia Patos	443,571	15	6,653,565
	Njësia Administrative Zharëz	230,357	14	3,224,998
	Njësia Administrative Ruzhdie	105,300	14	1,474,200
	<b>Totali = I+II</b>			<b>19,698,795</b>
III	Debitor për taksën e ndërtesës			<b>1,725,205</b>
	Njësia Administrative Patos			1,219,000
	Njësia Administrative Zharez			421,000
	Njësia Administrative Ruzhdie			85,205
	<b>Totali = I+II+III</b>			<b>21,424,000</b>

Të ardhurat totale nga Taksë e Ndërtesës për vitin 2023 parashikohen **21,424,000** lekë.

Paraqitja grafike e Taksës së Ndërtesës.  
Grafiku nr.1



### Taksa mbi tokën bujqësore

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës në hektarë, në pronësi të taksa paguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë. Taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor.

Për parashikimin i të ardhurave nga kjo taksë është zbatuar nen 23 te ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

## Toka bujqësore sipas zyrës kadastrës Njësia Administrative Patos

Tabela nr.5

Nr.	<u>Vendndodhje</u>	Sip/ha	Nivel i taksës sipas V.K.B	Shuma /lekë
1	Kat. I	12.08	5600	67,648
2	Kat. II	142.99	4900	700,651
3	Kat. III	187.954	4200	789,407
4	Kat. IV	499.279	3600	1,797,404
5	<b>KAT. V</b>	168.012	3000	504,036
6	Kat. VI	172.165	2400	413,196
7	<b>KAT. VII</b>	223.179	1800	401,722
	<b>SHUMA</b>	<b>1405.659</b>		<b>4,674,064</b>

Debitorë deri në 18 muaj = **1,375,516 lekë**Shuma totale në lekë = **6,049,580 lekë**

## Toka bujqësore sipas zyrës kadastrës Njësia Administrative Zharëz

Tabela nr.6

Nr.	<u>Vendndodhje</u>	Sip/ha	Nivel i taksës sipas V.K.B	Shuma /lekë
1	Kat. I	4.4	5600	24,640
2	Kat. II	497.3	4900	2,436,770
3	Kat. III	1179.7	4200	4,954,740
4	Kat. IV	388.1	3600	1,397,160
5	<b>KAT. V</b>	29.5	3000	88,500
	<b>SHUMA</b>	<b>2090</b>		<b>8,901,810</b>

Nga kjo sipërfaqe përjashtohen:

1. Persona invalid, 260 persona ,norma për frysë 0.3 dylym=  $260 \times 3000 \text{ m}^2 = 780,000 \text{ m}^2 = 78 \text{ ha}$ .

Veprimet 78 ha x 3600 = **280,800 lekë**.

**Shuma = 8,901,810 - 280,800 = 8,621,010 lekë**

Debitorë deri në 18 muaj = **2,362,252 lekë**

**Shuma totale në lekë = 10,983,262 lekë**

#### **Toka bujqësore sipas zyrës kadastrës Njësia Administrative Ruzhdie**

Tabela nr.7

<b>Nr.</b>	<b><i>Vendndodhje</i></b>	<b><i>Sip/ha</i></b>	<b><i>Niveli i taksës sipas V.K.B</i></b>	<b><i>Shuma /lekë</i></b>
1	Kat. VI	892	2400	2,140,800
2	<b>KAT VII</b>	1200	1800	2,160,000
	<b>TOTALI</b>	<b>2092</b>		<b>4,300,800</b>


Debitorë deri në 18 muaj = **86,358 lekë**

**Shuma totale në lekë = 4,387,158 lekë**

**Të ardhurat totale nga Taksa e Tokës bujqësore për vitin 2023 parashikohen 21,420,000 lekë.**

Paraqitja grafike e Taksës së Tokës Bujqësore.

Grafiku nr.2



Parashikimi për vitin 2023 është bërë në bashkëpunim me Drejtorinë e Kadastrës në bazë të formularëve që disponon kjo drejtori.

### Taksa mbi Truallin jo hapësire publike

Për planifikimin e të ardhurave nga kjo taksë jemi mbështetur në nenin 23/1 të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar si dhe në ankesin 2.1, që i bashkëlidhet këtij ligji.


1. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë.

Për vitin 2023 kemi parashikuar të ardhura nga Taksa e Truallit si më poshtë:

Tabela nr.8

Nr.	Emërtimi	Sip/m <sup>2</sup>	Niveli i taksës në lekë	Shuma në lekë
1.	<b>Truall për njësinë Administrative Patos</b>	<b>3,080,572</b>		<b>36,868,000</b>
	Biznesi	2,452,000	15	36,780,000
	Komuniteti	628,572	0.14	88.000
2	<b>Truall për njësinë Administrative Zharëz</b>	<b>80,000</b>		<b>1,200,000</b>
	Biznesi	80,000	15	1,200,000
3	<b>Truall për njësinë Administrative Ruzhdie</b>	<b>933</b>	15	<b>14,000</b>
	Biznesi	933	15	14,000
	<b>TOTALI</b>			<b>38,082,000</b>

Paraqitura grafike e Taksës mbi Truallin. Grafiku nr.3



### **Taksa e Rregjistrimit të Mjeteve të përdorura**

Mbështetur në ligjin nr.68/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9975 datë 27.07.2008 “Për taksat kombëtare” të ndryshuar.

Në nenin 4, pika 3 ndryshohet si më poshtë:


Taksa vjetore e mjeteve të përdorura është e vlefshme për 365 ditë dhe caktohet sipas formulës: Cilindrata në cm<sup>3</sup> x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit. Taksa fikse për llojin e karburantit është 12,5 lekë për naftën dhe 10 lekë për benzinën. Koeficienti sipas vjetërsisë së mjetit është si në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj takse. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë prej 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 25 për qind për çdo vit. 25 për qind e të ardhurave vjetore nga kjo takse i kalojnë buxhetit të qeverisjes vendore. Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësive të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore.

**Për vitin 2023 kemi parashikuar të ardhura nga Taksa e Rregjistrimit si më poshtë:**

Tabela nr.9

<b>Nr.</b>	<b>Njësitë Administrative</b>	<b>Të ardhurat që i takojnë Pushtetit Vendor në lekë</b>
1	Bashkia Patos	11,094,000
2	Njësia Administrative Zharëz	3,627,000
3	Njësia Administrative Ruzhdie	970,000
	<b>Totali</b>	<b>15,691,000</b>

Paraqitja grafike e Taksës së Rregjistrimit të Mjeteve. Grafiku nr.4



### Taksa mbi Ndikimin në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkohëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Parashikimi i të ardhurave nga kjo taksë është bërë nga Drejtoria e Urbanistikës mbështetur në kërkesat që ka për leje ndërtimi si dhe shkresat e ardhura nga ASHK për legalizimet.

**Të ardhurat totale nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë për vitin 2023 parashikohen 6,399,000 lekë.**

### Taksa mbi kalimin e të Drejtës së Pronësisë për pasuri të paluajtshme

1. Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
2. Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Për parashikimin e të ardhurave nga kjo taksë jemi mbështetur në nenin 28 te ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

**Të ardhurat totale nga Taksa mbi Kalimin e të Drejtës së Pronësisë për vitin 2023 parashikohen 400,000 lekë.**

#### Taksë e Tabelës

Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet të cilët vendosin tabele indetifikimi mbi 2 m<sup>2</sup>, të trupezuara në siperaqen e ndërtesës ose brenda teritorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoret për të reklamuar aktivitetin e të tretëve.

Tabele jashtë teritorit ku zhvillohet aktiviteti në formen dhe përmasat e tabelleve së sinjalistikës.


Tabele që përdoren për qëllime reklamimi e thjeshtë dhe elektronike.

Ky parashikim mbështetet në realizimin faktik të vitit 2021 dhe në realizimin si 9/mujor të vitit 2022. Për vitin 2023 parashikojme të realizojmë 630,000 lekë e ndarë: Njësia Administrative Patos 470,000 lekë, Njësia Administrative Zharez 150,000 lekë dhe Njësia Administrative Ruzhdie 10,000 lekë.

**Të ardhurat totale nga Taksa e Tabelës për vitin 2023 parashikohen 630,000 lekë.**

Paraqitja grafike e Taksës së Tabelës

Grafiku nr.5



**Taksa e Tregut**

Parashikimi i të ardhurave nga kjo taksë është bërë duke zbatuar ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar si dhe në Vendimin e Këshillit të Bashkisë.


Nisur nga realizimi e kësaj takse për vitin 2021 si dhe realizimin si 9/ mujor të vitit 2022, për vitin 2023 parashikojme duke u mbështetur në realizimin mesatar ditor si dhe numrin e tregëtarëve në treg, shumën 1,290,000 lekë, detajuar si më poshtë:

Tabela nr.10

Nr.	Njësiti Administrative	Parashikimi për vitin 2023 në lekë
1.	Bashkia Patos	<b>820,000</b>
2.	Njësia Administrative Zharëz	<b>470,000</b>
	<b>Totali</b>	<b>1,290,000</b>

**Të ardhurat totale nga Taksa e Tregut për vitin 2023 parashikohen 1,290,000 lekë.**

Paraqitja grafike e Taksës së Tregut      Grafiku nr.6



### **Taksa e Rentës Minerare**

Ne zbatim te ligjit nr.157/2014 datë 20.05.2010 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.9975 datë 28.07.2008 “Për taksën kombëtare” të ndryshuar.

Taksa e Rentës Minerare caktohet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënie kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi/dhe nëntoka e territorit të Republikës së Shqipërisë. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare. Në rastin e eksportit të produkteve minerare, renta paguhet në çastin e bërjes së deklaratës së eksportit. 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i kalojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria.Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore.


Renta minerare përcaktohet duke shumëzuar vlerën e përgjithshme të shitjes me shumicë të produktit me përqindjen e rentës, sipas përcaktiveve të shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Pagesa e rentës minerare bëhet brenda muajit pasardhës, kur janë realizuar shitjet. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit.

Nisur nga akt rakordimet e bëra si 9/ mujor me Degën e Doganës Vlorë si dhe transferimin e fondeve nga dogana dhe nga tatimet , për vitin 2023 parashikojmë të realizojmë 75,434,000 lekë.

**Të ardhurat totale nga Taksa e Rentës Minerare për vitin 2023 parashikohen 75,434,000 lekë.**

Paraqitura grafike e Taksës së Rentës Minerare

Grafiku nr.7



### Të ardhura nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (TAP)

Në zbatim të gjermës ç, pika 2 e nenit 25 të ligjit nr. 68 datë 27.04.2017 “ Për financat e vetëqeverisjes vendore ”njësitë e vetëqeverisjes vendore janë përfitues në masën 2% nga tatimi mbi të ardhurat personale (TAP) që realizojnë në juridikSION të tyre. Është Ministria e Financave dhe Ekonomisë , Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit , Drejtoria e Financave Vendore që i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve mbi ndarjen e tatimit të ardhurave Personale (TAP) .

**Të ardhurat totale nga Tatimi mbi të ardhurat personale (TAP) për vitin 2023 parashikohen 3,512,000 lekë.**

### **Të ardhurat nga Tarifat për vitin 2023**

Në bazë të nenit 35 pika 5 të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifat vendore:

- a) Për shërbimet publike që ato ofrojnë,
- b) Për të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore,
- c) dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj,
- ç) çdo tarifë tjetër të përkohshme, në përputhje me rrethana të përcaktuara me ligj,

Në këtë grup të ardhurash përfshihen të gjitha të ardhurat me natyrë jo tatimore.

### **Parashikimi i të ardhurave nga tarifat e transporti licencë dhe certifikat mjeti dhe autorizimet.**

Për parashikimin e të ardhurave nga këto tarifa jemi mbështetur në realizimin faktik të vitit 2021, në realizimin si 9/ mujor të vitit 2022 .Si bazë ligjore kemi parasysh ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.8308 datë 18.03.1998 “Për transportin rrugor”, Udhëzimeve nr.15 dhe 20 datë 19.07.2007. V.K.M. nr. 970 datë 02.12.2015 i ndryshuar me V.K.M. nr 344 datë 19.04.2017“.


Të ardhurat nga kjo tarifë për vitin 2023 parashikohen si më poshtë:

**Tabela nr.11**

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i taksës ose tarifës</b>	<b>Parashikohet për vitin 2023 në lekë</b>
1	Liçencë dhe certifikatë mjeti	1,179,000
2	Autorizime për shitje karburanti.	2,000,000
3	Tarifë parkimi	921,000
	<b>TOTALI</b>	<b>4,100,000</b>


Paraqitja grafike e të ardhurave nga liçensimi i mjeteve dhe autorizim për tregtim karburanti

Grafiku nr.8



Paraqitja grafike i të ardhurave nga tarifa e parkimit të mjeteve

Grafiku nr.9



Tarifa e Pastrimit për Familjet

Ky shërbim shtrihet në territorin e Bashkisë Patos, Njësinë Administrative Zharëz,

Njësinë Administrative Ruzhdie (vetëm në fshatrat Ruzhdie , Gjinoqarë ,Siqecë ).Në zbatim të V.K.B. tarifa aplikohet për të gjitha familjet që e përfitojnë këtë shërbim.

Për Tarifën e Pastrimit për Familjet kemi parashikuar të ardhura për vitin 2023 si më poshtë:

Tabela nr.12

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Nr Familje</b>	<b>Nivel tarifës</b>	<b>Shuma e parashikuar për vitin 2023 në lekë</b>
<b>1</b>	<b>Bashkia Patos</b>	Familje	7800		<b>16,471,000</b>
	Familje me kuatë te plotë	Familje	4706	3,500	16,471,000
	Familje të skemës së ndihmës ekonomike	Familje	88	0	0
	Invalid, tetraplegjik, , të paafte, verbëri	Familje	976	0	0
	Pensionist, në ato raste kur nuk kanë persona të tjere në çertifikat familjare	Familje	2030	0	0
<b>2</b>	<b>Njësia Administrative Zharëz</b>		2473		<b>7,882,000</b>
	Familje me kuatë të plotë	Familje	2252	3,500	7,882,000
	Familje të skemes së ndihmës ekonomike	Familje	54	0	0
	Invalid, tetraplegjik, , të paafte, verbëri.	Familje	167	0	0
<b>3</b>	<b>Njësia Administrative Ruzhdie ( fshatrat Ruzhdie, Gjinoqarë, Siqecë )</b>		599		<b>364,000</b>
	Familje me kuatë të plotë	Familje	520	700	364,000
	Familje të skemes së ndihmës ekonomike	Familje	34	0	0
	Invalid, tetraplegjik, , të paafte, verbëri.	Familje	45	0	0
	<b>Shuma totale</b>				<b>24,717,000</b>

Tarifa për Shërbimin Komunitar

Ky shërbim shtrihet në territorin e Bashkisë Patos, Njësinë Administrative Zharëz,

Njësinë Administrative Ruzhdie (vetëm në fshatrat Ruzhdie, Gjinoqarë, Siqecë). Në zbatim të V.K.B. tarifa aplikohet përfshirë gjitha familjet që e përfitojnë këtë shërbim.

Për Tarifën e Shërbimit Komunitar kemi parashikuar të ardhura për vitin 2023 si më poshtë:

Tabela nr.13

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Nr Familje</b>	<b>Nivel tarifës</b>	<b>Shuma e parashikuar për vitin 2023 në lekë</b>
<b>1</b>	<b>Bashkia Patos</b>	Familje	7800		<b>3,294,200</b>
	Familje me kuatë te plotë	Familje	4706	700	3,294,200
	Familje të skemës së ndihmës ekonomike	Familje	88	0	0
	Invalid, tetraplegjik, , të paafte, verbëri	Familje	976	0	0
	Pensionist, në ato raste kur nuk kanë persona të tjere në çertifikat familjare	Familje	2030	0	0
<b>2</b>	<b>Njësia Administrative Zharëz</b>		2473		<b>1,576,400</b>
	Familje me kuatë të plotë	Familje	2252	700	1,576,400
	Familje të skemes së ndihmës ekonomike	Familje	54	0	0
	Invalid, tetraplegjik, , të paafte, verbëri.	Familje	167	0	0
<b>3</b>	<b>Njësia Administrative Ruzhdie ( fshatrat Ruzhdie, Gjinoqarë, Siqecë )</b>		599		<b>156,000</b>
	Familje me kuatë të plotë	Familje	520	300	156,000
	Familje të skemes së ndihmës ekonomike	Familje	34	0	0
	Invalid, tetraplegjik, , të paafte, verbëri.	Familje	45	0	0
	<b>Shuma totale</b>				<b>5,026,000</b>

**Të ardhurat totale nga Tarifa për Shërbimin Kumunitar për vitin 2023 parashikohen 5,026,000 lekë.**

#### **Tarifa e Pastrimit për Biznesin**

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkisë tarifa aplikohet për të gjitha subjektet private që ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në territorin e Bashkisë Patos.


Për Tarifën e Pastrimit për Biznesin kemi parashikuar të ardhura për vitin 2023 si më poshtë:  
Tabela nr.14

<b>Emërtimi</b>	<b>Parashikimi për vitin 2023 në lekë</b>
Për Bashkinë Patos	10,750,000
Për Njësinë Administrative Zharëz	4,500,000
Për Njësinë Admnistrative Ruzhdie	864,000
<b>Shuma totale</b>	<b>16,114,000</b>

Debitorë deri në 18 muaj = **1,200,000 lekë**.

**Të ardhurat totale nga Tarifa e Pastrimit për vitin 2023 parashikohen 42,031,000 lekë.**  
Paraqitura grafike e Tarifës së Pastrimit

Grafiku nr.10



### Tarifë Ndotje Mjedisit

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të vendosin tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit. Niveli i këtyre tarifave përcaktohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjesvendore dhe vendoset për individët, personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë aktivitete, efekti i të cilave në mjedis është i qartë.


Pasqyra e parashikimit të ardhurave nga e tarifa e Ndotjes së Mjedisit

Tabela nr.15

	Emërtimi	Parashikimi për vitin 2023 në lekë
	Për Bashkinë Patos	6,600,000
	Për Njësinë Administrative Zharëz	31,356,000
	Për Njësinë Administrative Ruzhdie	3,000,000
	<b>Shuma totale</b>	<b>40,956,000</b>

Paraqitura grafike e tarifës për Ndotjen e Mjedisit

Grafiku nr.11



### Tarifë Gjelbërimi & Ndriçimi

I nënshtrohen të gjithe personat fizikë e juridikë, vendas dhe të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Patos dhe Njësisë Administrative Zharëz.


Pasqyra e parashikimit të ardhurave nga e Tarifa e Gjelbërimit dhe Ndriçimit

Tabela nr.16

	<b>Emërtimi</b>	<b>Parashikimi</b>
	<b>Tarifë Gjelbërimi</b>	
	Bashkia Patos për biznesin	1,234,000
	Njësia Administrative Zharëz	375,000
	Njësia Administrative Ruzhdie	0
	<b>SHUMA</b>	<b>1,609,000</b>
	<b>Tarifë Ndriçimi</b>	
	Bashkia Patos për biznesin	1,234,000
	Njësia Administrative Zharëz	375,000
	Njësia Administrative Ruzhdie	0
	<b>SHUMA</b>	<b>1,609,000</b>

Paraqitja grafike e tarifës Gjelbërimit dhe Ndriçimit

Grafiku nr.12



### **Tarifa e Zënies së Hapësirave publike**

Baza e tarifës për zënie të hapsirave publike është sipërfaqja në m<sup>2</sup>, e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet si detyrim më i takspaguesit.

**Për vitin 2023 parashikojmë të ardhura nga kjo tarifë 250,000 lekë.**

### **Tarifa e Mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit**

Baza e tarifës së mirëmbajtjes së infrastrukturës ujitjes dhe të kullimit është sipërfaqe toke në dylik, tarifa llogaritet si detyrim vjetor.

**Për vitin 2023 parashikojmë të ardhura nga kjo tarifë 880,000 lekë.**

### **Tarifat e tjera**

Të ardhurat që do të realizohen nga kryerja e këtyre shërbimeve do të janë sipas tabelës:

Tabela nr.17

Nr.	Emërtimi	në lekë
1	Vertetime Drejtoria e Financës	12,000
2	Vërtetime Drejtoria e Kadastrës	100,000
3	Vërtetime nga Drejtoria e Urbanistikës dhe plane vendosje	587,000
4	Vërtetime nga arshiva	150,000
5	Qera objekti	1,000,000
6	Qera toke bujqësore Njësia Administrative Ruzhdie	1,300,000
7	Gjoba	500,000
8	Tarifë reklame	507,000
9	Kopësht + çerdhe	2,800,000

10	Të ardhura nga MZSH	300,000
	<b>Shuma totale</b>	<b>7,256,000</b>

**Totali të ardhurave nga burimet e veta nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2023 parashikohen = 287,999,000 lekë.**

**Tabela e të Ardhurave:**

Tabela nr.18 .000

Emertimi I te ardhurave Tatimore	Fakti vitit 2020	Fakti vitit 2021	Parashikimi per vitin 2022	Parashiki,I per vitin 2023
<b>Te ardhurat nga taksat</b>	<b>120,089</b>	<b>164,340</b>	<b>178,538</b>	<b>184,282</b>
Taksa mbi Ndertesat	10,252	11,348	21,386	21,424
Taksa mbi token bujqesore	7,094	8,087	21,006	21,420
Taksa e ndikimit ne infrastruktur nga ndertimet e reja	7,967	2,009	5,600	6,399
Taksa e kalimit te drejtes se pronesis per pasuri te pa luajtshme	32	59	300	400

**BUXHETI 2023**

---

Taksa vjetore e mjeteve te perdonura	16,397	16,821	15,489	15,691
Taksa per zenien e hapsires publike	0	0	0	0
Taksa e tableles	606	980	630	630
Taksa te perkohshme	0	0	0	0
Taksa e rentes minerare	38,812	52,714	71,243	75,434
Tatim mbi te ardhurat personale TAP	5,268	6,937	3,512	3,512
Taksa mbi truallin	31,998	64,430	38,082	38,082
Tatimi i thjeshtuar mbi biznesin e vogel	1,083	495	0	0
Takse tregu	580	460	1,290	1,290
<b>Te ardhurat nga tarifat</b>	<b>102,324</b>	<b>75,586</b>	<b>89,444</b>	<b>98,117</b>
Tarifa per pastrimin	21,618	23,779	33,038	42,031
Tarifa e sherbimit komunitar	0	0	3,635	5,026
Tarife per hapsirat publike	7	30	250	250
Tarife per ndriçim rrugor	1,293	1,733	1,555	1,609
Tarife gjelberimi	1,321	1,749	1,555	1,609
Tarife per reklame	389	0	419	507
Tarife per parkim	702	769	891	921
Tarife per vulosje veterinare te bagetive te therura	676	1,952	2,046	0
Tarife per sherbime te tjera administrative	955	505	1,100	1,149
Tarfe per sherbime sociale ((arsim parashkollar dhe konvikte)	0	0	0	0
Sporte dhe kultura	0	0	0	0
Tarife per dhenje leje licensa dhe autorizime	3,387	2,240	3,119	3,179
<i>Tarihe mjedisit</i>	69,372	41,674	40,956	40,956
<i>Tarifa per mirmbajtje vaditje kullim</i>	468	565	880	880
Te tjera jo tatimore	2,136	590	0	0
<b>Te ardhura nga shitja e prones dhe dhenia me qera</b>	<b>1,864</b>	<b>2,240</b>	<b>2,300</b>	<b>2,300</b>
<i>Shitje ndertese</i>	0	0	0	0
<i>Shitje troje</i>	0	0	0	0
<i>Shitje te pronave te ndryshme</i>	0	0	0	0

<i>Qera troje (toke)</i>	1,049	1,070	1,300	1,300
<i>Qera nga ndetesat</i>	815	1,170	1,000	1,000
<i>Interesat nga te ardhurat</i>	0	0	0	0
<i>Te ardhurat nga ndermarrje te ndryshme</i>	0	0	0	0
<b>Te ardhura te tjera</b>	<b>4,518</b>	<b>3,028</b>	<b>3,300</b>	<b>3,300</b>
Grante nga nivele te tjera	0	1,175	0	0
<i>Kredi dhe hua</i>	0	0	0	0
<i>Dhurata dhe sposorizime te ndryshme</i>	1,543	97	0	0
<i>Te ardhurat nga gjobat</i>	1,718	129	500	500
<i>Te ardhura nga pagesat per kopeshte dhe çerdhe</i>	1,257	1,627	2,800	2,800
<b>Te Ardhurat e Veta Totale</b>	<b>228,795</b>	<b>245,194</b>	<b>273,582</b>	<b>287,999</b>
<i>Transferta e Pakushtezuar</i>			<b>134,575</b>	154,219
<i>Transferta Specifike</i>			<b>97,605</b>	101,519
<b>TOTAL</b>			<b>505,762</b>	<b>543,737</b>

## TRANSFERTAT NGA BUXHETI I SHTETIT

Niveli i transfertës së kushtëzuara dhe të pakushtëzuar përcaktohet çdo vit në ligjin e Buxhetit të Shtetit, sipas kritereve përfituese për cdo Bashki.

### II.2 TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR

Ashtu sikurse përkufizohet në ligj dhe në udhëzimet e Ministrisë të Financave, transferta e pakushtëzuar (grant) është e ardhur e pushtetit vendor, e trashëgueshme, e përfituar nga buxheti i shtetit pa kusht kthimi, për një qëllim të përcaktuar ose jo, që përdoret për financimin e shpenzimeve për funksionet e veta dhe të përbashkëta të qeverisjes vendore.


Transferta e pakushtezuar për vitin buxhetor 2023 është në vlerën **154 219 000 lekë**, nga **134 575 000 lekë** në vitin 2022, me një rritje në vlerën **19 644 000 lekë**, ose **12.7 % më shumë**.

{Si në tabelën më poshtë}:

Tabela nr.19

Viti	2022	2023
<i>Transferta e pakushtëzuar</i>	134 ,575	154 ,219

*Grafikisht: Grafiku nr.13*



### II.3 TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR SEKTORIALE

Ashtu sikurse përkufizohet në ligj dhe në udhëzimet e Ministrit të Financave, transferta specifike për funksionet e transferuara nga pushteti Qendoror (arsimi edukativ parashkollor, personeli ndihmes parauniversitar, Mbrojtja nga zjarri, Rrugët Rurale, Ujitja dhe Kullimi, Administrim Pyje) e përfituar nga buxheti i shtetit pa kusht kthimi, do të përdoret për financimin e shpenzimeve për këto funksione.

Transferta specifike për vitin buxhetor 2023 është në vlerën **101,519,000** lekë, nga **97,605,000 lekë në vitin 2022**, me një rritje prej 3.9% duke plotësuar me mirë nevojat për këto funksione të shtuara.

*Sipas tabelës më poshtë:*

Tabela nr.20

Viti	I pritshmi 2022	2023
Transferta pakushtëzuar sekторiale	97 605	101 519

Kjo transfertë do të mbulojë këto funksione :

- **Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Mbrojtjes Civile**, si funksion shtesë i detyrueshëm. Ky funksion do të mbulohet nga transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe do të përfshije shpenzimet e personelit dhe shpenzime operative. Gjithashtu për vitin 2023 ky funksion do të vazhdoi të jetë bashkë me funksionin e emergjencave civile dhe së bashku do të bëjnë një program menaxhimi. Për vitin 2023 fondi për këtë funksion është 22,822,000

lekë, të cilat 19,822,000 janë fonde nga transferta specifike për këtë funksion dhe 3.000.000 lekë nga të ardhurat e Bashkisë Patos. Njësia shpenzuese, Bashkia Patos.

- **Rrugë Rurale**, si funksion shtesë i detyrueshëm. Sipas përshkrimeve të reja të vendosura në udhëzimet e Pba-së ky funksion i buxhetit do të përbledhi edhe të gjitha investimet infrastrukturore prandaj e kemi ndarë ketë program në 2 njësi shpenzuese të cilat janë Bashkia dhe Agjenisa e Shërbimeve Publike kur tek ASHP kemi vendosur kryesisht fondet që vijnë me transfertën specifike për këtë program. Ky funksion do të mbulohet nga transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe do të përfshijë shpenzimet e personelit, shpenzime operative. Për vitin 2023 fonda nga **transferta specifike** është 2.003.000 lekë.

Njësia shpenzuese : Bashkia Patos dhe ASHP.

- **Arsimi bazë**, si funksion i transferuar. Ky funksion do të mbulohet nga transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe do të përfshije shpenzimet e personelit edukativ, operative dhe investime. Për vitin 2023 fonda për këtë funksion eshte 76,618,702 lekë nga të cilat 58,591,000 janë fonde nga **transferta specifike** dhe 18,027,702 janë fonde nga transferta e pakushtëzuar me një rritje nga viti 2022 të transfertës specifike në vlerën 2,582,00 lekë ose 4.4 % .
- . Njësia shpenzuese Bashkia Patos.
- **Arsimi mesëm**, si funksion shtesë i transferuar. Ky funksion do të mbulohet nga transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe do të perfshijë shpenzimet e personelit ndihmës dhe shpenzime operative. Për vitin 2023 fonda për këtë funksion është 7,292,709 lekë, nga të cilat 3,871,000 janë fonde nga **transferta specifike** dhe 3,421,709 lekë janë fonde nga transferta e pakushtëzuar nga 7,391,528 lekë per vitin 2022 nga te cilat 3.717.000 lekë kanë qënë nga transferta specifike dhe 3,674,528 lekë nga transferta e pakushtëzuar, me një ulje fare të vogël në total nga viti 2022 në vlerën 98,919 lekë ose 0.01% dhe me një rritje të transfertës specifike për këtë program në vlerën 154,000 lekë. Njësia shpenzuese Bashkia Patos.
- **Ujita dhe Kullimi**, si funksion shtesë i transferuar. Ky funksion do të mbulohet nga transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe do të përfshijë shpenzimet e personelit dhe shpenzime operative dhe shpenzimet për investime. Për vitin 2023 fonda sektorial për këtë funksion është 16,088,000 lekë, nga 15,741,000 lekë per vitin 2022 me një rritje prej rreth 2.2. Njësia shpenzuese Bashkia Patos.
- **Administrim Pyje**, si funksion shtesë i detyrueshëm i transferuar. Ky funksion do të mbulohet nga transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe do të përfshijë shpenzimet e personelit dhe shpenzime operative. Për vitin 2023 fonda për këtë funksion është 3,845,809 lekë nga të cilat 1,144,000 janë fonde nga **transferta specifike** dhe 2,701,809 janë fonde nga të ardhurat e veta të Bashkisë me një rritje nga viti 2022 në vlerën

312,383 lekë ose 8,8% në total ku shpenzimet për këtë program në vitin 2022 janë 3,533,426 lekë. Njësia shpenzuese Bashkia Patos.

#### **II.4 BURIME TË TJERA FINANCIMI - DONACIONE DHE FONDE NGA MINISTRITË.**

*Projektet janë paraqitur në tabelën e mëposhtëme :*

**TABELA :PASQYRA PERMBLEDHESE E PROJEKTVE ME FINANCIM NGA DONATORË**

**PER VITET 2022-2024**

Tabela nr.21

	<b>DONATORI</b>	<b>EMERTIMI I FINANCIMIT</b>	<b>FINANCIM 2022</b>	<b>FINANCIM 2023</b>	<b>FINANCIM 2024</b>	<b>TOTAL FONDI</b>	<b>SHPJEGIM</b>
1	Bashkimi Evropian	Projekti RELOAD		1,400,000	3,000,000	4,400,000	
2	Ambasada Zvicerane HAP	Rikonstruksioni I Qendres Shendetesore Rruzhdie dhe AMBULANCES DUKAS	10,057,748			10,057,748	34% mbi financimin do të jetë financim i Bashkisë.
3	Bashkimi Evropian	Permiresimi I Qëndrës Kulturore të Fëmijëve		5,411,120		5,411,120	Fituar projekt i bazë konkurimit

4	Ministria e Financave	Permiresimi I Qëndrës Kulturore të Fëmijëve		1,618,784		<b>1,618,784</b>	Financim I bashkefinancimit dhe TVSH
4	Ministria e Financave	Përmirësimi i banesave ekzistuese për familjet në nevojë	8,239,582	3,330,384		<b>11,569,966</b>	30% mbi financimin do të jetë financim i Bashkisë.
5	Ministria e Arsimit	Rikonstruksion I shkollës "Muhamet Shehu" dhe ndërtim i Palestrës.	32,434,150	48,651,226		<b>81,085,376</b>	15% mbi financimin do të jetë financim i Bashkisë.
6	IADSA	Rikonstruksion i magazinës në rrugën "Gani Banaj" me objekt me funksion shërbime artizanale.	27,000,000			<b>27,000,000</b>	FITUAR PROJEKTI PER NXITJEN E PUNESIMIT
	<b>TOTAL</b>		<b>77,731,480</b>	<b>60,411,514</b>	<b>3,000,000</b>	<b>141,142,994</b>	

## **II.5 TRANSFERTA E KUSHTEZUAR**

Transferta e kushtezuar jepet për financimin e një pjesë të shpenzimeve përfunksionet e përbashkëta dhe përfincimin e shpenzimeve përfunksionet e deleguara. Këto fonde përdoren vetëm për qëllimin përf të cilin janë miratuar. Kjo do të thotë që këto janë fonde të ministrike/institucioneve qëndrore dhe për transferimin e tyre nga një njësi e qeverisjes vendore në një tjetër, veprohet sipas rregullave të përgjithshme të transferimit të fondeve buxhetore.

Në buxhetin e njësive vendore, fondet e kushtezuara përfincimin e funksioneve që nuk janë transferuar ose deleguar, nuk janë të ardhura vendore dhe nuk miratohen si pjesë përbërëse e buxhetit të tyre.

Funksione të deleguara në pushtetin vendor janë:

- *Shërbimi i gjendjes civile* si funksion i deleguar i detyrueshëm. Numri i punonjësve dhe kuotat përkatëse përf këtë funksion do te dërgohen nga Ministria e Brendshme.
- *Për mbrojtjen sociale*, si funksion i deleguar i detyrueshëm. Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të respektojnë destinacionin e përcaktuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale.
- *Transferta e Kushtezuar përf Mbrotjen civile* sipas e cila alokohet sipas peshës specifik

Të buxhetit ndaj total buxhetit të 61 Bashkive.

### **III. PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2023**

#### **Baza ligjore:**

- Ligji nr.9936 datë 26.06.2008”Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”i ndryshuar
- Ligji nr.139/2015,datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligji nr.68/2017 datë 27.04.2017“Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- Ligji për buxhetin e Vtitit 2020
- Ligji nr.45/2019 për “Mbrojtjen Civile” datë 18.07.2019 neni 65.

#### Vendime dhe udhëzime:

- Udhëzimi Nr.21 dt 25.10.2016 “Për Nëpunësit Zbatues të të gjitha niveleve “
- Udhëzimi nr.23 dt. 30.07.2018 “Për proceduart standarte të përgatitjes së programit të PBA-së”.
- Udhëzimi nr.8 datë 28.02.2022 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë “ Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025”.
- VKB nr.16 datë 23.03.2022 “ Raporti për vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave për periudhën 2023-2025”
- VKB nr.17 datë 23.03.2022 “ Mbi Miratimin e Tavaneve Përgatitor të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”.”.
- VKB nr.43 datë 20.06.2022 “ Mbi Miratimin e Dokumentit të Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”
- Udhëzimit Plotësues nr.23 datë 08.07.2022“ Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”,nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
- Vendim i Këshillit Bashkiak nr.49 dt. 20.07.2022 miratimi i ” Tavaneve Përfundimtar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 Faza e Parë”.
- Shkresën nga Ministria e Financave për “Dërgimin e transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2023 me nr.19206 prot datë 19.10.2022

Shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë Patos për vitin 2023 për të gjitha funksionet parashikohen në masën **543,737,000** lekë, duke patur si burim financimi transfertën e pakushtëzuar e vitit në vlerën **154 219 000** lekë, të ardhurat të taksave dhe tarifave vendore **287,999,000** lekë , transferta e pakushtëzuar sektoriale **101,519,000** lekë.,

Shpenzimet e Pritshme të Bashkisë për vitin 2022 parashikohen në vlerën **749,305,148** lekë, duke pesuar rritje nga shtesa e fondevë te trashëgura në masën 243 543 235 lekë.

**Parashikimi i shpenzimeve për vitin 2023 vijon të ketë në vëmëndje:**

- Fokusimin e shpenzimeve në sektorët prioritarë si punë publike, infrastrukturë, mirëmbajtje, arsim, shërbime sociale.
- Procedura buxhetimi të fokusuar tek produkti/rezultati, për çdo program.
- Ruajtjen të pandryshueshëm ose ulje të nivelit të shpenzimeve administrative në bazë të normimit të tyre.
- Zbatimin rigoroz të politikave kombëtare për përcaktimin e nivelit të shpenzimeve për pagë.
- Planifikimin e investimeve afatgjata dhe prioritare duke sjellë cilësi në rritje në dy drejtime:
- Vlerësimit e zgjedhjes së projekteve të investimeve duke mbajtur parasysh kërkesat më emergjente dhe të domosdoshme për plotësimin e nevojave të komunitetit sipas PBA 2023-2025, Planit të Përgjithshëm vendor.
  - Sigurimit të shpërndarjes me përparësi të investimeve në projekte të rëndësishme të bazuara në vlerësime dhe studime paraprake.
  - Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik kanë një shperndarje sipas tablees së mëposhtme.

**Tabela : Planifikimi i buxhetit 2023 sipas klasifikimit ekonomik.**

Tabela nr.22

Nr	Programi	Njesia Shpenzuese	Shpenz. Personeli	Shpenzime Operative	Shpenzime Korrente	F.Rezerve & Kontigjencia& Emergent	Shpenzime kapitale	Total 2023	Raporti ne % per secilin program kundrejt totalit te shpenzimeve
1	Administrata Vendore	2112001	55,293,412	34,868,373	90,161,785	6,000,000	500,000	96,661,785	18
2	Sherbimet e Policise Vendore	2112001	4,076,000	0	4,076,000	0	0	4,076,000	1
3	Rruge Rurale Bashkia	2112001	7,153,722	5,325,326	12,479,048	0	71,477,345	83,956,393	15
4	Furnizimi me Uje dhe Kanalizime	2112001	0	0	0	0	454,000	454,000	0
5	Bujqesia	2112001	4,979,772	4,770,317	9,750,089	0	0	9,750,089	2
6	Mjedisi Menaxhimi i Mbetjeve	2112001	759,081	459,715	1,218,796	0		1,218,796	0

	Bashkia							
7	Pyjet	2112001	3,408,709	437,100	3,845,809	0	3,845,809	1
8	Arsim Kultura	2112001	13,279,665	3,897,600	17,177,265	10,310,171	27,487,436	5
9	Menaxhim i Mbetjeve ASHP	<b>2112009</b>	22,499,653	16,160,000	38,659,653	2,507,834	41,167,487	8
10	Sherbimet Publike Vendore ASHP	<b>2112009</b>	50,789,846	29,754,875	80,544,721	42,773,151	123,317,872	23
11	Rinia sporti	2112001	2,620,004	6,552,171	9,172,175	0	9,172,175	2
12	Arsimi/Baze:	2112001	58,591,000	8,747,000	67,338,000	9,280,702	76,618,702	14
13	Arsimi/Mesem	2112001	3,871,144	3,421,565	7,292,709	0	7,292,709	1
14	MZSH dhe Mbrojtja Civile	2112001	14,433,514	5,388,486	19,822,000	3,000,000	0	22,822,000
15	UJITJE KULLIMI	2112001	3,672,776	7,474,224	11,147,000	4,941,000	16,088,000	3
16	RRUG RURALE ASHP	<b>2112009</b>	2,644,145	-	2,644,145	144,602	2,788,747	1
17	Shërbimet Sociale	2112001	0	0	0	1,209,000	1,209,000	0
18	Perkujdesi Social	2112001	4,928,000	4,782,000	9,710,000	0	9,710,000	2
19	Strehimi Social	2112001	700000	2,400,000	3,100,000	3,000,000	6,100,000	1
<b>totali</b>			<b>253,700,443</b>	<b>134,438,752</b>	<b>388,139,195</b>	<b>9,000,000</b>	<b>146,597,805</b>	<b>543,737,000</b>
								<b>100</b>

### **III.1 Shpenzimet kapitale**

Bashkia Patos vijon politikat e saj për kryerjen e investimeve mbështetur në planin 3-vjeçar të miratuar me PBA e vitit 2023-2025 nga Këshilli Bashkiak Patos, si dhe në projekt-planin e përgjithshëm vendor.

Ky plan ka në themel të tij kryerjen e investimeve në infrastrukturë në gjithë qytetin, duke mbajtur në vëmendje:

- Pritshmërinë e realizimit të shpenzimeve kapitale për vitin 2022,
- Analizën e performancës së kryerjes së investimit,
- Shkallën e ndikimit të pritshëm në zhvillimin ekonomik e social,
- Numrin e përfituesve nga zbatimi i investimeve,
- Shkallen e ndikimit në reduktimin e varfërisë ,
- Më shumë investime në sektorët prioritarë dhe të domosdoshëm për qytetin,
- Kosto për njësi të përcaktuara për investim.

Për vitin 2023 fondi total për financim nga burimet e veta te shpenzime kapitale është në shumën **146,597,805** lekë .

- Raporti midis shpenzimeve korente dhe atyre kapitale, arrin respektivisht në 73 % me 27% .
- Bashkia Patos vijon me politikat e saj për kryerjen e investimeve duke i rritur ato.

Tabela e shpenzimeve për investimeve 2023 krahasuar me vitin 2022.

në lekë

Tabela nr.23

Nr.	Programet	Plan 2022	Plan 2023
<b>1</b>	Shërbimi i Pastrimit	1,500,000	2,507,834
<b>2</b>	Shërbimet Publike Vendore	26,500,000	42,773,151
<b>3</b>	Ruge Rurale ASHP	0	144,602
<b>4</b>	Rinia dhe Sporti	1,500,000	0
<b>5</b>	Administrata Vendore	3,900,000	500,000
<b>6</b>	Shërbimet e Policisë Vendore	0	-
<b>7</b>	Sherbimet Sociale	0	1,209,000
<b>8</b>	Përkujdesi Social	0	0
<b>9</b>	Strehimi Social	0	3,000,000
<b>10</b>	Arsimi dhe Shërbimet Kulturore	1,367,000	10,310,171
<b>11</b>	Arsimi bazë dhe parashkollar	5,582,791	9,280,702
<b>12</b>	Arsimi i Mesem	0	0
<b>13</b>	Bujqësia, Blegtoria	0	0
<b>14</b>	Menaxhimi I Mbetjeve Mbrojtja e Mjedisit Bashkia	0	0
<b>15</b>	Adiministrim Pyje	0	0
<b>16</b>	Ujitje dhe Kullim	7,388,467	4,941,000

<b>17</b>	Ruge Rurale Bashkia	74,861,727	71,477,345
<b>18</b>	Furnizimi me ujë dhe kanalizime	0	454,000
<b>19</b>	Mbrojtja/shpetimi/Zjarri dhe emergjencat civile	1,100,000	0
	<b>Totali</b>	<b>123,699,985</b>	<b>146,597,805</b>

### **III.2 Shpenzimet Korente**

Shpenzimet korente të Bashkisë Patos për vitin 2023 parashikohen në shumën 397,139,195 lekë të cilat përbëjnë 73 % të totalit të shpenzimeve për këtë vit buxhetor.

Shpenzimet korente përbëhen nga:

- Shpenzimet për personelin administrativ dhe atë sektoriale,
- Shpenzimet operative për realizimin e funksioneve kryesore,
- Transfertat për njësite vartëse për kryerjen e funksioneve të shërbimeve,
- Shpenzime për kuatën e Qarkut, kuotën e Shoqates së Bashkisë,
- Shpenzime për mbeshtetje per familjet e pastrea,etj.
- Fondi rezervë, Emergjencës, dhe fondi i kontigjencës.

*Shpenzimet korente sipas programeve të Bashkisë Patos paraqiten në tabelën e mëposhtme:*

Tabela Nr. 24

*në lekë*

<b>Programi</b>	<b>Shpenz. Personeli</b>	<b>Shpenzime Operative</b>	<b>Totali</b>	<b>F.Rezerve&amp; Kontigjenca&amp;Emergent</b>	<b>Totali 2023 Korrente</b>
Administrata Vendore	55,293,412	34,868,373	90,161,785	6,000,000	96,161,785
Sherbimet e Policise Vendore	4,076,000	0	4,076,000	0	4,076,000
Ruge Rurale Bashkia	7,153,722	5,325,326	12,479,048	0	12,479,048
Furnizimi me Uje dhe Kanalizime	0	0	0	0	0
Bujqesia	4,979,772	4,770,317	9,750,089	0	9,750,089
Mjedisi	759,081	459,715	1,218,796	0	1,218,796
Pyjet	3,408,709	437,100	3,845,809		3,845,809
Arsim Kultura	13,279,665	3,897,600	17,177,265		17,177,265
Menaxhimi i Mbetjeve ASHP	22,499,653	16,160,000	38,659,653		38,659,653
Sherbimet Publike Vendore	50,789,846	29,754,875	80,544,721		80,544,721
Rinia sporti	2,620,004	6,552,171	9,172,175		9,172,175

Arsimi/Baze:	58,591,000	8,747,000	67,338,000		67,338,000
Arsimi/Mesem	3,871,144	3,421,565	7,292,709		7,292,709
MZSH dhe Mbrojtja Civile	14,433,514	5,388,486	19,822,000	3,000,000	22,822,000
UJITJE KULLIMI	3,672,776	7,474,224	11,147,000		11,147,000
RRUG RURALE	2,644,145	-	2,644,145		2,644,145
Shërbimet Sociale	0	0	0		0
Perkujdesi Social	4,928,000	4,782,000	9,710,000		9,710,000
Strehimi Social	700000	2,400,000	3,100,000		3,100,000
<b>totali</b>	<b>253,700,443</b>	<b>134,438,752</b>	<b>388,139,195</b>	<b>9,000,000</b>	<b>397,139,195</b>

### ***III.3 Shpenzime për Personelin***

Totali i shpenzimeve të personelit (paga dhe sigurime shoqërore dhe fond i veçantë) për të gjitha funksionet Bashkisë Patos per vitin 2023 është parashikuar në shumën **253,700,443** lekë ose 46.66% të shpenzimeve totale.

*Shpenzimet e personelit dhe përqindja sipas programeve kundrejt totalit të shpenzimeve të personelit të Bashkisë Patos paraqiten në tabelën e mëposhtme:*

Tabela Nr. 25

<b>Programi</b>	<b>Shpenz. Personeli</b>	<b>Pesha Specifike në %</b>
Administrata Vendore	55,293,412	21.79
Sherbimet e Policise Vendore	4,076,000	1.61
Rruge Rurale Bashkia	7,153,722	2.82
Furnizimi me Uje dhe Kanalizime	0	0.00
Bujqesia	4,979,772	1.96
Mqedisi	759,081	0.30
Pyjet	3,408,709	1.34
Arsim Kultura	13,279,665	5.23
Menaxhimi i Mbetjeve ASHP	22,499,653	8.87
Sherbimet Publike Vendore	50,789,846	20.02
Rinia sporti	2,620,004	1.03

Arsimi/Baze:	58,591,000	23.09
Arsimi/Mesem	3,871,144	1.53
MZSH dhe Mbrojtja Civile	14,433,514	5.69
UJITJE KULLIMI	3,672,776	1.45
RRUG RURALE	2,644,145	1.04
Shërbimet Sociale	0	0.00
Perkujdesi Social	4,928,000	1.94
Strehimi Social	700,000	0.28
<b>totali</b>	<b>253,700,443</b>	<b>100</b>

### ***III.4 Shpenzimet Operative***

Shpenzimet operative për vitin 2023 paraqiten në shumën **134,438,752** lekë, të cilat krahasuar me vitin 2022 kanë qenë në shumën 128,254,713 lekë, kanë një rritje 4.6%. Këto shpenzime përbëjnë 34 % të totalit të shpenzimeve korrente, dhe 24.72% të totalit të buxhetit për vitin 2023. Në thelb të planifikimit të shpenzimeve operative vazhdon të jetë racionalizimi i shpenzimeve administrative, duke vënë theksin në funksionet prioritare si dhe në qëllimin e përdorimit të tyre ku qartësisht vërehet se këto shpenzime shkojnë për realizimin e funksioneve kryesore të Bashkisë Patos.

### ***III.5 Fondi rezervë dhe kontigjencia III***

Në buxhetin e vitit 2022, Fondi rezervë dhe ai i Kontigjencës, nga burimet e veta të llogaritur sipas ligjit përmenaxhimin e sistemit buxhetor, arrijnë së bashku në shumën 6 000 000 lekë **Fondi rezervë dhe i kontigjencës përbëjnë 1.1% të totalit të buxhetit.**

#### ***Fondi Rezervë do të përdoret:***

Për financimin e shpenzimeve që nuk mund të parashikohen gjatë hartimit të buxhetit, me vendime të Këshillit Bashkiak. Për vitin 2023 kemi parashikuar 3,000,000 leke.

#### ***Fondi i Kontigjencës do të përdoret:***

Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuarë të programave ekzistuese, në rast se do të jetë e nevojshme gjithmonë me miratimin e Këshillit Bashkiak. 3,000,000 leke.

*Totali i shpenzimeve të Bashkisë Patos (korente dhe kapitale) në lekë, në nivel programi mbështetur në të ardhurat e veta paraqitet në tabelë e mëposhtëme :*

**KAPITULLI IV****PROGRAMET E ZHVILLIMIT TË QYTETIT**

Tabela Nr.26:

Nr	Programi	Total 2022	Total 2023
1	Administrata Vendore	99,899,853	90,661,785
2	Sherbimet e Policise Vendore		4,076,000
3	Rruge Rurale Bashkia	87,847,341	83,956,393
4	Furnizimi me Uje dhe Kanalizime		454,000
5	Bujqesia	9,606,886	9,750,089
6	Mjedisi Menaxhimi i Mbetjeve Bashkia	1,200,407	1,218,796
7	Pyjet	3,533,426	3,845,809
8	Arsim Kultura	18,297,212	27,487,436
9	Menaxhimi i Mbetjeve ASHP	35,593,648	41,167,487
10	Sherbimet Publike Vendore	105,424,487	123,317,872
11	Rinia sporti	11,153,319	9,172,175
12	Arsimi/Baze:	71,391,791	76,618,702
13	Arsimi/Mesem	7,391,528	7,292,709
14	MZSH dhe Mbrojtja Civile	16,747,000	19,822,000
15	UJITJE KULLIMI	16,367,176	16,088,000
16	RRUG RURALE	2,514,704	2,788,747
17	Shërbimet Sociale	10,495,222	1,209,000
18	Perkujdesi Social		9,710,000
19	Strehimi Social		6,100,000
	Fondi Rezerv/kontigjenc	6,000,000	6,000,000
	. Fond Emergjence	2,298,000	3,000,000
	<b>totali</b>	<b>505,762,000</b>	<b>543,737,000</b>

**PROGRAMI MENAXHIMI I MBETJEVE**

<b>Përshkrimi i programit</b>	Mbledhja, depozitimi i mbeturinave, trajtimi, pastrimi i rrugëve, shesheve, rrugicave, tregjeve, kopshteve publike, parqeve etj. Mbrojtja e ajrit dhe e klimës, mbrojtja e tokave dhe ujrate nëntokësore, reduktimi i zhurmave dhe vibracioneve si dhe mbrojtja ndaj rrezatimeve. Veprimtaritë dhe politikat për mbrojtjen mjedisore.
-------------------------------	---

<b>Qëllimi i Politikës së programit</b>	Politika e këtij programi konsiston: - në ofrimin me cilësi, sipas standardeve bashkëkohore dhe konform legjislacionit të shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin e bashkise, për të siguruar arritjen e normave dhe standardeve të qyteteve dhe fshatrave të zhvilluara. - Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve. Rritje e vazhdueshme në cilësinë e këtij shërbimi
<b>Objektivat e politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Përmirësimin dhe garantimin e shërbimeve publike (nëpërmjet aktiviteteve e nderhyrjeve) që sigurojnë:</li> <li>- shërbimin e largimit publik të mbeturinave,</li> <li>- mirëmbajtjen dhe menaxhimin e fushës së mbetjeve urbane</li> <li>- shtrirja e shërbimit të pastrimit edhe ne fshatra dy njësistë administrative, në zonat periferike dhe informale</li> <li>- rritja e cilësisë së ofrimit të shërbimit të pastrimit.</li> <li>- rritjen e numrit të kontenierve duke filluar dhe ndarjen që në burim të mbetjeve me qëllim riciklimin e tyre.</li> <li>- Edukim dhe ndërgjegjësim të komunitetit dhe biznesit në mbajtjen pastër të ambientit, pagesën e tarifës se pastrimit,</li> <li>- Të krijojë premisat për të prezantuar elementë të tjerë të trajtimit të mbetjeve nëpërmjet riciklimit</li> <li>- Mbajtja ne gadishmeri pune e mjeteve te ndërmarrjes.</li> </ul>
<b>Buxheti 2023</b>	Bashkia vazhdon ta ketë në prioritet edhe për vitin 2023 ofrimin me cilësi e sipas standardeve bashkëkohore të këtij shërbimi.  Buxheti i akorduar nga Bashkia për këtë program paraqitet në shumën <b>41,167,487</b> lekë ose 8 % e totalit të shpenzimeve.
<b>Njësia shpenzuese:</b>	Agjensia e Shërbimeve Publike

<b>Programi i Pastrimit</b>	<b>Plani 2022</b>	<b>Plani 2023</b>
<b>Shpenzime Korrente</b>	34,093,648	38,659,653
<b>Shpenzime Kapitale</b>	1,500,000	2,507,834
<b>TOTALI</b>	<b>35,593,648</b>	<b>41,167,487</b>

*Vështrim i përgjithshëm i Programit “Menaxhimi i Mbetjeve; Pastrimi i qytetit”.*

### **I.Shërbimi i pastrimit**

Agjencia e Sherbimeve Publike Bashkia Patos,shtrine sherbimet e saj per komunitetin ne tre Njesite administrative , ne qytetin e Patosit me rrithinat përreth,si dhe ne dy Njesitë adm. Zharrez dhe Ruzhdije, duke grumbulluar mbetjet urbane nga 330 kontinere te shperndare ne : njesine administrative Bashkia Patosit ,ne njesine administrative Zharrez, (Beline,Sheqishte,)ne njesine adm.Ruzhdije,gjithashtu grumbullohen mbeyje urbane 38 pika betoni shoqëruar me kontenier. Kryerjen e sherbimeve ne grumbullimin e mbetjeve urbane nga kontineret behet me dy mjete teknologjike , MAN. VOLVO te cilet gumbullojne mbetjet urbne nga kontineret, dhe dy mjete kamjon vetshkarkues BENZ qe grumbullojne mbetjet urbane nga pikat e grumbullimit Patos,Zharrez,Ruzhdije.Per vitin 2022 eshte planifikuar blerja e edhe 37 kontinereve te rinj si investim i vitit 2022. Blerja e kontinereve te rinj do te risë standartine e shërbimeve dhe parandalimin e ndojeve te ambjentit.

Ne Sek. e Manazhim mbetjeve , shërbimi I Pastrimit behet nga 41 punonjes. Ne sek., te Transportit menaxhimin e mbetjeve ubane kryhet me dy mjetet teknologjike dhe dy kajmon vetshkarkues BENZ, me 4 shofere dhe 9 punonjes te cilet shoqerojne mjetet. Kryehet sherbime me tre punonjes te Njesise dministrative Zharrëz duke grumbulluar mbetjet urbane ne çdo familje.

Funksioni i **Pastrimit** mbulon sherbimi me fshirje ne fshese rruga “Shetitorja e Republikes” rruga e Unazes, Ruget dytesore,” Koli Marku”, ”Demokracia”Ruga ,”Sotir Xoxe”,rruga e Varrezave,rruga e “Gani Banaj” Rrga e Çameve deri tek lagjja e Vreshtit si dhe rrugët e reja të rikonstruktua. Pastrohet nga mbeturinat anesoret e rrugeve, çdo dite pastrohen fshihen platformat e kontinereve nga Bashkia deri ne Rrugen e Fierit tek Policia. Për vitin 2022 kemi shtesë në fshirje me fshese një sip.prej 10800 m<sup>2</sup>,**12 km rruge**.

- Çështje kryesore për projektet dhe politikat e Programit**

Programi mbulon Menaxhimin e mbetjeve urbane,grumbullimi i mbetjeve urbane nga kontineret, dizinfektimi i tyre me klore dhe gelqere pluhur, menazhimi i rrugeve në fshirjen dhe pastrimin e tyre,te institucioneve, shesheve te pallateve,ne sherbimin dhe edukimin ambiental te qytetareve per një qytet te Paster..Prioritet ne sek, e Pastrimi eshte primate rritja e cilësisë së shërbimeve me standarde dhe parandalimin e ndotjes se ambjentit. Këto projekte do te japin :

.Jemi duke Zbatuar Planin e Menazhit të Integruara të Mbetjeve në bashkëpunim me Bashkine sipas njoftimeve që kemi marrë nga Ministria e Mjedisit .Mbetjet urbane shkarkohen ne inceneratorin Fier.Çdo gjë do të kryhet në zbatim të planit të miratuar,udhëzimeve nga Ministria e Mjedisit dhe ligjeve në fuqi për një menazhim sa më të mirë të mbetjeve.

c.Shtimin e siperfaqeve te shërbimit brenda Qytetit te Patosit ne 85% me rrithinat dhe shtrirjen me kontinere ne pikat e grumbullimit te mbetjeve ne Njesite Zharrez dhe Ruzhdije. Kjo sipas nje projekti te kryer nga ana e jone.

d.Te rrisim cilesine e sherbimeve ndaj komunitetit me moton për një “**Qytet te Pastër**”

dh.Të ndërgjegjësojmë qytetaret ne hedhjen dhe grumbullimin e mbetjeve urbane në pikat e caktuara.Programit perfshin kostot sipas funksioneve dhe aktivitetave sipas natyrës dhe klasifikimit ekonomik.

**- Strategja e zhvillimit afatmesëm synon të:**

- 1) Të Drejtojë zhvillimin territorial bazuar në planifikimin e shtrirjeve te hapësirave të reja; përfshirëse dhe të integruese, që do të garantojnë menaxhimin dhe kontrollin e territorit duke siguruar cilesi ne sherbime dhe ofruar kenaqesine qytetarëve.
- 2) Kordinojë vizionin ne zhvillimin e objektivave të planifikimit ne sherbime me vizionin dhe objektivat e përcaktuara sipas standardeve;
- 3) Vlerësojë potencialet ekzistuese asetet ne burime njerezore, financiare dhe e trupezuara te ndermarjes ne perpektivat territoriale;
- 4) Promovojë përmirësimin e cilesise se sherbimeve sipas standardeve të BE, veçanërisht për të mbështetur krijimin e një zone me uljen e ndotjes se ambjentit.
- 5) Promovojë mbrojtjen e mjesdit nga ndotja dhe degradimi, gjithashtu të promovojë rehabilitimin e zonave të ndotura në të gjitha zonat problematike të identikuara, në përputhje me standardet e BE

**- Sfidat kryesore të zhvillimit te programit:**

Rikualifikasi urban i qytetit rrit ndergjegjesimin si ndje ne realizimin e sfidave .

Krijimi i kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm në gjithë territorin e bashkisë, pasi vendbanimet dhe popullsia janë të shpërndara dhe bëjnë të vështirë ofrimin e sherbimeve.

## **II.Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve.**

Ky funksion konsiston ne ofrimin e sherbimeve publike qytetarve, bizneseve dhe gjithe komunitetit e gjithe teritorin administrative te bashkise e cila perben nje kollonat kryesore te buxhetit. Ai permblehdh disa aktivitete qe perbejne problemet jetike te komunitetit siç jane , grumbullimi dhe largimi i mbetjeve urbane nga pikat e grumbullimit,,pastrimi dhe fshirja e teritoreve qe menazhohen nga ndermarrja, dhe menaxhimi i mjeteve teknologjike qe jane ne funksion te menazhimit te mbetjeve urbane .Kryerjen e investimeve te nevojshme ne mire administrimin e mbetjeve urbane, krijimin e infrastruktureve se nevojshme por edhe ne blerjen e mjeteve te posacme per trajtimin e ketyre mbetjeve,pasi sherbimet publike ndikojne direkt ne cilesine e jetesës së qytetarëve.

**Shpenzimet operative të programit për vitin 2023:**

Tabela e mëposhtme paraqet shpenzimet operative për shërbimin publike (pastrim,menaxhim mbetjesh ):

<b>Shërbimet Publike</b>	<b>Plani 2023</b>	<b>Pesha specifike (%)</b>
Shpenzime Karburant +shpenzime për mjete(4 mjete transporti)	10,790,000	66.7 %
Shpenzime për pastrimin e qytetit+ menaxhim mbetjesh	5,230,000	32.3%
Për administratën	140,000	1%
<b>TOTAL</b>	<b>16,160,000</b>	<b>100%</b>

**Shpenzimet kapitale të programit për vitin 2023:**

Tabela e mëposhtme paraqet shpenzimet kapitale për shërbimin publike (pastrimit):

<b>Shërbimet Publike</b>	<b>Plani 2023</b>	<b>Pesha specifike (%)</b>
Konteniere për njësitë Zharrëz/Ruzhdie	1,500,000	60.0%
Remont mjetesh te medha	1,007,834	40.0%
<b>TOTA LI</b>	<b>2,507,834</b>	<b>100%</b>

**PROGRAMI SHËRBIMET PUBLIKE VENDORE**

<b>Përshkrimi i programit</b>	Programi i mirëmbajtjes urbane dhe rurale parashikon zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe pajisjen e tyre me të gjithë elementët e nevojshëm për mirëmbajtje ne vazhdueshmerine të rugëve kryesore, segmenteve rrugore dhe nyjeve si dhe rehabilitimin të rrugëve rurale, me qëllim sigurimin e një mqedisi bashkëkohor duke synuar jetëgjatësinë e investimeve ne infrastrukturre. Programi i gjelberimit parashikon zhvillimin,shtimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike te gjelberuara,si dhe pajisjen e tyre me të gjithë elementët e nevojshëm për sigurimin e një mqedisi të gjelbërt dhe bashkëkohor.Ky
-------------------------------	---

	program synon edhe mirëmbatjen e varrezave publike si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit.
<b>Qëllimi i Politikës së Programit</b>	Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e shërbimeve për mirëmbajtjen e infrastrukturës sipas standardeve bashkë kohorenë të gjithë komponentëve të saj, të shtrirë në të gjithë qytetin dhe periferite, me qëllim që t'iu mundësojë qytetarëve shërbim në kohe dhe sipas kërkesave për mirëmbajtje dhe zgjatje të kohes së investimit. Politike e këtij program do te jetë dhe mirëmbatja rurale funksion ky i cili mbulohej nga Qarku. Politika e këtij programi konsiston në ofrimin me cilësi, sipas standardeve bashkëkohore dhe konform legjislacionit të shërbimit të gjelberimit në të gjithë qytetin, për të siguruar arritjen e normave të qyteteve me tëzhvilluara për mirëmbajtjen dhe shtimin e sipërsaqeve të gjelbëruara publike, social kulturore e sportive.
<b>Objektivat e politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Ndërhyrjet komplekse në infrastrukturën rrugore nën dhe mbitokësore nëpërmjet shërbimeve në: <ul style="list-style-type: none"> <li>– mirëmbajte të rrugëve, trotuareve</li> <li>– mirëmbajte të objekteve arsimore, adminstrative</li> <li>– mirëmbajte të rrjetit të ndricimit,</li> <li>– mirëmbajtje të dekorit,</li> <li>– mirëmbajta e rrugëve Rurale</li> </ul> </li> <li>❖ Pëmirsësimin dhe garantimin e shërbimeve publike (nëpërmjet shpenzimeve operative) që sigurojnë: <ul style="list-style-type: none"> <li>– shtimin e hapësirave të gjelbra dhe mirëmbajtja e hapësirave ekzistuese,</li> <li>– shtimin dhe mirëmbatjen e lulishteve publike</li> <li>– shtimin e gjelbërimit rrugor duke mbjellë drurë të rinj e shkurre të reja si dhe duke zëvendësuar drurë e shkurre,</li> <li>– mirëmbajtjen e varrezave si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit.</li> </ul> </li> </ul>
<b>Buxheti 2023</b>	Buxheti i akorduar nga Bashkia për këtë program paraqitet në shumën <b>123,317,872</b> lekë një rritje prej 4.2 % e këtij programi krasuar me 2022. Totali i këtij programi zë 23 % të totalit të shpenzimeve.
<b>Njësité shpenzuese</b>	Agjensia e Shërbimeve Publike

<b>Shpenzime Korrente</b>	79,074,487	80,544,721
<b>Shpenzime Kapitale</b>	26,500,000	42,773,151
<b>Total</b>	<b>105,574,487</b>	<b>123,317,872</b>

**Vështrim i per gjithshem i Sektorit “Gjelbërimit dhe mirëmbajtje Varreza”.**

## **II.1 Gjelberimi i qytetit**

Shërbimi i gjelberimit të qytetit të Patosit do të realizohet nga Sektori i Gjelbërimit dhe Mirembajtja e Vorrezave Publike

- Mirëmbajtja dhe shtimi i hapësirave të gjelberta.**

Bashkia Patos dhe Agjencia e Sherbimeve Publike me Sek.e Gjelberimit dhe Mirembajtjen Varrezave, realizon sherbime ne 40 parcelave te Vorrezave ne tre njesite Administrative Bashkia Patos, Zharrez, Ruzhdije. Ky sek. realizon mirëmbajtjen dhe shtimin e hapsirave të gjelbra dhe lulishte, si dhe gjelbërimin rrugor dhe shtimin dhe zvendesimin me drure dekorativ te rindje ne lulishtet e qytetit .

Për përbushjen e këtij shërbimi Agjencia e sherbimeve Publike , nepermjet sek. te Gjelbërimi do të realizojë si çdo vit edhe për 2023 shërbimet si më poshtë :

- Mirëmbajtjen e lulishteve te shkurreve dekorativ pastrimin e tyre, krasitjen në një sipërfaqe **gjithsej sipërfaqe e gjelberuar per tu shërbuer 12.600 m<sup>2</sup>** duke pastruar, krasitur,punime me bel,prej nga vjen dhe rritja e kerkeses per baze material, vegla pune, paisje mjete korrese bari dhe lulesh .
- Mirëmbajtjen sipërfaqe të gjelbra në objekte shkollore e parashkollore(çerdhe, kopshte e shkolla) prej 4246 m<sup>2</sup> lulishte të gjelbëruara,
- Shërbimin e nevojshëm e mirëmbajtjen për 2397 drurë dekorative te llojeve te ndryeshme, ku kosiston ne blerjen e drureve decorative sipas preventivave me sasine dhe llojin e pemave dekorative si Manjola,kumbulla e kuqe, fotinje, ,blina, tunja, Dafine,Geshtenje,ligustra flete gjere, etj, Nje pjese e drureve sherbeu per zvendesimin e drureve te thare dhe nje pjese tjeter u mbollen ne lulishten përboll Gjermanit, ne rrugen e Kinemase vjeter Behet Mirembajtje e luleve e shkurre dekorative te ndryeshme rreth 5710 cop,ne lulishtet e qytetit, shkollave, parqeve, ne rrugen e Unazes me sherbimet si me poshte:krasitje, plehrim, sperkatje, punime.

## ***II.2 Mirëmbajtjen e varrezave të qytetit dhe fshatrave në juridikcionin tonë.***

Shërbimi i mirembajtjes se varrezave të qytetit të Patosit do të realizohet nga Ndërmarrja e Gjelbërimit dhe Vorrezave Publike .

Ky sherbim ofrojn mirembajtje dhe pastrim të vorrezave në Bashkinë Patos dhe 2 njesite Administrative në 40 parcela varezash. Me investimin e ri te bere nga Bashkia eshte shtuar dhe një parcel e re. mbi te cilën duhet nderhyre me mirembajtjen e saj. me pastrim te shkurreve dhe barerave me korrjen tre here ne vit., Pastrohen nga inertet ,ne gjithe sipërfaqet e vorrezave më një sipërfaqe 259 430 m<sup>2</sup>:

## ***III. Vështrim i përgjithshem i sektorit “Shërbimet Publike Vendore”.***

### **• *Mirëmbajtje e infrastrukturës rrugore***

Shërbimi i mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore në bashki realizohet nga Agjencia e sherbimeve Publike me Sek, Mirembatjes Urbane dhe Rurale.

Cilësia e këtij shërbimi është përmirësuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit, si rezultat i:

- mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve kryesore, segmenteve rrugore dhe nyjeve si dhe rehabilitimin e blloqeve të banimit dhe trotuareve.

Kjo Ndërmarrje, ka realizuar një analizë të detajuar te infrastrukturës për të përcaktuar:

- Gjendjen e rrugëve, trotuareve dhe infrastrukturës ndihmëse në to,
- Volumin e dëmtimeve dhe nevojën për mirëmbajtje për secilën rrugë,
- Përcaktimin e kostos për çdo njësi të ndërhyrjes.

Në përfundim të analizës, parashikohet që për vitin 2022, do të ndërhyhet me punime për:

- Mirëmbajtjen e rrugëve parësore dhe dytësore që përfshin: shtrime e riparime me asfalto-beton dhe rerë bituminoze, skarifikim, shtrime me çakull e stabilizant.
- Mirëmbajtjen e trotuareve që përfshin: sistemime të pjesshme me pllaka, asfalt dhe beton.
- Mirëmbajtjen e bordurave të lulishteve dhe të pemëve në trotuaret e rindës.
- Prodhime të betoformave për ndërhyrje të ndryshme,
- Mirëmbatje të godinave dhe objekteve arsimore,
- Mirëmbatje të rrjetit të ndricimit,
- Mirëmbatje të dekorit
- Mirëmbajtjen e makineri e paisje të inventarit.
- Mirembajtjen e institacioneve Arsimore dhe Shendetesore.

Agjencia e sherbimeve Publike për vitin 2022 ka kryer nderhyje per riparimin dhe mirembajtjen e rrugëve e troruareve ne lagje te ndryshme te Bashkise Patos si me poshte:

**Rikonstruksion te rrugeve me Asfalto beton**

Ne njesine Adm Bashkia Patos

Rruga Muskallaret

Lagjja 29 Marsi

Lagjja e Re Patos

Rruga e Gropallareve

Rruga anes perroit te Çobaneve

Sheshi Lagjja 1 Maj

Sheshi tek shkolla “M Gostinishti”

Rruga Menca 9

Ne njesine Adm Zharrez

Shen Maria Zhafajt

Keneta e Mitros

Degezimi tek Monkaj

Rruga Diellaraket

Rruga tek Pylli I Sheqishtes

Rruga njesia Adm, Zharrëz

Rruga e Belines

Njesia Adm Ruzhdije

Rruga e shkolles Ruzhdije

Rruga e Kuqar Rusinje

**Rikonstruksion rrugeve me Rere bituminoze**

Rruga “G.Bubeqi”

Rruga Rruga e Pompes

Rruga Belin Agjinature

Rruga binjaket Gjinoqare

Rruga Ervis Menca 9

Rruga Koçomil Ruzhdije

Rruga Menxharaj Gjinoqar

Rruga Gjinoqar Siqece

Rruga Gjinoqar Drenie

Rruga e brendshme Gjinoqar

Rruga Mekam Ruzhdije

Urat + Agjinaturat

Rruga 29 Marsi

Rruga e Gropallarve

Rruga e Albpetrolit

Rruga Bana

Rruga konfiskat Verbas

Për vitin 2023 do të riparohen, do të ndërohen dhe do të mirëmbahen trotuare me vlerë 3.000.000 leke si më poshtë;

Sipërfaqja totale e trotuareve do të jetë 980 m<sup>2</sup>

Trotuar në fshatin Zharrëz RR.QENDER 400 ml

Trotuar ne fshatin e RI(rr komune-Rr 7 Marti-98ml

Trotuar në fshatin e ri(rr Komune-rr7Marti 460 ml

Gjerësia e trotuareve do të jetë

Trotuar ne Lagjen 7 marsi-1.2-1.4m

Trotuar Komune –rr.7 Marti 2.3-2.5 m

Trotuar zharrez rr.QENDER

Numri i banoreve qe perfitojne eshte 860 qytetare

Trotuaret do te ndertohen me pllaka veteshternguese mbi shtrese cakulli te ngjeshur

Bordurat do te jene me dimensione 100cmx25cm15cm

Vlera per secilin trotuar do te jete:

Rruga qender 1.450.000

Rruga komune rr nacionale 350.000

Rruga 7 Marti 1.200.000

Punimet u kryen nga Agjencia e sherbimeve Publike me Sek, Mirembajtjes Urbane dhe Rurale

Synimi kryesore ne drejtim te sistemit rrugore urban dhe atij rural te Bashkise se Patosit do te jete : permiresimi dhe modernizimi i infrastrukturies rrugore urbane dhe infrastrukturies rrugore rurale duke mundesuar akses te plot te tyre ne sistemimin e infrastrukturies rrugore kombetare dhe nderkombetare. Tashme rrejti rrugore urban i qytetit lidhet me rrjetin kombetar rrugore nepermjete unazes kryesore te qytetit.

- **Mirembajtja e objekteve asimore dhe administrative**

Ky sherbim do ju mundësojë qytetarëve shërbim në kohe dhe sipas kërkesave për mirëmbajtje dhe zgjatje të kohes së investimit. Politike e këtij programi do te synoje në realizimin e mirembajtjes se objekteve ne kohe, dhe me një cilesi të mirë.

- Mirembajtja e ndriçimit rrugor dhe ndjekja e harxhimit të energjisë.**

Per vitin 2022 nevojat per ketë sherbim rriten per faktin e marrjes ne dorezim te objekteve te reja te cilat janë investuar nga Bashkia. Ky sherbim do ju mundësojë qytetarëve shërbim në kohe dhe sipas kërkesave për te arritur ne realizimin e mirembajtjes ne kohe reale. Politike e këtij programi do te synoje në uljen e kostos per kete sherbim deri në mbulimin me tarifen e ndricimit. Harxhimi i energjisë mbulon 32 kontrata gjithsej për ndricimin rrugor për bashkine dhe njesite administrative.

#### A Shpenzimet operative për vitin 2023:

Tabela e mëposhtme paraqitet shpenzimet operative për shërbimin e mirëmbajtjes urbane:

Shërbimet Publike	Plani 2023	Pesha specifike (%)
Shpenzime karburanti +mirëmbatje mjetesh	8,015,000	27.1 %
Shpenzime operative funksioni	21,382,747	71.7 %
Administrata	357,128	1.2 %
<b>TOTALI</b>	<b>29,754,875</b>	<b>100%</b>

#### Shpenzimet kapitale për vitin 2023:

Tabela e mëposhtme paraqet shpenzimet kapitale në vlerën **27,237,151** lekë për programin “Shërbimet Publike Vendore” :

Shërbimet Publike	Plani 2023	Pesha specifike (%)
Blerje Asfalto-Beton per shtrim rrugesh	35,236.000	82.3
Blerje Rere Bituminoze per shtrim rrugesh brendshme	6,056.676	14.5
Blerje Peme dekorative	980.475	2.3
Blerje Pajisje Pune	500.000	0.9

SHUMA	42,773.151	100%
-------	------------	------

**Projekti:****Ndërhyrjet dhe problematikat:**

<p><b>1.“Blerje baze materiale per shtrim rrugesh te brendshme me rere bituminoze”</b></p>	<p>Ky investim konsiston ne blerje baze materiale, transporti i materialeve si cakell, stabilizant dhe asfaltobeton per shtrimin e rrugeve. Punimet do te kryhen ne bashkepunim me Agjensine e Sherbimeve Publike. Objktivi kryesor eshte permiresimi i kushteve te infrastruktures per banoret te Njesive Administrative. Rruget qe do te shtrohen ndodhen ne Njesine Administrative Zharrez, Ruzhdie .            Ne vitin 2023: 6,056,676 leke            -Ne vitin 2024: 7,991,000 leke            -Ne vitin 2025: 7,991,000 leke  <b>Kohezgjatja e Projektit:</b> 3 vjet</p>
<p><b>2.Blerje baze materiale per shtrim rrugesh te brendshme me Asfalto Beton”</b></p>	<p>Ky investim konsiston ne blerje baze materiale, transporti i materialeve si cakell, stabilizant dhe asfaltobeton per shtrimin e rrugeve. Punimet do te kryhen ne bashkepunim me Agjensine e Sherbimeve Publike. Objktivi kryesor eshte permiresimi i kushteve te infrastruktures per banoret dhe urbanizimin e qytetit dhe Njesive Administrative.            Rruget qe do te shtrohen ndodhen ne Njesine Administrative zharrez, ruzhdie dhe ne brendesi te qytetit te Patosit.  <b>Vlera totale e parashikuar per kete projekt:</b> 2023-2025 <b>83,236,000</b> leke me financim si meposhte:            -4,236,000 vazhdimi i financimit për vitin 2022.            -Ne vitin 2023: 31,000,000 leke            -Ne vitin 2024: 24,000,000 leke            -Ne vitin 2025: 24,000,000 leke  <b>Kohezgjatja e Projektit:</b> 3 vjet            Emertimi i rruges Gjatesi (ml)            Rruga Mjeraka 250</p>

Rruga tek Baftjar Bani	340
Rruga tek Daut Grembi	640
Rruga tek burimi I Xanes M.Matohiti	440
Rruga Cobanet Zharrez	305
Rruga Kryqezim-Alit Gjeriti	380
Rruga Deshmoret e Prishtines	190
Rruga Dhimiter Deda	560
Rruga Ferrajt	450
Rruga Fitorja (Agim Hoxha)	70
rruga Anes perroit Frasher	1160
Rruga Pone	225
Rruga Vazhdim I Halit Gjeritit-Rezervuar	1540
Rruga Keneta e Mitros-Pellumbaj	135
Rruga Lejleket	370
Rruga Luigj Gurakuqi	670
Rruga Naun Nasi Vazhdim i Muskallareve	130
Rruga Ramis Aranitasi	190
Rruga Koceqet-Pelaret	1125
Rruga qender Gjinoqar	900
Rruga Sotir Xoxe degezim	120
Rruga Laberia	250

### **PROGRAMI RRUGËT RURALE ASHP**

<b>Përshkrimi i programit</b>	Rrugë rurale parashikon zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe pajisjen e tyre me të gjithë elementët e nevojshëm për mirëmbajtje ne vazhdueshmerine të rugëve kryesore, segmenteve rrugore dhe nyjeve si dhe rehabilitimin të rrugëve rurale,me qëllim sigurimin e një mqedisi bashkëkohor duke synuar jetëgjatësinë e investimeve ne infrastrukturre. Marrja e masave për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural të njësisë vendore;
<b>Qëllimi i Politikës së programit</b>	Politike e këtij program do te jetë dhe mirëmbatja rurale funksion ky i cili mbulohej nga transferta e pakushtezuar sektoriale.
<b>Objektivat e politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Ndërhyrjet komplekse në infrastrukturën rrugore nën dhe mbitokësore nëpërmjet sherbimeve në:           <ul style="list-style-type: none"> <li>– mirëmbatja e rrugëve Rurale</li> </ul> </li> </ul>
<b>Buxheti 2023</b>	Buxheti i akorduar nga Bashkia për këtë program paraqitet në shumën <b>2,788,747</b> lekë.Buxheti përbëhet nga transferta e pakushtezuar sektoriale në vlerën 2,003,000 dhe 785,747 nga të ardhurat e Bashkisë. Totali i këtij programi zë 1 % të totalit të shpenzimeve.

**Njësitë shpenzuese**

Agjensia e Shërbimeve Publike

<b>Programi</b>	<b>Plani 2022</b>	<b>Plani 2023</b>
<b>Shpenzime Korrente</b>	2,514,704	2,644,145
<b>Shpenzime Kapitale</b>		144,602
<b>Total</b>	<b>2,514,704</b>	<b>2,788,747</b>

#### **IV. Vështrim i përgjithshem i Programit “Rruget Rrurale”.**

Ky program në bazë udhëzimit të PBA-së 2023-2025 nga Ministria e Financave përfshin edhe të gjitha investimet në infrastrukturë dhë për këtë arsy ne e kemi ndarë këtë programi në 2 (dy) njësi shpenzuese , në njësinë shpenzuese Bashkia Patos dhe njësinë shpenzuese Agjensia e Shërbimeve Publike ku kemi vendosur kryesisht shpenzinmet që janë nga transferta specifike për këtë program. Synimi kryesore ne drejtim te sistemit rrugore urban dhe atij rural te Bashkise se Patosit do te jete : permiresimi dhe modernizimi i infrastruktures rrugore urbane dhe infrastruktures rrugore rurale duke mundesuar akses te plot te tyre ne sistemimin e infrastruktures rrugore kombetare Tashme rrjeti rrugore urban i qytetit lidhet me rrjetin kombetar rrugore nepermjete unazes kryesore te qytetit.

#### **PROGRAMI SHËRBIMET REKREATIVE DHE SPORTIVE**

<b>Përshkrimi i programit</b>	Programi per rinin do te ofroje sherbime specifike ne lidhje me a)informimin dhe keshillimin per rinin per sherbimet ne shkolla,edukim,per formim professional,etj, b)vlersimin e nevojes per mbeshtetje te te rinjeve,c)kordinimin e grupeve rinore te shkollave ne qytetin e Patosit me aktivitet ne ambjentet e Stadiumit “Alush Noga”Bashkerendim me sektorin e sherbimeve sociale,shendetesore e te sportit per nxitjen e aktiviteve me te rindj.
<b>Qëllimi i Politikës së Programit</b>	Politika e këtij programi synon nxitjen, zhvillimin dhe përhapjen e kulturës sportive në qytet, nëpërmjet organizimit projekteve sportive me moton “ <i>të jetojmë me sportin</i> ”.
<b>Objektivat e politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Organizimi i aktiviteve sportive dhe rekreacionale, zhvillimi dhe administrimi i institucioneve dhe objekteve që lidhen me ushtrimin e këtij funksioni.</li> <li>❖ Tërheqjen drejt programeve sportive të të gjithë komunitetit e veçanërisht rininë.</li> <li>❖ Riorganizimi i sportit në shkolla, si bazë për</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ përcaktimin e sporteve prioritare,</li> <li>❖ Mbrojtjen, forcimin dhe shpalosjen e identitetit të qytetit në drejtim të sportit,</li> <li>❖ Hartimin e programeve duke zhvilluar politikat lokale të rinisë e sportit,</li> <li>❖ Krijimi i tryezës sportive për të nxitur e zhvilluar shkencën dhe profesionalizmin në sport,</li> <li>❖ Krijimi i kushteve të përshtatshme të infrastrukturës sportive,për zhvillimin e sportit në të gjitha kategoritë.</li> <li>❖ Rritja e kategorisë së ekipit të futbollit të bashkisë</li> <li>❖ Përmirësimi i kushteve të strukturave dhe terreneve sportive</li> </ul>
<b>Buxheti 2023</b>	Buxheti i akorduar nga Bashkia për këtë Program, për vitin 2023, paraqitet në shumën prej <b>9,172,175</b> lekë dhe përbën 2 % të totalit të shpenzimeve.
<b>Njësitë shpenzuese</b>	<b>BASHKIA PATOS</b>

<b>Programi i Rinise dhe Sportit</b>	<b>Plani 2022</b>	<b>Plani 2023</b>
<i>Shpenzime Korrente</i>	9,653,319	9,172,175
<i>Shpenzime Kapitale</i>	1,500,000	
<b>TOTALI</b>	<b>11,153,319</b>	<b>9,172,175</b>

#### *V. Vështrim i përgjithshem i Programit “Rinia dhe Sporti”.*

Programi per rinin do te ofroje sherbime specifike ne lidhje me a)informimin dhe keshillimin per rinin per sherbimet ne shkolla,edukim,per formim professional,etj, b)vlersimin e nevojes per mbeshtetje te te rinjeve,c)kordinimin e grupeve rinore te shkollave ne qytetin e patosit me aktivitet ne ambjentet e Stadiumit “Alush Noga”Bashkerendim me sektorin e sherbimeve sociale,shendetesore e te sportit per nxitjen e aktiviteteve me te rijn.

Pjesa e programit per te rinine dhe sportit do te jete organizimi i përvitshem i aktivitete sportive dhe zhvillimi i sportit ne komunitet.keto aktivitete do te zhvillohen sipas tradites qe ndihqet per cdo vite nga shkollat e qytetit te Patosit me aktivitete sportive kulturore etj.

Nepermjet programit per rinine dhe sportin do te mbeshteten administrimi dhe funksionimi i Klubit shumesportesh “Albpetrol Patos”,si dhe do te mbeshteten disiplina te ndryshme.

Pjese perberese e programit ne mbeshtetje te sportit te futbollit eshte mbeshtetja dhe financimi i ekipeve zinxhire te grupemoshave te ndryshme qe jane pjesa e ekipit te futbollit “Albpetrol Patos”.Me qellim rritjen e pjesemarrjes se te rinjeve ne aktivitete sportive dhe zhvillimin e sportit ne komunitet synojme organizimin e programit “Jeto me Sportin”keto aktivitete do te zhvillojnë

traditen ku te rinte dhe te rejat e shkollave te Qytetit te Patosit konkurojne midis shkollave dhe te garojne mes tyre ne mbeshtetje te Klubit Sportiv “Albpétrol Patos”.

- **Dialogu me Tifozet**

Qellimi kryesor do te jete krijimi i dialogut dhe bashkepunimit nepermjet kater aktoreve kryesore:

- 1-FSHF
- 2-Bashkia Patos
- 3-Tifozet e ekipeve “Albpétrol”
- 4-Aktoret e jashtem(policia etj.)

Nepermjet ketij dialogu dhe bashkepunimi, aktivitetet sportive do te kene keto perfitime si me poshte:

- Afrimi ne stadium sa me shume sportdashes, vecanerishte te familjeve dhe femrave.
- Organizimi i nje grapi pune, me pjesemarrjen e paleve mbeshtetesve dhe te aktoreve kryesore.
- Permisim i pervojes ne stadium, per te gjithe aktoret e ndeshjeve(tifozet, klub, policia, etje).

**Shpenzimet operative të programit për vitin 2023:**

Planifikimi i shpenzimeve Operative ne Projekt Program te Buxhetit per vitin 2023, i referohemi shpenzimeve operative faktike te vitit 2022,sipas PBA 2023-2025, mbi shpenzimet qe mbulojme per aktivitetet e Klubit Sportiv Albpétrol mbi zhvillimin e sportit ne komunitet me moton “Jeto me Sportin” per Qytetin te Patosit.

Shpenzimet operative të këtij programi konsistonë në mbështetjen financiare për funksionimin të klubit sportive në qytetin e Patosit për të kaluar në Kategorinë e Parë, duke siguruar:

- trajtimin ushqimor për sportistët,
- shpenzimet për honorare, dieta udhëtime, uniforma etj,
- mbështetjen financiare të klubeve në aktivitetet,
- shpenzimet për administrimin e klubeve,
- nxitja dhe organizimi i projekteve të ndryshme sportive duke i mbështetur financiarisht,
- financimin e projekteve sportive për të gjithë aplikuesit dhe pjesëmarresit që organizojnë aktivitete sportive që përbushin funksionin e politikat e programit të Bashkisë së Patos.

Shpenzimet operative për sportin paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Shërbimet Rekreative dhe Sportive	Plani 2023	Pesa specifie (%)
Shpenzime karburanti + benzinë(autobuzi+paisje mirmbjtjen e fushës)	703,000	10.7

Siguracione, shërbime autobuze + siguracion mjeti	362,000	5.5
Kuotëpjesëmarrje, antarësimi, rregji i futbollistëve, volejbollisteve, stafit, kartona të kuq + verdhe, të tjera penalitetë	690,000	10.5
-Veshmbathje + medikamente	450,000	6.9
-Mjete stervitore	100,000	1.5
- Shpenzime udhetime dieta për administratën	50,000	0.8
-Shpenzime për fazë e parë, kupa e Shqipërisë, fazë përgatitore faza e dyte	1,730,106	26.4
Trajtimi i sportistëve me ushqim	2,023,000	30.9
Shpenzime lëngje	90,000	1.4
Mirembajtje te fushes se stadiumit dhe aneksit	200,000	3.1
Materiale pastrimi	50,000	0.8
Aktivitete boksi	104,065	1.6
<b>TOTAL</b>	<b>6,552,171</b>	<b>100</b>

### **PROGRAMI I ADMINISTRATËS VENDORE**

<b>Përshkrimi i programit</b>	Ky program parashikon menaxhimin financiar të Bashkisë Patos dhe përfshin shpenzimet e nevojshme administrative për funksionimin normal të administratës vendore si dhe shpenzimet për nevojat e ushtrimit të kometencave të veta.
<b>Qëllimi i Politikës së Programit</b>	Politika ekëtij programi konsiston në përmirësimin e funksionimit dhe të menaxhimit të Bashkisë Patos për të arritur qëllimin që të vëmë në themel të shërbimeve konsiderimin e “qytetarit-klient”. Në zhvillimin e kapaciteteve menaxhuese për garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të burimeve njëzore dhe përdorimit me efektivitet të burimeve financiare të Bashkisë.
	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Përmirësimi i menaxhimit dhe përdorimit të fondeve publike me trasparencë, efiçencë, ekonomike dhe implementimin e zhvillimin e një sistemi bashkëkohor e të qëndrueshëm për kontrollin e brendshëm financiar, me një shërbim të pavarur e funksional të auditimit të brendshëm,</li> </ul>

<b>Objektivat e politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>❖ Hartimin e planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal</li><li>❖ Hartimi dhe propozimi i ndryshimeve në politikën fiskale, me qëllim mbështetjen e vazhdueshme të rritjes ekonomike të qytetit,</li><li>❖ Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike,</li><li>❖ Mbëshetje për nxirese zhvillimin e biznesit te vogël nepermjete veprimitarive</li><li>❖ Ndërtimin e një sistemi efektiv të programimit buxhetor, mbi bazë programesh, për të gjitha institucionet buxhetore,</li><li>❖ Krijimi i një institucioni eficient, ku të përmirësohen në vazhdimësi aftësitë e stafit drejtues, kapacitetet institucionale dhe teknike, me qëllim administrimin korrekt të fondeve,</li><li>❖ Përmirësimi në vazhdimësi i aftësive drejtuese të stafit të Bashkisë Patos dhe niveleve të tjera të vendimmarrjes në varësi të saj</li><li>❖ Organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomike vendor</li><li>❖ Të asistohen dhe nxiten tatimpaguesit në mënyrë që të likuidojnë detyrimet në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor, duke siguruar që të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, të shkojnë për llogari të buxhetit të Bashkisë,</li><li>❖ Të sigurohet zgjerimi i bazës së taksueshme, rritja e numrit të taksapaguesve, dhe reduktimi i elementeve të evazionit,</li><li>❖ Forcimi i auditimit mbi bazën e riskut,</li><li>❖ Për një shërbim të ndershëm, të plotë dhe cilësor për biznesin dhe qytetarët,</li><li>❖ Krijimi i sistemit të informacioni, nëpërmjet informatizimit dhe lidhjes online ndërmjet strukturave bashkiake dhe bankave të nivlet të dytë, si dhe për ofrimin e shërbimit ndaj taksapaguesve, në mënyrë elektronike,</li><li>❖ Fushata informative dhe sensibilizuese për ndërgjegjësimin e publikut për detyrimet ligjore ndaj Bashkisë,</li><li>❖ Organizimi i trajnimeve me stafin e ri dhe atë ekzistues,</li><li>❖ Përmirësimi i ambjenteve të punës për punonjësit e Bashkisë,</li><li>❖ Mirëmbajtja e sistemit kompjuterik dhe faqes së</li></ul>
--	---

	internetit të Bashkisë Patos për pasqyrimin me transparencë të punës, ♦ Forcimi i kontrollit mbi territorin urban në fushën e ndërtimeve, të veterinarisë, të kontrollit ushqimor dhe atij të qëndrave e shërbimeve komunitare.
<b>Buxheti 2023</b>	Për vitin 2023 ky program do të financohet në shumën prej <b>96,661,785</b> lekë ose 18 % të totalit të shpenzimeve. Ky program për vitin 2023 ka pësuar një ulje prej 10 %.
<b>Njësitë shpenzuese</b>	Bashkia Patos .

<i>Programi i Administratës Vendore</i>	<i>Plani 2022</i>	<i>Plani 2023</i>
<i>Shpenzime Korrente</i>	101,999,853	96,161,785
<i>Shpenzime Kapitale</i>	3,900,000	500,000
<b>TOTALI</b>	<b>105,899,853</b>	<b>96,661,785</b>

## **VI. Vështrim i përgjithshem i Programit “Administrata Vendore”**

- Situata e njësisë së vetëqeverisjes vendore**

Bashkia Patos është pjesë e Qarkut Fier dhe ka një sipërfaqe prej 82.5 km<sup>2</sup>, me qendër qytetin e Patosit. Ajo kufizohet në veri dhe në lindje nga bashkia e Roskovecit, në jug me bashkinë e Mallakastrës dhe në perëndim me bashkinë e Fierit. Kjo bashki përbëhet nga dy njësi administrative, të cilat janë: Zharrëza dhe Ruzhdia. Bashkia e Patosit, në bazë të statistikave të vitit 2021 sipas Censusit regjistronte 22.959 banorë dhe densitet prej 278.3 b/km<sup>2</sup>, ndërsa sipas Regjistrat të Gjendjes Civile në vitin 2021 rezulton 42,015 banorë.

Aktualisht Bashkia Patos ka perfunduar dhe eshtë gati për zbatimin Planit të PërgjithshëmVendor i financuar nga Qeveria Qëndrore .

**Ky Plan reflekton investimet që do të ndërmerrin për 15 vitet e ardhshme, duke u ndarë në 5 fazë 3 vjeçare, kjo ndarje ka si qëllim që të lidhë projektet e PPV me fazat e planeve buxhetore afatmesëm.**

- ♦ Çështje kryesore për projektet dhe politikat e bashkisë.

Duke pasur parasysh situaten e qeverisjes vendore është përgatitur një listë të investimeve që kanë më shumë prioritet dhe janë më shumë të nevojshmë për rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe rritjen urbane të qytetit. Këto projekte do te jasin zgjidhje te integruar te projekteve te largimit te ujërave te ndotura, kanalizimeve dhe rehabilitimit/ndërtimit te akseve te infrastrukturës.

- ***Informacion financiar kryesor***

Bashkia Patos sipas programeve të miratuara nga IFP-ja ka shpërndarë tavane buxhetore në 19 programe. Programet kanë të përfshirë funksione dhe aktivitete sipas natyrës dhe klasifikimit ekonomik.

**Shpenzimet operative për vitin 2023:**

Këto shpenzime paraqiten me rritje në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022. Këto shpenzime përfshijnë:

- Aparatit të Bashkisë Patos, me drejtore përbërëse të saj.
- Aparati i Njësisë Administrative Zharrëz
- Aparati i Njësisë Administrative Rruzhdije
- Inspektoriatit të Ndërtimit,

Brenda zërit të shpenzimeve operative të Aparatit të Bashkisë përfshihen:

- shpenzime për zhvillimin ekonomik, ku përfshihen shpenzimet për të gjitha aktivitetet në ndihmë të zhvillimit të bizneseve të qytetit, për mirëmbajtjen e rrjetit kompjuterik, mirëmbajtjen e sistemit te Taksave “TAIS” dhe Financave Vendore “FAIS” etj.
- shpenzime të funksionimit të institucionit,
- shpenzimet për pritje perciellje delegacioni të huaj,
- realizimi i pagesës së pagave dhe sigurimit shoqëror të nëpunësve dhe punonjësve të administratës.
- plotësimi kërkesave dhe përmirësimi i kushteve për punë normale në Administratë .
- sigurimi i materialeve e shërbimeve nga të tretët .
- sigurimi i lëvizjes së nëpunësve dhe realizimi shpenzimeve të transportit.
- mirëmbajtja e mjeteve të transportit dhe paisjeve të zyrate nëpërmjet shpenzimeve për mirëmbajtje të zakonshme.
- shpenzime për zbatimin e vendimit nr.265 dt 12.02.2020 të vendimit gjyqësor për Bankersin
- realizimi i shpenzimeve të tjera operative të përballuara nga fondi rezerv,fondi i kontigjencës dhe fondi për Këshillin e Qarkut, kuoten e antarësimit ne shoqatën e Bashkive.
- realizimi i shpenzimeve të tjera operative.

Totali i këtyre shpenzimeve administrative paraqitet në tabelën e mëposhtme:

<b>Shpenzime administrative + Fondi I Rezervës,Kontigjencës</b>	<b>Plani 2023</b>	<b>Pesha specifike (%)</b>
Materiale të përgjithshme funksionimi	2,605,000	6.4
Shpenzime ndaj të treteve (ujë,energji,telefon, sherbim postar etj)	4,460,000	10.9
Materiale pastrimi	300,000	0.7
Mirembajtje,sherbim per pajisje informatike dhe sistemi i rregjistrat elektronik	455,000	1.1
Shpenzime gjyqësore	2,000,000	4.9
Shpenzime transporti	3,960,000	9.7
Mirembajtje per Programin e Financave Vendore "FAIS"+"TAIS"	700,000	1.7
Shpz.per zbatimin e vendimit nr.265 dt 12.02.2020 të vendimit gjyqesor për Bankersin	12,532,510	30.7
<u>Fond Emergjence, Rezerve dhe Kontigjence</u>	6,000,000	14.7
Kuota e Qarkut	500,000	1.2
Kuota e antaresimit ne Shoqaten e Bashkive	300,000	0.7
Buxheti per Keshillin dhe Kryepleqte e Fshatrave	4,300,000	10.5
Hipotekime +Sh.per vleresimin e Objekteve te cert.nga Hipoteka+Sherbime kadastrale	1,800,000	4.4
Shpenzime udhetime dhe dieta brenda vendit	300,000	0.7
Shpenzime udhetime dhe dieta jashtë vendit	100,000	0.2
Shpenzime Trajnimi për Administratën	150,000	0.4
Shpenizme për Komision Vlerësimi në Administratë	100,000	0.2
Shpenzime per zbatimin e planit per integritetin dhe antikorupsonin	305,863	0.7
<b>SHUMA</b>	<b>40,868,373</b>	<b>100</b>

**Shpenzimet kapitale për vitin 2023:**

Në buxhetin e vitit 2023 kemi paraqitur me kërkesat buxhetore PBA 2023-2025 nevojat për paisje zyre dhe informatike, me vlerën 500 000 lekë duke qenë se është bërë rikonstruksioni i njësisë Administrative Zharrëz dhe është parashikuar rikonstruksioni i njësisë Administrative Ruzhdie del si domosdoshmeri për mobilim dhe përshtatja me sistemet e reja të tekonologjisë së informatike të punës:

**Ndërhyrjet dhe problematikat**

<i>1.Paisje zyre dhe pajisje informatike për një infrastrukturë sa më bashkëkohore për administratën.</i>	<p>Projekti parashikon prodhimin e mobiljeve per zyrat e Njësive Administrative dhe sipas sektoreve specifike që kanë nevojë duke qënë rinnovimi i pajisjeve informative është domosdoshmëri për tju përshtatur proceseve të reja teknologjike të punës. Punimi i mobiljeve konsiston ne përdorimin e materialeve të qëndrueshme dhe në mënyrë të tillë që të sigurojnë komoditet dhe produktivitet më të lartë në punën e punonjësve. Ky projekt synon përmirësimin e infrastrukturës publike. Përfituesit do të janë specialiste, pergjegjes e drejtora te drejtorive perkatese dhe njësive Administrative. Perveç kesaj, përfitues janë edhe qytetaret e Bashkisë Patos të cilet do të marrin një sherbim më cilesor. Pajisjet informatike synojnë përshtatjen me sistemet e reja të informacionit me të cilat punohet në punën e përditshme dhe të cilat kërkojnë pajisje të reja që të përdoren dhe në këtë mënyrë të sigurojnë komoditet dhe produktivitet më të lartë në punën e punonjësve</p> <p>Vlera e zbatimit të projektit: 500,000 leke  Kohëzgjatja e projektit: 3 muaj , Brenda vitit 2023  Financimi me buxhetin e vitit.</p>
---	--

**PROGRAMI I SHËRBIMET E POLICISË VENDORE**

<b>Përvetësime i programit</b>	Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve policore që janë të nevojshme për kryerjen e funksioneve në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike, parandalimin dhe zbulimin e informalitetit brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Masa të njësisë së vetëqeverisjes vendore për të rritur besimin e qytetarëve dhe marrëdhënien e njësisë me komunitetin. Për qëllime bashkëpunimi njësia vendore planifikon aktivitete të cilat ndihmojnë në ofrimin e shërbimeve sa më afér kërkesave dhe nevojave të qytetarëve.
<b>Qëllimi i Politikës së Programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sigurimi i mbrojtjes, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror;</li> </ul>

<b>Objektivat e politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Forcimi i kontrollit mbi territorin urban në fushën e ndërtimeve, të veterinarisë, të kontrollit ushqimor dhe atij të qëndrave e shërbimeve komunitare.</li> <li>❖ Ekzekutimi dhe zbatimi i akteve të nxjerra nga Kryetari i Njësisë dhe i vendimeve të Këshillit të Njësisë.</li> <li>❖ Sigurimi i mbrojtjes, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë</li> </ul>
<b>Buxheti 2023</b>	Për vitin 2023 ky program do të financohet në shumën prej <b>4,076,000 lekë</b> ose 0.5 % të totalit të shpenzimeve.Ky program është shtuar për herë të parë për vitin 2023 si program më vete.
<b>Njësitë shpenzuese</b>	Bashkia Patos .

<b>Programi i Shërbimeve të Policisë Vendore</b>	<b>Plani 2022</b>	<b>Plani 2023</b>
<i>Shpenzime Korrente</i>	0	4,076,000
<i>Shpenzime Kapitale</i>	0	0
<b>TOTALI</b>	<b>0</b>	<b>4,076,000</b>

Programi Shërbimet e Policisë Vendore u hap shtuar për herë të parë si program më vete buxhetor për tju përshtatur nevojave, për të bërë një matje sa të më mirë funksioneve që ka Policia Vendore në mirëfunksionimin dhe ofrimin e shërbimeveve sa më afér kërkeseve të qytetarëve.

Policia Bashkiake është angazhuar tërësisht për të zbatuar sa më mirë detyrat që i ngarkon ligji nr.8224, datë 15.05.1997 për Organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës (i ndryshuar), Vendimet e Këshillit Bashkiak, të KRRT-së si dhe aktet e nxjerra nga Kryetari i Bashkisë.

Puna e deritanishme ka qenë rezultative dhe roli i kësaj policie, si forcë ekzekutive në ndihmë të ushtrimit të funksioneve të organeve dhe strukturave të Bashkisë, është i rëndësishëm.

Vecanërisht me kalimin e biznesit të vogël në Bashki dhe dhënies të kompetencave Policisë Bashkiake me ndryshimet në Kodin Rrugor si dhe ato që priten të merren në të ardhmen, puna e Policisë Bashkiake merr dimension të gjërë.

Puna e policisë bashkiake ka synuar:

Në zbatimin e Vendimeve të Këshillit Bashkiak, të KRRT-së dhe akteve të Kryetarit të Bashkisë për mbarëvajtjen e punëve publike, sigurimin e rendit e qetësisë në veprimtaritë që zhvillon bashkia, në ruajtjen e pronës së bashkisë dhe atyre që administrohen prej saj.

Në kontrollin e vazhdueshëm të territorit për të mos lejuar shkeljet ligjore për zënien e hapësirave publike apo tregti e paligjshme (ambulantë), vendosjen e reklamave, tendave, dëmtimin e sipërfaqeve të gjelbra, trotuareve, ndricimit publik, ndotjen e mjedisit etj si dhe ndëshkimin e kundravajtësve me gjobë.

Në parandalimin, pezullimin dhe prishjen e ndërtimeve pa leje. Me ngritjen e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik në Bashki, policia bashkiake ka detyrë të mbështesë Inspektoratin në zbatimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje, objekte që kanë penguar punimet në infrastrukturën rrugore, në blloqet e banimit të miratuara me Vendime të KRRT-së, ndërtime pa leje në fasada, shkallë, mure rrethues, etj.

Në shlyerjen e taksave e tarifave vendore nga subjekte juridik e fizik që nuk kanë respektuar afatet ligjore apo nuk janë regjistruar fare si subjekte. Për këtë, në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë, është angazhuar një efektiv i cili ka mbështetur në mënyre të vazhdueshme Inspektorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore për zbatimin e detyrës së tyre dhe kjo ka rezultuar e efektshme.

Duke qenë organ ekzekutiv, policia bashkiake ka zbatuar Urdhrat administrativ të Kryetarit të Bashkisë për lirimin e objekteve që janë pronë e bashkisë, kopshte, biblioteka, ish uzina, ndërmarrje etj të zëna nga persona të ndryshëm në mënyrë abuzive. Për të gjitha rastet është ndjekur procedurë e plotë.

Në bazë e për zbatim të detyrave që i jepen Policisë Bashkiake me ndryshimet e bëra në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, është krijuar Sektori i Qarkullimit Rrugor. Të drejtat e Policisë Bashkiake janë kryesisht për konstatimin dhe ndëshkimin e shkeljeve në drejtim të parkimit të automjeteve ndërqytetëse që nuk respektojnë kërkesat e ligjit, për rregullimin e trafikut kur ka ceremoni apo veprimit bashkiake, etj.

Për realizimin e detyrave nga ky sektor, i rëndësishëm ka qenë bashkëpunimi me Drejtorinë e Transportit dhe Lëvizshmërisë së Bashkisë Tiranë. Pavarësisht kërkesave dhe kontakteve, mbetet që të sigurohet një bashkëpunim efikas me policinë rrugore të shtetit për probleme të ndërsjellta.

Në marrjen, ndjekjen e zgjidhjen e kërkesë-ankesave të qytetarëve dhe subjekteve të ndryshme shtetërore e private të sjella nëpërmjet Zyrës së Informimit Qytetar, Qendrës Operatore të Bashkisë ose telefonatave në Zyrën e Informacionit të Policisë Bashkiake. Kjo detyrë realizohet

nga Inspektorët që mbulojnë Njësitë Bashkiake, nga grupet e Gatshme si dhe nga Grupi i Natës. Duhet theksuar se ankesat e shumta të qytetarëve apo subjekteve të ndryshme për prishje të qetësisë nga lokalet e natës, është e vështirë të përballohen, jo vetëm për mungesë të efektivit e mjeteve që disponohen, por edhe për mangësitë ligjore (përplasjen e disa institucioneve për të njëjtën shkelje zhurmat etj). Në mënyrë periodike është bashkëpunuar me Agjencinë Rajonale të Mjedisit dhe Policinë e Qarkut). Me daljen e VKM ku përcaktohen oraret e ushtrimit të veprimtarisë nga lokalet e natës, situata ka përmirësim.

Bashkëpunimi me Sektorin e Emergjencave Civile ka qenë i vazhdueshëm, sepse është detyrim ligjor i Policisë Bashkiake që rrjedh nga neni 8 i ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 për Organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës (i ndryshuar). Policia Bashkiake ka qenë e gatshme dhe i ka dhënë ndihmën e saj qytetarëve në raste fatkeqësie (zjarre, përmbytje etj).

### **PROGRAM SHËRBIMET E KUJDESIT PARËSOR DHE SOCIAL**

#### **Përshkrimi i programit**

- Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktivitetave edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qëndrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

<b>Qëllimi i Politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vështrim i përgjithshëm Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor; Sigurimi i kujdesit shëndetësor për të gjithë individët dhe familjet.</li> </ul>
<b>Buxheti 2023</b>	Bashkia Patos finançon programin për vitin 2023 me <b>1,209,000</b> lekë. Ky program zë 0.5 % të totalit të shpenzimeve.
<b>Njësitë shpenzuese</b>	Bashkia Patos

Programi Shërbimet e Kujdesit Parësor	Plani 2022	Plani 2023
<i>Shpenzime Korrente</i>	10,495,222	0.000
<i>Shpenzime Kapitale</i>		1,209,000
<b>Total</b>	<b>10,495,222</b>	<b>1,209,000</b>

Shpenzimet janë parashkikuar me ulje sepse është bërë rishpërndarja e tyre në dy programet e reja buxhetore që janë hapur për vitin 2023, konkretisht programi Përkujdesi Social dhe Shërbimet Sociale. Aktivitetet kryesore të parashikuara për t'u realizuar gjatë 2023 janë: Rritja e numrit të aktiviteteve, temave dhe pjesëmarrësve për informim dhe edukim të kujdesit parësor dhe social

Përmirësimi i mbulimit me shërbim të kujdesit parësor dhe social në të gjithë territorin e bashkisë Patos.

Përmirësim i infrastrukturës në qendrat shëndetësore (base materiale).

<b>1.Permiresim i infrastrukturës ne qendrat shëndetësore(base materiale)</b>	<p>Ky investim konsiston ne blerjen e bazes materiale per permiresimin e infrastrukturës ne qendrat shëndetësore</p> <p><b>Perfituesit nga ky projekt Jane:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjithe banoret e zones.</li> </ul> <p><b>Vlera totale e parashikuar per kete projekt: 13,000,000 leke me financim si meposhte:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Ne vitin 2022: 500,000 leke</li> <li>-Ne vitin 2023: 400,000 leke</li> <li>-Ne vitin 2024: 400,000 leke</li> </ul> <p><b>Kohezgjatja e Projektit:</b> 1 vit</p>
---	---

### PROGRAMI PËRKUJDESI SOCIAL

<b>Përshkrimi i programit</b>	<p>Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Dhënia e ndihmës në para dhe në natyrë për personat e moshuar, për të lehtesar jetën e tyre të përditshme, integrimin në jetën shoqërore dhe për të siguruar akomodimin e tyre. Ofrimi i asistencës në para dhe në natyrë, për të dhënë mbrojtje shoqërore për familjet, fëmijët. Ndërtim dhe administrim i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. Mbulimi i kostove për ofrimin e shërbimit të çerdhes pranë njësive vendore për fëmijët e moshës nga 0 deri në 3 vjeç. Ofrimi i përfitimeve në para dhe në natyrë për të siguruar mbrojtje shoqërore për personat e papunësuar; marrja e masave për të riintegruar personat e papunë në tregun e punës dhe për të zvogëluar rrezikun e papunësisë të grupeve të veçanta.</p>
<b>Qëllimi i Politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfitime në para dhe në natyrë për familjet që kanë fëmijë në kujdestari; Përfitime në para, si pagesa për nëna me fëmijë, grante për lindje, përfitime për kujdes për prindërit, pagesa për fëmijët ose familjare, pagesa të tjera periodike apo të menjëherëshme për të mbështetur familjet ose për t'i ndihmuar ato të përballojnë kostot e nevojave specifike (për shembull, familjet me një prind të vetëm ose familjet me fëmijë të paaftë). Mbështetje të pjesshme për faturën e energjisë elektrike dhe konsumin e ujit dhe shërbimet sanitare;</li> <li>• Ndihmë financiare, asistencë për pagesën e një kujdestareje që kujdeset për fëmijët gjatë ditës;</li> <li>• Strehë dhe ushqim dhënë fëmijëve dhe familjeve në mënyrë të përhershme (jetimore, familje kujdestare etj.);</li> </ul>

- Mallra dhe shërbime dhënë në shtëpi fëmijëve ose atyre që kujdesen për ta;
- Shërbime dhe mallrat e ndryshme dhënë familjeve, të rinjve ose fëmijëve (qendra pushimi ose zbavitjeje);
- Administrim, organizim ose mbështetje të skemave të mbrojtjes shoqërore;
- Shpenzimet për mbulimin e shërbimit të çerdheve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë shoqërisht të përjashtuar ose në rrezik për përjashtim shoqëror (si personat në skamje, me fitime të ulëta, imigrantë, indigenë, refugjatë, abuzues me alkoolin dhe droga, viktima të dhunës kriminale etj.);
- Përfitime në para, si kompensim page dhe pagesa të tjera për personat e varfër ose të dobët, për të ndihmuar në lehtësimin e varfërisë ose në situata të vështira;
- Përfitime në natyrë, si strehë afatshkurtër dhe afatgjatë dhe vakte ushqimi dhënë personave të varfër dhe të dobët, shërbime dhe mallra për të ndihmuar personat, si këshillim, strehim ditor, ndihmë për të kryer punët e përditshme, ushqim, veshje, lëndë djegëse etj.;
- Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të ndihmës ekonomike dhe pagesën për personat me aftësi të kufizuar;
- Përfitime monetare ose në natyrë, si asistencë për detyrat e përditshme për personat përkohësisht të paaftë për punë për shkak sëmundjeje ose dëmtimi (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.);
- Përfitime monetare ose në natyrë për personat që janë plotësisht ose pjesërisht të paaftë të merren me veprimitari ekonomike ose të bëjnë një jetë normale për shkak të një gjyntimi fizik ose mendor;
- Përfitime në natyrë, si: vakte ushqimi që u jepen personave të paaftë në ambjente të përshtatshme, ndihmë që u jepet personave të paaftë për t'i ndihmuar në detyrat e përditshme (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.), pagesë ditore për personin që kujdeset për personin e paaftë, trajnim profesional e trajnim tjetër i dhënë për të nxitur rehabilitimin në punë dhe atë shoqëror të personave të paaftë, shërbime dhe përfitime të ndryshme dhënë personave

	<p>të paaftë, për të marrë pjesë në veprimtari kulturore dhe zbavitëse ose për të udhëtar apo për të marrë pjesë në jetën e komunitetit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Administrim, venie në funksionim ose mbështetje për skema të mbrojtjes shoqërore.</li> <li>• Administimi dhe mirëmbajtja e qendrave rezidenciale për të moshuarit;</li> <li>• Përfitime në para dhe në shërbime kundrejt rreziqeve të lidhura me moshën e tretë (humbje e të ardhurave, mungesë pavarësie në kryerjen e detyrave të përditshme, pjesëmarrje e ulur në jetën shoqërore dhe komunitare etj.);</li> <li>• Administrim dhe organizim ose mbështetje të skemave të tillë të mbrojtjes shoqërore.</li> <li>• Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë të aftë për punë, të disponueshëm për punë, por janë të paaftë të gjejnë punësim të përshtatshëm;</li> <li>• Pagesa për grupe pjesë në forcën e punës që marrin pjesë në skemat e trajnimit që kanë për qëllim të zhvillojnë potencialin e tyre për punësim, kompensime për humbje të punës, pagesa të tjera periodike apo të menjëhershme për të papunët, në veçanti për të papunët afatgjatë;</li> <li>• Përfitime në natyrë, si pagesat për lëvizje dhe zhvendosje;</li> <li>• Trajnim profesional për personat pa punë ose ritrajin për personat që rrezikojnë të humbin vendin e punës;</li> <li>• Akomodim, ushqim ose veshje dhënë personave të papunë dhe familjeve të tyre;</li> </ul>
<b>Objektivat e politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të sensibilizojmë komunitetin për dhunën në familje dhe të drejtat e fëmijëve</li> <li>• Të mbështesim dhe riintegrojmë viktimat e dhunës në familje dhe fëmijëve në nevojë për mbrojtje</li> <li>• Të krijojmë hapësira për strehim afatshkurtër të viktimate të dhunës në familje/fëmijëve në nevojë për mbrojtje</li> <li>• Të informojmë individët/familjet në vështirësi</li> </ul>

	<p>ekonomike mbi shërbimet shoqërore ekzistuese</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tëmbështesim dhe riintegrojmë individët/familjet në vështirësi ekonomike</li> <li>• Të mbështesë financiarisht familjet të cilat nuk janë përfituese në sistemin e ndihmës ekonomike</li> </ul>
<b>Buxheti 2023</b>	Bashkia Patos financon programin për vitin 2023 me <b>9,710,000</b> lekë. Ky program zë 2 % të totalit të shpenzimeve. <b>Program i ri.</b>
<b>Njësitë shpenzuese</b>	Bashkia Patos

<b>Programi</b>	<b>Përkuqdesi</b>	<b>Social</b>	<b>Plani 2022</b>	<b>Plani 2023</b>
<i>Shpenzime Korrente</i>			0	9,710,000
<i>Shpenzime Kapitale</i>			0	0
<b>Total</b>			<b>0</b>	<b>9,710,000</b>

Aktivitetet kryesore të parashikuara për t'u realizuar gjatë 2023.

janë:

1. Aktivitete sensibilizuese mbi dhunën në familje dhe të drejtat e fëmijëve
2. Transport per viktimat e dhunës
3. Transport për fëmijët në nevojë për mbrojtje
4. Paketa ushqimore për viktimat e dhunës në familje
5. Paketa ushqimore për fëmijët në nevojë për mbrojtje
6. Ekspertë të jashtëm(psikolog të caktuar nga gjykata) për vlerësimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje
7. Paketa ushqimore për individë/familje në vështirësi ekonomike

\*\*Mbështetje me pagesë cash (në zbatim të VKM-së nr 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” për familjet në nevojë socio-ekonomike të cilat nuk janë përfituese të sistemit të ndihmës ekonomike dhe nuk janë të përfshira te fondi 6% nga fondet e MSHMS

8. Pagesë cash për familjet jo përfituese në sistemin e ndihmës ekonomike.

<b>PROGRAMI STREHIMI SOICAL</b>	
<b>Përshkrimi i programit</b>	Strehim i përshtatshëm për njerëzit në nevojë, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social.
<b>Qëllimi i Politikës së programit</b>	Rikonstruksioni i banesave me kushte të papërshtatshme për grupet e pafavorizuara dhe trajtim me bonus qeraje. Rimbursimi I familjeve të pastreha për bonus qiraje në zbatim të Ligjit nr.22/2018 ''Për strehimin social
<b>Objektivat e politikës së programit</b>	Strehim i përshtatshëm për njerëzit në nevojë, ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social.  Rimbursimi I familjeve të pastreha për bonus qiraje në zbatim të Ligjit nr.22/2018 ''Për strehimin social.
<b>Buxheti 2023</b>	Bashkia Patos finançon programin për vitin 2023 me <b>6,100,000</b> lekë. Ky program zë 1 % të totalit të shpenzimeve. Program i ri.
<b>Njësitë shpenzuese</b>	Bashkia Patos

<b>Programi Përkujdesi Social</b>	<b>Plani 2022</b>	<b>Plani 2023</b>
<i>Shpenzime Korrente</i>	0	31000,000
<i>Shpenzime Kapitale</i>		3,000,000
<b>Total</b>	<b>0</b>	<b>6,100,000</b>

Aktivitetet kryesore të parashikuara për t'u realizuar gjatë 2023. janë:

1. Përfitime në natyrë për të ndihmuar familjet të përballojnë koston e strehimit;

2. Ndërtim dhe administrim i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
3. Pagesa të kryera në mënyrë të përkohshme ose afatgjatë për të ndihmuar qiramarrësit për koston e qirasë;
4. Administrim i çështjeve dhe shërbimeve të strehimit; promovim, monitorim dhe vlerësim i veprimitarive për zhvillimin e strehimit;
5. Të ardhura në para për grupe të ndryshme familjarësh dhe individësh në nevojë;
6. Përfitimet në para, si mbështetje për të ardhurat dhe pagesa të tjera në para për personat e varfër dhe vulnerabël me qëllim uljen e varférissë ose për të asistuar në situata të vështira;

\*Rimbursimi I familjeve të pastreha për bonus qiraje në zbatim të Ligjit nr.22/2018 ”Për strehimin social”

Apartamenti Që u takon	Numri i familjeve	Qiraja mujore mesatare	Rimbursim nga Bashkia 50%
Numri i familjeve 3+1	9	10000	5000
Numri i familjeve 2+1	33	8000	4000
Numri i familjeve 1+1	27	6000	3000
Numri i familjeve gazoniere	37	5000	2500
Shuma Totale mujore	106 familje		

#### **PROGRAMI I ARSIMIT DHE SHËRBIMET KULTURORE**

Përshkrimi i programit	Organizim, mbështetje e ngjarjeve kulturore në njësinë e vetëqeverisjes vendore; mbrojtje dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore.
------------------------	---

<b>Qëllimi i Politikës së Programit</b>	Ti japë një dimension të ri dhe më të plote jetës artistike dhe kulturore të qytetit tonë jo vetëm duke u mbështetur në projektet ekzistuese, të cilat po kthehen në një traditë për qytetin tonë, por edhe duke dhënë hapësira të reja për projekte të tjera inovative të cilat do te vijnë pranë Bashkisë Patos nga persona të tretë, shoqëria civile apo ente të tjera kombëtare. Ky program do të tentojë të promovojë vlerat kulturore të qytetit.
<b>Objektivat e politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Gjallerimin e jetes kulturore dhe artistike te qytetit, ruajtjen dhe transmetimin e vlerave historike, kulturore dhe artistike</li> <li>❖ Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrim i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve;</li> <li>❖ Mbështetja e vendeve historike, kopshteve zoologjike dhe botanike;</li> <li>❖ Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i bibliotekave, e i ambienteve për lexim me qëllim edukimin e përgjithshëm qytatar;</li> <li>❖ Mbështetje për muzeumet, galeritë e arteve, teatrot, sallat e eksposítave;</li> <li>❖ Organizim ose mbështetje për ngjarjet kulturore (koncerte, prodhime skenike dhe filma, shfaqje artistike etj.);</li> <li>❖ Sigurim i shërbimeve kulturore; administrim i çështjeve kulturore; mbikëqyrje dhe rregullim i strukturave kulturore;</li> <li>❖ Organizim i aktiviteteve kulturore dhe promovim i identitetit kombëtar e lokal.</li> </ul>
<b>Buxheti 2023</b>	Buxheti i akorduar nga Bashkia Patos për këtë Program, për vitin 2023 paraqitet në shumën prej <b>27,487,436</b> lekë. Ky program zë 5 % të totalit të shpenzimeve.
<b>Njësitë shpenzuese</b>	Bashkia Patos . Drejtoria Arsimit Kulturës dhe Trashegimise Kulturore

<b>Programi i Arsimit dhe Kultures</b>	<b>Plani 2022</b>	<b>Plani 2023</b>
<b>Shpenzime Korrente</b>	16,930,212	17,177,265
<b>Shpenzime Kapitale</b>	1,367,000	10,310,171
<b>Totali ;</b>	<b>18,297,212</b>	<b>27,487,436</b>

## **VII. Vështrim i përgjithshem i Programit “Arsimit dhe Shërbimet Kulturore”**

Programi mbulon strukturat kulturore dhe organizon ose mbështet ngjarjet kulturore në bashki.

- Vë në funksionim ose mbështetje, teatrot, sallat e eksposítave.

Prodhim, organizim ose mbështetje për ngjarjet kulturore (koncerts, prodhime skenike dhe filma, shfaqje artistike etj.)

**Qëllimi:**

Plotësimi i infrastrukturës së objekteve social-kulturore për zhvillimin cilësor të veprimtarive social-kulturore dhe organizimi i veprimtarive artistike-kulturore-sociale me përfshirje në të gjithë territorin e Bashkisë Patos

**Objektivat:**

1. Edukimi i brezit të ri nëpërmjet projekteve kulturore dhe nxitja e talenteve te reja në gjini të ndryshme të artit
2. Gjallërimi i jetës kulturore-artistike nëpërmjet gjithpërfshirjes së moshave, niveleve sociale, arsimore, përfaqësimit gjinor dhe komuniteteve
3. Sigurimi i infrastrukturës kulturore e sociale për tërheqjen e komunitetit drejt artit e kulturës.
4. Rritja e cilësisë së veprimtarive artistike, kulturore dhe promovimit të turizmit.

**Shpenzimet operative të programit për vitin 2023**

Kemi një rritje të shpenzimeve për këtë program për vitin 2023 në krahasim me vitin 2022, duke planifikuar me shumë projekte kulturorë të cilat do të janë në shërbim dhe të datave historike përvjetore por dhe në shperndarje me të drejtë të shpenzimeve ndërmjet programeve sipas natyrës së shpenzimit dhe përshtatjes me programin përkatës.

• *Materiale për pastrim, dezifikim 50 000 lekë*

Në këtë zë janë përfshirë të gjitha materialet për pastrim, disifikim e ambienteve të Pallatit të Kulturës dhe Klubit të Pensionistëve.

• *Baze materiale për organizimin e aktivitetave të Pallatit të Kulturës dhe QKF-së 100 000 lekë*

Përfshin materiale për organizimin e aktivitetave të ndryshme gjatë vitit bateri, fisha mikrofoni, medaljone sportiv, kupa artistike dhe sportive, certifikata për stimulimin e fituesve të konkurseve të ndryshme artistike, letrare dhe turizmin gjatë vitit. Përfshihen dhe shpenzimet përgatitjen e ftesave për institucionet e pushtetit qendror, organizatave të huaja dhe vendase me të cilat bashkëpunojmë (PNUD, RELOAD, Bashkitë e Forta etj) për festat lokale. Përgatitja e broshurave dhe guidave për atraksionet turistike të zonës si dhe përgatitjen e certifikatave të vlerësimit nga Kryetarja e Bashkisë për figura me kontributë në qytet apo mësues të dalluar.

• *Stimulimi financiar i nxenesve ekselente(fitues te olimpiadave kombetare &maturanteve me medalje,kampionateve sportive) te Bashkise Patos 200.000 leke*

Në këtë zë përfshihen shpenzimet financiare për shpërbirim të nxënësve fitues të olimpiadave kombëtare ose me medalje ari në maturë shtetërore si dhe fitues të kampionateve sportive kombëtare.

- **Veshje e stolave të Pallatit të Kulturës 1,010 171lekë**

Përfshihen shpenzimet financiare për riparimin e 200 stolave të dëmtuar të sallës së kinemasë me sfunjjer, dërrasë dhe veshje nikeliti .

- **Aktivitete të jashtme 1 800 000lekë**

Në këtë zë është parashikuar organizimi i veprimtarive të ndryshme artistike, kulturore që do të paraqiten nga producent, organizator eventesh ose persona fizik dhe do të financohen nga Bashkia sipas procedurave ligjore .

- **Organizimin e programit kulturor-artistik dhe turizmin 1 947 600 lekë** të cilat do të përfshijnë projektet e mëposhtme:

**Projekt 1. Pasurimi i bibliotekës me libra artistik për të rritur dhe promovimi i talenteve në letërsi**

**Shpenzimet financiare për projektin 120.000lekë:**

Numri i lexuesve në bibliotekën tonë është në rritje 800 lexues të rritur dhe 453 lexues të vegjël. Ky pasurim është i domosdoshëm pasi kërkesat e lexuesve janë për librat artistik të rinj. Duam të theksojmë që në bibliotekë ka shumë libra të dëmtuar dhe të vjetër( me letër të zverdhur, të grisur dhe me baktere pasi nuk janë dizifektuar asnjëherë).

-Në ditën botërore të poezisë(muaji Mars) Biblioteka Publike e qytetit do të organizojë një konkurs me pjesë të përzgjedhura nga autorë të ndryshem, midis shkollave 9-vjeçare.

-Aktiviteti “ Dita botërore e letërsisë përfshirë (muaji Prill) me temë “ **Fran Ukcama dhe krijimtaria e tij**” do të zhvillohet me shkollat 9-vjeçare të Bashkisë Patos.

-Gjate muajit të letërsisë(muaji Tetor) Biblioteka Publike Patos do të zhvilloj konkursin me poezi midis shkollave të mesme të qytetit me poze të shkrimitarëve të rilindjes.

**Shënim:**Në listën e lartë përmendur të librave gjatë kohës titujt e librave ndryshojnë, sepse qëllimi i bibliotekës është pasurimi i bibliotekës me libra të rinj. Vlefta e lekut nuk ndryshon.

**Projekt 2.**Organizimi i ceremonive zyrtare dhe përkujtimore të datave të shënuara historike e **10shkurtit** (Aksioni i Patosit), **29Marsit** (beteja e Margelliçit),**5Maii** (Dita e Dëshmorëve), **3nëntorit**(Batalioni i Sheqistes)dhe **28-29Nëntorit** (Shpallja e Pavarësisë dhe Çlirimi i Atdheut) si dhe eveneteve te ndryshme që organizon Bashkia. Këtu përfshihen blerjet e kurorave me lule si dhe luleve të freskëta përfshirë homazhe në bustet ,lapidarët dhe pllakatat përkujtimore të heronjve dhe dëshmorëve të luftës si dhe per t'u dhuruar personalitetev te ndryshem që vijne per vizite, mesuesve te vjeter ne pension si dhe drejtuesve te shkollave per festen e 7-marsit.  
**Shpenzimet financiare per projektin 120.000lekë**(buqeta dhe kurora me lule)

**Projekti 3.“Jo vetëm lule !”**–do të organizohet me rastin e 7-8marsit, festës së mësuesit dhe gruas. Ky projekt eshte konceptuar si një format me gra te profesioneve te ndryshme te qytetit

dhe njesive administrative per te vlerësuar kontributin e tyre si dhe rritjen e perfaqesimit gjinor ne shoqeri.

**Shpenzimet financiare për projektin: 300.000lekë:**Aktivitet

- Aktiviteti(dreke) 200 000lekë
- Programi muzikor 50 000lekë
- Blerje lulesh 50 000lekë

**Projekt 4. “Në skenën e Teatrit”**– do të organizohen gjatë vitit në Pallatin e Kulturës.Në këtë projekt përfshihet përgatitja dhe vënia në skenë e shfaqjeve teatrale nga Pallati i Kulturës me talentet e qytetit, festivali teatrор i shkollave të mesme dhe teatër me kukulla.

**Shpenzimet financiare per projektin:300.000leke**

**1.Vënie në skenë e shfaqjeve teatrale 150.000 leke**

Blerje e bazes materiale per kostumografine & skenografi	80 000lekë
Blerje e teksteve të shfaqjeve teatrale	20 000lekë
Stimulimi i aktoreve	50 000lekë

**2.Festivali teatral me shkollat e mesme 150.000 leke**

Bazë materiale për kostumografi dhe skenografi

**Projekt 5.“Kupa Neki Abazi”**- Aktivitet sportiv i boksit do të organizohet në Pallatin e Kulturës me pjesëmarrjen e ekipeve të Patosit, Fierit, Durrësit dhe Tiranës. Do të përfshihet ceremonia e vlerësimit të sportistëve të kësaj disipline të qytetit tonë në vite.

**Projekt 6. “Maratona e qytetit”** – Do të organizohet për herë të dytë në qytetin tonë pas suksesit dhe interesit të treguar nga pjesëmarrja në këtë aktivitet sportiv.Aktiviteti ka si qëllim sensibilizimin e qytetarëve të moshës mbi 16 vjeç për pjesëmarrje. Këtë herë do të ketë shpërbirim finansiar për vendet e I, II dhe III në të dy kategoritë vajza dhe djem.

**Shpenzimet financiare: 67.600 leke**

Vendi i parë 15 000lekë x 2 – 30 000lekë
Vendi i dytë 10 000lekë x 2 – 20 000lekë
Vendi i tretë 5 000lekë x 2 – 10 000lekë
Bazë materiale (kupa, certifikata)- 7 600 lekë

**Projekt 7.”Beteja e lirisë”** – aktivitet kushtuar 79-vjetorit të Betejës së Margëlliçit.Do të organizohen një sërë aktivitetesh artistike gjatë kësaj dite të rëndësishme historike të gjithë zonës sonë. Pas ceremonisë zyrtare të vendosjes se kurorave me lule pranë lapidarit në Margëlliç do të organizohet aktivitet (koktej me veteranët).

**Shpenzimet financiare për projektin : 50 000lekë**

Aktiviteti (koktej me veteranët)

**Projekt 8.“Brez pas brezi myzeqar!”**Festa e e Njësisë Zharrëz organizohet gjatë muajit shtator për promovimin dhe trashëgiminë e vlerave etnografike, muzikore, folklorike dhe produktet e kësaj zone.

***Shpenzimet financiare për projektin :150.000leke:***

Këngëtar popullor 100 000lekë

Materiale per dekor 10 000leke

Aktivitet(koktej) 40 000lekë

**Projekt 9.”Mirënjohje thinjave tuaja!”**I dedikohet moshës së tretë prindërve dhe gjyshërvë tanë. Do të jetë një ditë e veçantë përkushtuar mundit dhe sakrificës së tyre në 1 Tetor Ditën Ndërkombëtare të Moshës së Tretë.

***Shpenzimet financiare per projektin :40.000leke:***

Aktivitet(koktej)

**Projekt 10.”Sofra bujare”**-Festa e Njësisë Ruzhdie organizohet ne 20 tetor. Promovimi dhe reklamimi i ullirit(varieteteve) dhe vajit të tij si dhe punimet artizanale, trashëgimine e vlerave etnografike, muzikore, folkloriketë kësaj zone.

***Shpenzimet financiare për projektin :150.000leke:***

Këngëtar popullor 100 000leke

Bazë materiale për panairin 10 000leke

Aktivitet (koktej) 40 000leke

**Projekt 11.”Ti Shqipëri më jep nder!** ”aktivitet kushtuar festive të 28-29 Nëntorit. Në këtë projekt do të përfshihen aktivitete të ndryshme historike , letrare e muzikore ku do të përfshihen të gjitha moshat në sheshin qendror të qytetit ku do të ndërthuren elementet letrar dhe muzikor.

***Shpenzimet financiare për projektin:50.000lekë***

-Koktej me veteranet

**Projekt 12.”Këngët e rinisë”** – Koncert recital me këngëtar dhe grupe muzikore të rinj i cili do të organizohet në 8dhjetor në Ditën e Rinisë.

***Shpenzimet financiare per projektin:200.000lekë***

Shpenzimet për grupin muzikor i cili do të përzgjidhet nga stafi sipas preferencave e të rinjve të qytetit.Do të organizohet në sheshin qendror para Pallatit te Kulturës.

**Projekt 13. “Nga mot gëzuar Vitin e Ri 2024!”** –Koncert festiv me rastin e festës së Vitit të Ri i cili do të mbledh të gjithë nxënësit e dalluar në procesin mësimor-edukativ të shkollave 9-vjecare të qytetit dhe fshatrave të Bashkisë Patos për të cilët do të përgatitet një dhuratë .

***Shpenzimet financiare : 300.000lekë***

-Blerje e dhuratave për nxënësit e dalluar të shkollave 200nxënës x 1.000lekë -200.000lekë

-Blerje e lodrave për fëmijët e kopshteve të qytetit 100.000lekë

Në tabelën e mëposhtme paraqiten shpenzimet operative për programin e arsimit:

<b>Shpenzime për Arsimin dhe Shërbimet Kulturore</b>	<b>Plani 2022</b>	<b>Pesha specifike (%)</b>
Projekte artistike	1,947,600	50.0%

Aktivitete të jashtme	1,800,000	46.1%
Material për mbarevajtjen e aktiviteteve + QKF	100,000	2.6%
Materiale pastrimi	50,000	1.3%
<b>SHUMA</b>	<b>3,847,600</b>	100%

**Shpenzimet kapitale të programit për vitin 2023:**

Në tabelën e mëposhtme paraqiten investimet për paisje programin e arsimit:

Shpenzime për arsimin	Plani 2023	Pesha specifike (%)
<ul style="list-style-type: none"> <li>Veshje e stolave të sallës së Kinemasë</li> <li>Rikonstruksion dhe mobilim per sallen e konferencave</li> <li>Reabilitim I shtresave të mbuleses se Pallatit te Kultures</li> </ul>	<b>1,010,171</b> <b>3,500,000</b> <b>5,800,000</b>	10% 34% 56%
<b>Total</b>	<b>10,310,171</b>	100%

<b>1. Rikonstruksion dhe mobilim per sallen e konferencave</b>	<p>Rikonstruksioni i salles multifunksionale e cila do te sherbeje si teater, salle leksionesh dhe perdonimi per aktivitete te ndryshme. Do te behet hidroizolimi i tarraces ne nyjet e percaktuara duke eleminuar lageshtiren dhe permiresimi i kushteve te nevojshme per pjesemarresit. Do te behet ndertimi i shkallares me konstruksion metalik te lehte dhe me veshje druri. Eshte parashikuar ndertimi i 1 dhoma projekzioni dhe 2 dhoma teknike. Ne zbatim te projektit eshte parashikuar dhe ndricimi i salles me ndricues LED. Kapaciteti i salles eshte 108 persona.</p> <p><b>Perfituesit nga ky projekt jane:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjithe qytetaret qe do marrin pjese ne aktivitet.</li> </ul> <p><b>Vlera totale e parashikuar per kete projekt: 6,500,000 leke me financim si meposhte:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Ne 2022: 3,000,000 leke</li> <li>-Ne 2023: 3,500,000 leke</li> </ul> <p><b>Kohezgjatja e Investimit:</b> 2-Vite. Puna per hartimin e ketij projekti ka filluar ne vitin 2022.</p>
--	--

<p><b>2. Veshje e stolave të sallës së kinemasë</b></p>	<p>Ky investim konsiston ne blerjen e bazeve materiale te nevojshme per veshjen e stolave te kinemase. Materiali qe do te perdoret per veshjen e stolave do te jete veshje lekure, ngjyra kafe. Objektivi kryesor eshte permiresimi i kushteve te nevojshme per pjesemarresit. Numri i stolave qe kane nevoje per veshje eshte 324 .</p> <p><b>Perfituesit nga ky projekt jane:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Banoret e gjithe qytetit.</li> </ul> <p><b>Vlera totale e parashikuar per kete projekt: 1,010,171 leke me financim si meposhte:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Ne 2023: 1,010,171 leke</li> </ul> <p><b>Kohezgjatja e Investimit:</b> 1 vit</p>
<p><b>3. Rehabilitim i shtresave të mbuleses se Pallatit te Kultures</b></p>	<p>Konsiston ne blerje baze materiale per rehabilitimin e mbuleses se Pallatit te Kultures per eleminimin e lageshtires . Siperfaqja totale e nderhyrjes eshte 1550 m<sup>2</sup>. Do te behet nivelimi me shtrese nivelimi (rere e lare+cimento) mbulimi i shtreses se parapetit do te behet me karton katrama me 2 shtresa guajne e ngjitur me gas.</p> <p><b>Perfituesit nga ky projekt jane:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Punonjesit ne objektin e pallatit</li> </ul> <p><b>Vlera totale e parashikuar per kete projekt: 6,810,00 leke me financim si meposhte:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Ne 2023: 5,800,000 leke</li> <li>-Ne 2025: 1,010,000 leke</li> </ul> <p><b>Kohezgjatja e Investimit:</b> 2-Vite.</p>

**PROGRAMI I ARSIMIT BAZE DHE PARASHKOLLORË**

<p><b>Përshkrimi</b></p>	<p>Mbështetja e arsimit parashkollar dhe arsimit bazë, administrim dhe rregullim i sistemit arsimor parashkollar në kopshte.</p>
--------------------------	--

<b>programit</b>	
<b>Qëllimi i Politikës së Programit</b>	Arsim parashkollar dhe bazë për të gjithë dhe përmirësim i infrastrukturës për arritjen e standardeve bashkëkohore
<b>Objektivat e politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ ndërhyrje me mirembajtje në arsimin parashkollar. Brenda vitit 2023 do të ndërhyhet në mirembajtjen e të gjitha shkollave dhe kopshteve të qytetit të Patosit dhe të dy Njësive Administrative në të cilat marrin shërbim fëmijët që konsiderohen si përfitues të drejtëpërdrejtë të arsimit parashkollar dhe familjet e tyre.</li> <li>❖ ndërhyrje në kopshte e çerdhe për plotësimin e infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme dhe për pajisjen me të gjithë elementët e nevojshëm duke krijuar një infrastrukturë argëtuese dhe edukative për fëmijët .</li> <li>❖ edukimin e brezit të ri, nëpërmjet politikave të caktuara sociale, kulturore dhe edukative.</li> <li>❖ realizimi i administrimit sa më me efektivitet të personelit edukativ per arsimin parashkollar dhe personelit ndihmes per arsimin parauniversitar.</li> <li>❖ furnizimi dhe mbështetja me ushqim e kopshteve</li> </ul>
<b>Buxheti 2023</b>	Buxheti i akorduar nga Bashkia Patos si transferte e pakushtezuar sektoriale dhe nga të ardhurat e bashkisë për këtë Program, për vitin 2023 paraqitet në shumën prej <b>76,618,702</b> lekë nga të cilat 58,591,000 lekë janë nga transferta e specifike dhe 18,027,702 lekë janë nga të ardhurat e Bashkisë. Ky program zë 14 % të totalit të shpenzimeve.
<b>Njësité shpenzuese</b>	Bashkia Patos . Drejtoria Arsimit Kulturës dhe Sporteve

<b>Programi i Arsimit Bazë dhe Parashkollar</b>	<b>Plani 2022</b>	<b>Plani 2023</b>
<b>Shpenzime Korrente</b>	65,809,000	67,338,000
<b>Shpenzime Kapitale</b>	5,582,791	9,280,702
<b>Totali :</b>	<b>71,391,791</b>	<b>76,618,702</b>

Ky program parashikon mirëmbajtjen e institucioneve arsimore parashkollore, pajisjen me bazë materiale si dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme higjieno-sanitare, në funksion të rritjes së cilësisë në zhvillimin normal të procesit mësimor-edukativ. Programi mbulon pagesat dhe sigurimet

shoqërore të mësuesve në arsimin parashkollor dhe stafit mbështetës. Synon realizimin e administrimit sa më me efektivitet të personelit edukativ për arsimin parashkollor në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, mirëmbajtjen e objekteve, pajisjen me bazë materiale si dhe mirëmbajtjen e vazdueshme higjeno-sanitare, në funksion të rritjes së cilësisë në zhvillimin normal të procesit mësimor-edukativ parashkollor. Pjesë e rëndësishme e këtij programi është dhe organizimi i veprimtarive argëtuese me fëmijët .

### **Qëllimi:**

Arsim parashkollor dhe bazë për të gjithë dhe përmirësim i infrastrukturës për arritjen e standardeve bashkëkohore

### **Objektivat:**

- Ndërtim dhe mirëmbajtje e objekteve parashkollore
- Mbulimi i pagave për mësuesit e kopshteve të fëmijëve dhe stafit mbështetës
- Furnizimi dhe mbështetja me ushqim e kopshtit me drekë dhe çerdhes
- Sigurimi i ngrohjes në të gjitha kopshtet
- Organizimi i veprimtarive argëtuese, konkurse midis kopshteve

✓ *Materiale për pastrim, disinfektim 400 000 lekë*

Në këtë zë janë përfshirë të gjitha materialet për pastrim, disinfektim e ambienteve të -14 Kopshteve dhe 1 Çerdhe të qytetit dhe fshatrave të njësisë Zharrëz dhe Ruzhdie.

✓ *Dru zjarri +gaz për ngrohje gatim(kopsht,çerdhe) 700 000 lekë*

Në këtë zë përfshihet lëndë djegëse(gaz) për gatim në kopshtin me ushqim dhe çerdhe dhe lëndë djegëse(dru zjarri) për ngrohjen e 9 objekteve parashkollore.

✓ *Furnizime dhe sherbime me ushqim per kopshtin Nr.1 dhe çerdhen 3.067.000 leke.*

Në këtë zë është përfshirë vlera e shpenzime financiare për blerjen e produkteve ushqimore për kopshtin Nr.1(me ushqim) dhe çerdhen bazuar në ligjin Nr. 10138, dt. 11.05.2009,Neni 46/1 “Per shendetin publik”, urdhrin Nr.5 dt.12.01.2016 “Për ndryshimet në menunë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç” si dhe parashikimin për rritjen e numrit të fëmijëve qe frekuentojnë ne keto dy institucionë.

✓ *Energji elektrike dhe kontrata te reja 1 800 000 lekë*

Në këtë zë përfshihen energjia elektrike të 6 Shkollave 9-vjeçare, 4 Shkolla vartëse të arsimit fillor, kopshtet dhe QKF: Këto fonde shërbejnë për pagesën e energjisë elektrike të shkollave dhe kopshteve të bashkisë Patos dhe preventivat realizohen nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë Patos duke u bazuar në faktin e një viti më parë dhe nevojat që janë për këtë shërbim me kërkesë të Drejtorisë sonë.

✓ *Ngrohje në shkollat “M.Gosnishi” dhe ”H.Maneku” 1 000 000 lekë*

Në këtë zë përfshihet lëndë djegëse (naftë) për sistemin e ngrohjes në shkollën “Zh.Ciko”, ”M.Gosnishti”, ”H.Maneku”, ”M.Matohiti” referuar udhëzimeve të manualit teknik te kaldajave, hapesirave të mjediseve që do të ngrohen dhe praktikave të perdonura me parë.

**✓ Mirëmbajtje dhe lyerje e kopshteve 1.600.000 lekë.**

Në këtë zë përfshihen punimet për mirëmbajtjen e zakonshme të 15 objekteve parashkollore dhe çerdhes : meremetime, punime hidarulike, elektrike, lyerje e dezinfektim si dhe ndërhyrje për mjedise të reja në kopshtin e njësisë Zharrëz.

Preventivat realizohen nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë Patos dhe shërbimi zbatohet nga Ndërrmarja e Mirëmbajtjes Urbane Patos me kërkesë të Drejtorisë sonë.

**✓ Marrje me qira objekti për kopshtin Grizë 180 000 lekë**

Në këtë zë përfshihen shpenzimet financiare për marrjen me qira të objektit në fshatin Grizë për zhvillimin e procesit mësimor-edukativ të fëmijëve të kopshtit Grizë, godina e të cilit është vlerësuar nga Instituti i Ndërtimit me rrezikshmëri të lartë për përdorim. Marrja me qira do të bëhet sipas procedurave ligjore për periudhën 1 janar -30 qershori 2023 për vitin arsimor 2022-2023 dhe 1 shtator 2023 -31 dhjetor 2023 për vitin arsimor 2023-2024 (kjo në varësi të ecurisë për zgjidhjen përfundimtare të godinës).

**✓ Rikonstruksioni i Shkollës “Muhamet Shehu”**

“Rikonstruksioni i Shkollës 9 Vjeçare “Muhamet Shehu” me vlerë projekti 95.394.560 lekë, bashkëfinancimi i te cilit shtrihet sipas viteve si më poshtë:

Financuar në vitin 2022 35 157 823 lekë nga të cilat 5,723,673 janë nga të ardhurat e Bashkisë dhe 32,434,150 nga Ministria e Arsimit

Financuar në vitin 2023 57 236 737 lekë nga të cilat 8,585,511 nga të ardhurat e Bashkisë dhe 48,651,226 nga Ministria e Arsimit.

Qëllimi dhe objektivat (*)	<p>Qëllimi i projektit është që të ofrojë kushte bashkëkohore për zhvillimin e mësimit dhe tërheqja e nxënësve për të ardhur në këtë shkollë dhe mos të largohen më për kushte jo të mira të zhvillimit të mësimit. Objektivat:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mësim cilësor sipas standardeve</li> <li>2. Rritje e numrit të nxënësve që ndodhen në këtë zonë</li> <li>3. Krijimi i kushteve bashkëkohore duke i bërë të gjitha shkollat e qytetit njësoj me kushte dhe me shërbim cilësor.</li> <li>4. Krijimi i hapësirave të mundëshme për stërvitje dhe kryerje të aktivitetave sportive pasi afër ndodhet dhe stadiumi i qytetit dhe palestra do të shërbejë jo vetëm për</li> </ol>
----------------------------	---

	<p>stërvitje gjatë shkollës dhe mësimit por edhe për aktivitet pasditeve për të gjithë të rinjtë e qytetit.</p> <p>Objekti ndodhet ne lagjen “Naftetari”. Ky investim i referohet permiresimit te infrastruktures se godines se shkolles “Muhamet Shehu” dhe ndertimin e palestreve se shkolles si dhe sistemimi i ambienteve te jashtme te saj. Siperfaqja totale e shkolles eshte 862.4m<sup>2</sup>, ka një gjatesi 56 ml dhe gjeresi 15.4 m.</p> <p>1.Punimet qe perfshin projekti jane si me poshte:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Punime prishje</li><li>- Punime suvatim dhe lyerje</li><li>- Punime shtresash</li><li>- F.V dyer/dritare</li><li>- Punime elektrike</li><li>- Punime hidrosanitare</li><li>- Sistemim i jashtem</li><li>- Bordurime, mbjellje me bar,</li><li>- Ndertimi i palestreve</li><li>- Punime kanalizimi</li></ul>
Numri i përfituesve (*)	<p><b>Aktualisht në shkollen “Muhamet Shehu” shkojnë nxënës nga lagjja “Naftëtari”, Lagjja “Dukas” dhe “Kuqari</b>, aktualisht numri i banorëve që përfshijnë këto blloqe shkon afersisht 10800 banorë. Student që shkojnë në shkollë janë 360 nxënës, por ka një tendencë në rritje të nurmit të nxënësve dhe sidomos pas rikonstruksionit ku do të vijnë dhe shumë nxënës të tjerë të zonës që aktualisht shkojnë në shkolla private si pasoj e gjendjes jo shumë të mirë të shkollës. Aktualisht në shkollë ka 27 mësues të cilët japing mësim në shkollë.</p> <p>Vlera totale e parashikuar per kete projekt se bashku me mbikqyrje dhe kolaudim: 9,280,702 leke</p> <p>Projekti është Bashkëfinancim me Ministrinë e Arsimit.</p> <p>Kohezgjatja e Projektit: 1 vit (pergjate 2023 ), Projekti eshte hartuar pergjate vitit 2022</p>

---

**PROGRAMI ARSIMI I MESËM**

<b>Përshkrimi i programit</b>	Mbështet arsimin e mesëm, duke siguruar dhe mirëmbajtur ambientet shkollore dhe pagesën e stafit mbështetës. Programe arsimore dhe trajnim për mësuesit.
<b>Qëllimi i Politikës së Programit</b>	Arsim i mesëm i qëndrueshëm , përmirësim i infrastrukturës për arritjen e standardeve bashkëkohore.
<b>Objektivat e politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore</li> <li>❖ Përmirësimi i kushteve për zhvillimin cilësor të procesit mësimor-edukativ</li> <li>❖ Edukimin e brezit të ri, nëpërmjet politikave të caktuara sociale, kulturore dhe edukative.</li> <li>❖ Realizimi i administrimit sa më me efektivitet të personelit edukativ per arsimin parashkollar dhe personelit ndihmes per arsimin parauniversitar.</li> <li>❖ Administrim,inspektim, organizim ose mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave;</li> <li>❖ Mbështetje për trajnimin e mëtejshëm të mësuesve.</li> </ul>
<b>Buxheti 2023</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Buxheti i akorduar për këtë Program, për vitin 2023 paraqitet në shumën prej <b>7,292,709</b> lekë nga të cilat 3,871,000 lekë janë nga transferta specifike për këtë program dhe 3,421,709 lekë nga të ardhurat e veta të Bashkisë Patos . Ky program zë 1 % të totalit të shpenzimeve.</li> </ul>
<b>Njësité shpenzuese</b>	Bashkia Patos .Drejtoria Arsimit Kulturës dhe Sporteve

<b>Programi Arsimi Mesëm</b>	<b>Plani 2022</b>	<b>Plani 2023</b>
<b>Shpenzime Korrente</b>	7,391,528	7,292,709
<b>Shpenzime Kapitale</b>	0,000	0,000
<b>Totali ;</b>	<b>7,391,528</b>	<b>7,292,709</b>

Ky program parashikon mirëmbajtjen e institucioneve arsimore , pajisjen me bazë material si dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme higjieno-sanitare, në funksion të rritjes së cilësisë në zhvillimin normal të procesit mësimor-edukativ.Programi mbulon pagesat dhe sigurimet shoqërore të personelit ndihmës për sistemin parauniversitar. Synon realizimin e administrimit sa më me efektivitet të personelit ndihmës në funksion të rritjes së cilësisë së higjenës dhe ruajtjes së

objekteve shkollore. Pjesë e rëndësishme është nxitja e nxënësve drejt arsimit cilësor dhe motivimi i tyre nëpërmjet stimulimit të ekselentëve.

**Qëllimi:**

Arsim i mesëm i qëndrueshëm, përmirësim i infrastrukturës për arritjen e standardeve bashkëkohore.

**Objektivat:**

- Ndërtim dhe mirëmbajtje e strukturave shkollore
- Mbulimi pagave për stafin mbështetës
- Nxitja e nxënësve drejt arsimimit cilësor dhe motivimi nëpërmjet stimulimit të ekselentëve në arsimin e mesëm të lartë në nivel rajonal dhe kombëtar.
- Përmirësimi i kushteve për zhvillimin cilësor të procesit mësimor-edukativ
- Rritja e produktivitetit dhe efektivitetit në fushën e arsimit

• Mirëmbajtje dhe lyerje e shkollave dhe QKF 1.000.000 lekë.  
Në këtë zë përfshihen punimet për mirëmbajtjen e zakonshme të 2 Shkolla të Mesme të Bashkuara(9-vjeçar+mesem) dhe 1 Shkollë e Mesme: meremetime, punime hidarulike, elektrike, lyerje e dezinfektim. Këto fonde shërbejnë për mirëmbajtjen e shkollave dhe kopshteve të bashkisë Patos të cilat kryhen çdo vit dhe preventivat realizohen nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë Patos dhe shërbimi zbatohet nga Ndërrmarja e Mirëmbajtjes Urbane Patos me kërkesë të Drejtorisë sonë.

**• *Materiale për pastrim,disifikim 450 000 leke***

Në këtë zë janë përfshirë të gjitha materialet për pastrim, disifikim e ambienteve të 6 Shkollave 9-vjeçare, 2 Shkolla të Mesme të Bashkuara(9-vjeçar+mesem), 1 Shkollë e Mesme dhe 4 Shkolla vartëse të arsimit fillor, QKF.

**• *Ngrohje në shkollën "Zh. Ciko" 400 000 lekë***

Në këtë zë përfshihet lëndë djegëse (naftë) për sistemin e ngrohjes në shkollën "Zh.Ciko" referuar udhëzimeve të manualit teknik të kaldajave, hapësirave të mjediseve që do të ngrohen dhe praktikave të përdorura më parë.Harxhimi i naftës do të jetë 9litra në orë. Do të ndizet në periudhën 15dhjetor-15mars e do të qëndroj ndezur reth 223 orë.

**• *Pelete druri për ngrohje(kopsht,shkolla) 300 000 lekë***

Në këtë zë përfshihet lëndë djegëse pelete druri 2000 kg për shkollën "M.Matohiti" dhe 1120 kg kopshtin +Qendra Shëndetsore Sheqishte referuar udhëzimeve të manualit teknik të kaldajave, hapësirave të mjediseve që do të ngrohen. Harxhimi i peletës do të jetë 6kg/orë.Kaldajat do të ndizen gjatë periudhës 15dhjetor-15mars e do qëndrojnë ndezur 260orë.

- *Shpenzime për kolaudimin e kaldajave të institucioneve arsimore të Bashkisë Patos.*  
**100 000 lekë**

Në këtë zë përfshihet kolaudimi i kaldajave të 5(pesë) institucioneve arsimore të Bashkisë Patos: Kopshti Sheqishte, Shkolla “Mustafa Matohiti”, Shkolla “Zhani Ciko”, Shkolla “Meleq Gosnishti” dhe Shkolla “Hekuran Maneku”.

- *Bazë materiale kancelarike për shkollat 100 000 lekë*

Në këtë zë është parashikuar bojë printeri për 9 institucionet arsimore dhe baze materiale letër A4, dosje, stilolapsa etj.

- *Materiale dekorit shkollat 71.565 leke*

Në këtë zë janë parashikuar materiale për dekorin e shkollave si flamuj, tabela emërtimi për fillimin e viti shkollor.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten shpenzimet operative për programin e Arsimit të Mesëm:

Nr	<b>Emertimi</b>	<b>VITI 2023</b>	<b>Pesha specifike (%)</b>
<b>Shpenzime operative</b>			
1	Blerje kancelari per shkolla + qkf	100,000	2.92
2	Materiale te ndryshme pastrimi	450,000	13.15
3	Energi elektrike+kontrata te reja	1,000,000	29.22
4	Pelete druri per ngrohje shkolla M.Matohiti+K.Shevqishte	300,000	8.77
5	Ngrohje te Shkolla Zh.Ciko	400,000	11.69
6	Shpenzime per kolaudimin e Kaldajave	100,000	2.92
7	Materiale dekorit per shkollat	71,765	2.10
8	Blerje Mirembajtje,lyerje Shkolla +kopshti	1,000,000	29.22
	<b>SHUMA E SHPENZIMEVE</b>	<b>3,421,765</b>	<b>100</b>

**PROGRAM I BUJQËSISË, BLEGTORISË**

<b>Përshkrimi I programit</b>	 Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve
<b>Qëllimi i Politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Konservim, zgjerim dhe shfytëzim i racionalizuar i rezervave pyjore;</li> <li>❖ Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe dhënie e licencave për prerje drurësh (hedhja e pemëve);</li> <li>❖ Organizim ose mbështetje për veprimtarinë ripyllëzuese, kontrollin e insekteve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit dhe ofrimin e shërbimeve për operatorët pyjorë;</li> <li>❖ Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve</li> </ul>
<b>Ojektivat e politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Azhornimin e sipërfaqeve të paazhornuara apo të azhornuara gabim,</li> <li>❖ Ndërhyrjet në hapjen e rrugëve të parcelave të tokave bujqësore dhe sistemimine tyre,</li> <li>❖ Përfundimin e procesit të rregjistrimit të tokave bujqësore në ZVRPP.</li> <li>❖ Forcimi i kontrollit në fushën e veterinarisë si dhe bashkëpunimi me shërbimin veterinar privat.</li> <li>❖ Certifikimin e sipërfaqeve pyjore si dhe pyllëzimi i i sipërfaqeve të zhveshura.</li> <li>❖ Ngritura, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave.</li> <li>❖ Ky program parashikon zhvillimin buqësisë, blektorisë pyjeve dhe mjedisit me qëllimofrimin e një shërbimi më cilësor për qytetarët, një menaxhim më të mirë te tyre.</li> </ul>
<b>Buxheti 2023</b>	Bashkia Patos finançon programin për vitin 2023 me <b>9,750,089 lekë</b> . Ky program zë 2 % të totalit të shpenzimeve.

	Me një rritje rrëth 1.49% ne krahasim me vitin e kaluar.
<b>Njësitë shpenzuese</b>	Bashkia Patos Drejtoria e Zhvillimit Bujqësisë, Blegtorisë

<b>Programi i Bujqësise, Blektorisë</b>	<b>Plani 2022</b>	<b>Plani 2023</b>
<i>Shpenzime Korrente</i>	9,606,886	9,750,089
<i>Shpenzime Kapitale</i>	0	0
<b>Total</b>	<b>9,606,886</b>	<b>9,750,089</b>

Përmes fondeve të alokuara në këtë program buxhetor, synohet mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e saj nëpërmjet projekteve që fuqizojnë përdorimin e qëndrueshëm të tokave bujqesore si dhe të kategorive të resurseve të tjera. Në këtë drejtim bashkia ka punuar gjatë vitit në objektiva si: Bashkia mbështet rritjen e prodhimit bujqësor dhe blektoral nëpërmjet forcimit të inspektoimit dhe si. Buxheti i alokuar në këtë program buxhetor është përdorur nga bashkia për përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen komunitetit për shërbimet bujqësore.

Në zbatim të funksioneve që ka secili dhe planifikimit të detyrave për vitin 2023, jemi përkushtuar për realizimin e tyre.

Në zbatim të VKM-së nr.1174 datë 24.12.2020 “Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese”, u bë inventarizimi dhe përcjellja për në ASHK Drejtoria Vendore Fier e dokumentacionit.

Në zbatim të VKM nr.1142 datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e kritereve bazë të masës së përsitimit dhe mënyrës së përdorimit të fondit për skemën e mbështetjes me naftë për bujqësinë” si dhe udhëzimit nr.1 datë 08.01.2021 “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të skemës së mbështetjes me naftë për bujqësinë”, kemi informojmë dhe orientojmë fermerët për aplikim si dhe i kemi pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për këtë proces.

Ofrojmë çdo ditë për qytetarët që paraqiten pranë zyёs me një ndalesë, gjithë shërbimet që ofrohen në sportelin e bujqësisë, dhënie e vërtetimeve për pronësinë mbi tokën bujqësore, sqarimi i qytetarëve për problematikat e ndryshme që kanë në lidhje me kufijtë e pronave tokë bujqësore dhe me dokumentacionin që disponojnë për tokën.

Sektori i shërbimit veterinar në Bashkinë Patos, duke u mbështetur ne ligjin nr.10465 date 29.09.2011 “per veterinarine”dhe ligjit nr.9863 date 28.01.2008 “Per ushqimin”, ka marre gjith masat e duhura per një mbarevajtje te mire te shendetit publik nga produktet e mishit, te therura ne territorin e Bashkise Patos.

**Shpenzimet operative për vitin 2023:**

Shërbimi i bujqësisë,blektorisë dhe pyjeve realizohet nga Drejtoria e Zhvillimit Buqësisë dhe Blegorisë, Bashkia Patos në bashkëpunim me dy Njësitë Administrative Zharrëz dhe Rruzhdi. Cilësia e këtij shërbimi është përmirësuar gjatë vitit të kaluar,si rezultat i:

- Ndërhyrjet në hapjen e rrugëve të parcelave të tokave buqësore dhe sistemimin e tyre.

Kjo drejtori, ka realizuar një analizë të detajuar për të përcaktuar:

- Gjendjen e kanaleve kulluese dhe ato vaditese,
- Volumin e punës e nevojshme për mirëmbajtje për secilën,
- Përcaktimin e kostos për çdo ndërhyrje,
- Saktësimi i inventareve të pyjeve,gjendja reale e tyre dhe koston për cërtifikim,
- Gjendjen e thertoreve me qëllim forcimin e kontrollit ndaj tyre.

Tabela e mëposhtme paraqet shpenzimet operative për shërbimin e bujqësisë dhe blegorisë:

Shpenzimet Operative	Plani 2023	Pesha specifike (%)
<b>Karburant për nevojat e bujqësisë</b>	<b>655,965</b>	<b>13.75%</b>
<b>Mbeshtetje per fermeret e rindj</b>	<b>2,000,000</b>	<b>41.93%</b>
<b>Mirëmbajtje e Rrugëve Bujqësore (Baza Materiale)</b>	<b>2,114,352</b>	<b>44.32%</b>
<b>TOTAL</b>	<b>4,770,317</b>	<b>100.00%</b>

<b>PROGRAM MENAXHIMI I MBETJEVE, MBROTJA E MJEDISIT BASHKIA</b>	
<b>Përshkrimi I programit</b>	<p>***Programi mbulon Mbrojtja e ajrit dhe e klimës, mbrojtja e tokave dhe ujrale nëntokësore, reduktimi i zhurmave dhe vibracioneve si dhe mbrojtja ndaj rrezatimeve. Veprimtaritë dhe politikat për mbrojtjen mjedisore.</p>
<b>Qëllimi i Politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Masa mbrojtëse për cilësinë e ajrit, tokës dhe ujit</li> <li>❖ nga ndotja;</li> <li>❖ Ndërtim, mirëmbajtje dhe vënie në funksionim e sistemeve të monitorimit të ndotjes, si dhemasave për mbrojtjen nga ndotja akustike.</li> <li>❖ Administrim, mbikëqyrje, inspektim, organizim</li> <li>❖ ose mbështetje e veprimtarive që lidhen me kontrollin dhe zvogëlimin e ndotjes;</li> <li>❖ Grante, hua ose financime për të mbështeturve primitaritë që lidhen me uljen dhe kontrollin endotjes;</li> <li>❖ Zhvillimi i aktivitetave edukuese dhe promovuese, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.</li> <li>❖ Ky program parashikon Mbron mjedisin nga ndotja dhe dëmtimi që mund t'i bëhet si nga personat juridik dhe fizikë, vendas ose të huaj.</li> <li>❖ Sensibilizon komunitetin për nismat e Bashkisë nëpërmjet të gjitha mënyrave të informimit si mediave, takimeve, spoteve, njoftimeve etj.</li> </ul>
<b>Ojektivat e politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Administrimi, kordinimi dhe monitorimi i politikave, planeve, programeve dhe buxheteve për promovimin e mbrojtjes mjedisore;</li> <li>❖ Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm për mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin mjedor.</li> </ul>

<b>Buxheti 2023</b>	Bashkia Patos financon programin për vitin 2023 me <b>1,218,796 lekë</b> . Ky program zë 0.5 % të totalit të shpenzimeve. Fondi për është këtë program ka një rritje fare të lehtë krahasuar me vitin 2022.
<b>Njësitë shpenzuese</b>	Bashkia Patos Drejtoria e Zhvillimit Bujqësisë, Blegtorisë

<b>Programi Mbrojtja e Mjedisit Menaxhimi i Mbetjeve</b>	<b>Plani 2022</b>	<b>Plani 2023</b>
<i>Shpenzime Korrente</i>	1,200,407	1,218,796
<i>Shpenzime Kapitale</i>	0	0
<b>Total</b>	<b>1,200,407</b>	<b>1,218,796</b>

Bashkia Patos po punon për Zbatimin e Planit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve ku programi “Mbrojtja e Mjedisit” ka një rol kryesor prandaj është hapur si program më vete në varësi të drejtorisë së Bujqësisë dhe Blegtorisë.

Për menaxhimin sipas ligjit, të mbetjeve të prodhuara nga familjet Bashkia Patos do të realizojë projekte me në fokus ndërgjegjësimin e banorëve për ndarjen e mbetjeve në burim. Do të realizohen projekte në lagje pilot të Bashkisë Patos dhe në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme.

Qëllimi: Përmirësimi i shërbimit të Menaxhimit të mbetjeve, reduktimi i ndotjes dhe kthimi i burimeve natyrore në shërbim të komunitetit.

Rezultate:

- Përmirësimi i shërbimit të Menaxhimit të mbetjeve duke përdorur teknologji bashkëkohore.
- Ofrimi i shërbimit cilësor, në kohë dhe në të gjithë territorin.
- Reduktimi i ndotjes dhe kthimi i burimeve natyrore në shërbim të komunitetit.
- Përputhshmëria me objektivat kombëtare duke nxitur minimizimin e mbetjeve në burim.

### 1. MENAXHIMI I MBETJEVE

Bashkia Patos synon një mjedis të pastër me cilësi të lartë në vazhdimësi, falë punës dhe kontributit të përbashkët të komunitetit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, duke synuar ndarjen në burim në të gjithë territorin, për një jetesë të shëndetshme.Në mbështetje të ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 “PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE”, Sektori i Pyjeve dhe Mjedisit në Bashkinë Patos synon progresin gradual drejt përmirësimit të situatës aktuale drejt standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.Menaxhimi në nivel lokal përfshin zbatimin e skemave të minimizimit të mbetjeve në qytetin e Patosit dhe në shkollat e qytetit për të reduktuar në mënyrë progressive mbetjet për në incinerator. Lidhur me burimet e gjenerimit të mbetjeve , mbetjet bashkiake ndahen në dy rryma mbetjesh, sipas burimit të origjinës:

1.MF mbetjet e prodhua nga familjet

2.MB mbetjet e prodhua nga bizneset dhe industritë

Për menaxhimin sipas ligjit, të mbetjeve të prodhua nga familjet Bashkia Patos do të realizojë projekte me në fokus ndërgjegjësimin e banorëve për ndarjen e mbetjeve në burim. Do të realizohen projekte në lagje pilot të Bashkisë Patos dhe në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme.

Qëllimi: Përmirësimi i shërbimit të Menaxhimit të mbetjeve, reduktimi i ndotjes dhe kthimi i burimeve natyrore në shërbim të komunitetit.

Rezultate:

- Përmirësimi i shërbimit të Menaxhimit të Mbëtjeve duke përdorur teknologji bashkëkohore.
- Ofrimi i shërbimit cilësor, në kohë dhe në të gjithë territorin.
- Reduktimi i ndotjes dhe kthimi i burimeve natyrore në shërbim të komunitetit.
- Përputhshmëria me objektivat kombëtare duke nxitur minimizimin e mbetjeve në burim.
- Kontribut në Planin e Zhvillimit Vendor lidhur me menaxhimin e mbetjeve.

### **MONITORIM I CILËSISË SË AJRIT, UJIT DHE TOKËS NË ZONËN NAFTËMBAJTËSE PATOS-MARINËZ**

-Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 26 Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit”, Ligjit Nr 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, Ligjit Nr.10 431 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Neni 26 Normat e cilësisë së mjedisit, si edhe Ligjit nr.10 433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Bashkia Patos do të kryej shërbimin për monitorimin e mjedisit në zonat e ndotura në territorin e Bashkisë Patos kryesisht në zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz. Ky monitorim bëhet për të mësuar nivelin e ndotjes dhe për të propozuar masat që duhet të merren për të shmangur ndotjen. Kërkohet që ky monitorim të kryhet nëpërmjet pajisjeve dhe instrumenteve të akredituara që disponon operatori. Operatori duhet të jetë i pajisur me çertifikatën e laboratorit të specializuar e të akredituar nga Ministria e Mjedisit sipas legjislativit në fuqi. Ky shërbim shkon rrëth **84,868 lekë**.

### **MBROJTJA E SHËNDETIT**

-Në mbështetje të vendimit Nr.369, datë 26.07.1993 “Për Riorganizimin e Shërbimit, të Dezinfektimit,Dezinsektimit dhe Deratizimit (DDD), ku thuhet se ky shërbim kalon në vartësi të organeve të pushtetit vendor, si edhe nisur nga detyrat e lëna nga Inspektorati Shtetëror i Shëndetit për pajisje me Certifikatën e shërbimit (DDD) të institucioneve si shkollat,kopshte dhe çerdhe.

- Shërbimi (DDD) duhet kryer nga persona të trajnuar. ): Pajisjet dhe materialet të cilat pëdoren për DDD, duhet të jenë të cilësisë së lartë dhe të certifikuara .

Shërbimi do të kryhet ne : Shkolla, kopshte dhe çerdhe. Pas kryerjes së shërbimeve DDD bëhet pajisja me certifikat – dëshmi mbi kryerjen e shërbimeve të caktuara.

**Dezinfektimi** – bëhet me qëllim të shkatërrimit të mikroorganizmave patogen, parandalimin e sëmundjeve infektive në ambientet ku punohet.

Dezinfektimi bëhet me preparate përkatese për shkatërrimin e bakterieve gram positive dhe bakterieve gram negative, sporeve, myqeve dhe viruseve.

**Dezinsektimi** – bëhet me qëllim të mbytjes, largimit dhe pengimin e shumëzimit të Insekteve.

Dezinsektimi bëhet me preparate përkatëse që ndikojnë në luftimin e insekteve si :Preparate që shkaktojnë mbytjen e insekteve (insekticide) dhe Preparate që shkaktojnë largimin e insekteve nga hapësira të ndryshme.

**Deratizimi** – bëhet me qëllim të largimit të minjëve, me qëllim të parandalimit të dëmtimeve që sjellin minjtë(brejtësit).

Deratizimi bëhet me preparate përkatëse “Rodenticide”. Egzistojnë mjete fizike speciale për vendosjen e rodenticideve, këto mjete janë ekologjike dhe të siguruara nga prekja fizike e fëmijëve.

Shërbimi DDD për gjithë ambientet e institucioneve si: shkolla, kopshte dhe çerdhe të ndodhura në territorin e Bashkisë Patos shkon rreth: **155.720 lekë**

## **1. PROJEKTE MJEDISORE**

### **1.NESËR DO TË TË THEM “FALEMINDERIT”**

Të ndihmojmë familjet në nevojë nëpërmjet riciklimit, reduktimit dhe ripërdorimit.

#### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Projekti synon ndërgjegjësimin e qytetarëve për të dhuruar objekte njerëzve në nevojë. Veshjet e ndryshme, lodrat, orenditë të cilat nuk hyjnë më në punë në vend që të përfundojnë në koshë mund t'ua dhurojmë familjeve në nevojë. Në këtë mënyrë jo vetëm

realizojmë punë vullnetare por në këtë mënyrë ulet dhe sasia e mbetjeve në venddepozitim nëpërmjet, riciklimit, reduktimit dhe ripërdorimit.

**Qëllimi:** Në kuadër të këtij projekti, Bashkia Patos do të angazhohet të kryejë një sërë fushatash, me qëllim sensibilizimin qytetar në mbrojtje të mjedisit që duam.

**Rezultate:**

- Sensibilizim qytetar.
- Ndërgjegjësim mbi ruajtjen dhe sigurinë e mjedisit.
- Angazhim i qytetarëve për të ndihmuar njerëzit në nevojë .
- Angazhim dhe sensibilizim të nxënësve të shkollave.
- Dhurim buzëqeshjesh.

Për realizimin me sukses të këtij projekti na nevojitet një fond prej **9 000 lekësh** i cili do të shërbejë për blerjen e koshave të cilat do të shërbejnë për grumbullimin e sendeve, rrobave që do t'u shpërndahen familjeve në nevojë.

**“DITA NDËRKOMBËTARE E TOKËS” DATA E ZHVILLIMIT: 22 PRILL 2023**

**Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Data 22 Prill, njihet në gjithë botën, si Dita Ndërkombëtare e Tokës. Kjo është një ditë që shërben për të dhënë alarmin për dëmet që njerëzimi i shkakton pyjeve, lumenjve, tokës dhe pasurive të tjera të natyrës. Qëllimi i kësaj dite është reflektimi dhe sensibilizimi për të ndaluar shkatërrimin e mëtejshëm të saj. Më 22 prill, në mbarë botën, dashamirës të mjedisit organizojnë një varg aktivitetesh për të mirën e mjedisit dhe të njeriut, si: aktivitete pastrimi, gjelbërimi, pyllëzimi, manifestime në formë protestash, eksposita, koncerte, vizita, peticione, orë edukative me nxënës, konferanca shkencore lidhur me problemet mjedisore etj.

**Qëllimi:** Në kuadër të kësaj dite, Bashkia Patos do të angazhohet të kryejë një sërë aktivitetesh, me qëllim sensibilizimin qytetar.

**Rezultate:**

- Sensibilizim qytetar.
- Ndërgjegjësim mbi ruajtjen dhe sigurinë e mjedisit.
- Angazhim i qytetarëve lidhur me dobinë e mjedisit.

-Angazhim dhe sensibilizim të nxënësve të shkollave.

Për realizimin me sukses të aktiviteteve që janë parashikuar për t'u zhvilluar në simbol të kësaj dite nevojitet një fond prej **14,280 lekësh**. Aktivitetet që do të zhvillohen në këtë ditë janë aksione pastrimi shoqëruar me ekspositë me punime të realizuara me materiale të riciklueshme. Në këtë ditë do të shpërndahen doreza, qese dhe certifikata për të realizuar këto aktivitete në bashkëpunim me institucionë të ndryshme, si shkolla, biznese etj.

### **“ARTI I GJELBËR”**

#### **Përshkrimi i projektit:**

Ky projekt do t'i jap mundësinë të rindjeve të shpalosin aftësinë e tyre, talentin dhe imagjinatën e tyre duke sjellë me anë të vizatimeve mesazhe mjedisore që na kujtojnë se mjedisi është shtëpia jonë e përbashkët.

#### **Qëllimi:**

Përcjellja e mesazheve për mbajtjen pastër të mjedisit, mbrojtjen e natyrës, ruajtjen e burimeve natyrore, riciklimin etj.

Rezultate:

- Ndërgjegjësim i nxënësve lidhur me mjedisin.
- Zhvillimi i kreativitetit.
- Mbrojtja e mjedisit.

Për realizimin me sukses të këtij projekti na nevojitet një fond prej **10,267 lekësh** i cili do të shërbejë për blerjen e materialeve të tillë si bojra, penela dhe materiale të tjera që do t'u shpërndahen shkollave për të zhvilluar aktivitetin.

### **“PARKU ME MATERIALE TË RICIKLUESHME”**

#### **Përshkrim i shkurtër i projektit:**

Përfshirja e shumë aktorëve në këtë iniciative rimore, krijon një ndërgjegjësim mbi mjedisin:

- Të rindjet e shkollave do të krijojnë dhe zbatojnë idetë e tyre inovative, duke marrë pronësinë e suksesit të këtij projekti dhe eksperiencën për ta replikuar në mjedise të tjera.

- Të rindjtë vullnetarë do të ndihmojnë në punimin me materialet e riciklueshme. Forcimi i partneritetit midis aktorëve, do të çojë në promovimin e iniciativave të përbashkëta të zhvillimit lokal dhe rajonal, përmirësimin e mjedisit dhe shërbimeve në zonë.

**Qëllimi:**

Tu ofrojë të rinjve një zonë të sigurt të gjelbër që mbështetet në inovacionin dhe kreativitetin e tyre.

**Rezultate:**

Të rindjtë e shkollave të mesme dhe 9- Vjeçare, rrisin informacionin, interesin dhe ndërgjegjesimin mbi çështjet mjedisore dhe ato të pjesëmarrjes qytetare në projekte komunitare. -Vlerësimi i iniciativave dhe ideve inovative të të rinjve në zbatimin e projektit dhe bashkëpunimi i tyre me NJQV.

Krijimi i një modeli të përfshirjes së të rinjve, i promovuar online.

**Kostoja totale: 10,000 (dhjetë mijë) Lekë**

**KONSULENCË MJEDISORE**

Në mbështetje të ligjit Nr. 10 448, datë 14.7.2011 PËR LEJET E MJEDISIT, ligjit 10 431 “PËR MBROJTJEN E MJEDISIT”, për venddepozitimin e mbetjeve inerte na nevojitet pajisje me leje mjedisi kjo konsulencë do të shërbejë për hapat që do të ndiqen për pajisje me leje mjedisi të venddepozititmit. Për pajisje me leje mjedisi na nevojitet fondi prej **85,000 lekësh**.

**MONITORIMI I ZBATIMIT TË KUSHTEVE TË LEJES MJEDISORE.**

Pas pajisjes me leje mjedisi një nga kushtet e lejes është monitorimi i zbatimit të lejes. Ky vetmonitorim realizohet nga studio të akreditura 2 herë në vit. Monitorimi i kushteve të lejes mjedisore kërkon një fond prej **70,000 lekësh**.

**DITA PA MAKINA**

Në çdo 22 Shtator tashmë është bërë traditë zhvillimi i aktivitetit Dita pa makina në këtë ditë njerëzit ndërgjegjësohen lidhur me ndotjen e shkatuar nga makinat dhe rëndësinë e përdorimit të dyrrotakut.

**Qëllimi:**

Mbrotja e mjedisit nëpërmjet promovimit të ecjes dhe përdorimit të bicikletave.

Për realizimin me sukses të këtij aktiviteti nevojitet një buxhet prej **20,580 lekësh**.

<b>PROGRAMI ADMINISTRIMI I PYJEVE</b>	
<b>Përshkrimi I programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore;</li> <li>• Konservim, zgjerim dhe shfytëzim i racionalizuar i rezervave pyjore;</li> <li>• Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe dhënie e licencave për prerje drurësh (hedhja e pemëve);</li> <li>• Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore;</li> <li>• Grante, hua ose or financime për të mbështetur veprimtaritë tregtare pyjore</li> <li>• Shpërndarja e kullotave, duke përshirë menaxhimin e kullotjes .</li> </ul>
<b>Qëllimi i Politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të fondit pyjor dhe kullosor</li> <li>• Rritja e monitorimit të fondit pyjor dhe kullosor</li> </ul>
<b>Ojektivat e politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e kontrolleve dhe inspektimeve të fondit</li> <li>• Rritja e sipërfaqes së fondit pyjor dhe kullosor</li> <li>• Organizim ose mbështetje për veprimtarinë ripyallëzuese, kontrollin e insekteve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit dhe ofrimin e shërbimeve për operatorët pyjorë;</li> </ul>
<b>Buxheti 2023</b>	<p>Bashkia Patos finançon programin për vitin 2023 me <b>3,845,809 lekë</b>.</p> <p>Buxheti i akorduar nga Pushteti Qendror si transfertë Pakushtëzuar Sektoriale është 1,144,000 lekë dhe fondi i vendosur nga të ardhurat e Bashkisë është 2,701,809 lekë. Ky program zë 1 % të totalit të shpenzimeve .</p>
<b>Njësitë shpenzuese,menaxhue</b>	Drejtoria e Zhvillimit Bujqësisë, Blegtorisë dhe Pyjeve Bashkia Patos

<b>PROGRAM I ADMINISTRIMIT TË PYJEVE</b>	<b>Plani 2022</b>	<b>Plani 2023</b>
<b><i>Shpenzime Korrente</i></b>	3,533,426	3,845,809
<b><i>Shpenzime Kapitale</i></b>	0	0
<b>Total</b>	<b>3,533,426</b>	<b>3,845,809</b>

Vlera për realizimin e funksionit “Administrimi i Pyjeve” mbulohet nga transfera sektoriale në vlerën 1,144,000 lekë dhe pjesa tjetër në vlerën 2,701,809 mbluohet nga të ardhurat e veta të Bashkisë.

Administrimi i Pyjeve konsiston ne mirëmbajtjen dhe administrimin e 751 ha Pyje.

#### ***IV. Vështrim i përgjithshem i Programit “Administrimi i Pyjeve”.***

Synimi kryesore i ketij funksioni eshtë perdorimi i qendrueshem i pyjeve dhe kullotave.

Përmes fondeve të alokuara në këtë program buxhetor, synohet bashkia siguron përdorim të qendrueshëm të pyjeve dhe kullotave. Në këtë drejtim bashkia ka punuar gjatë vitit në objektiva si: Përmirësimi i shërbimit pyjor dhe kullosor. Buxheti i alokuar në këtë program buxhetor është përdorur nga bashkia për përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen komunititetit për pyjet dhe kullotat.

##### **1-Kontrolle**

Kontrolle të vazhdueshme në ekonomitë pyjore “Drenie” dhe “Lumi Seman 2” mbi dëmet e shkaktuara në pyje si dëme nga zjarret, prerjet dhe zëni e fondit pyjor. Nga kontrollet e ushtruara nuk janë konstatuar dëme në pyjet të cilat administrohen nga Bashkia Patos. Problemi më shqetësues është ndërhyrja në fondin pyjor, duke i zaptuar dhe tjetërsuar në vite me mbjelljen e drurëve frutore.

##### **2-Masa për mbrojtjen e pyjeve.**

Janë përpiluar dhe prodhuar tabela me siglën “Mbronji Pyjet”, “Pyjet janë burimi i jetës”, “Mos ndiz zjarrë në pyll”, ”Mos hidh cigare në pyll”etj., të cilat janë të hartuara nga ana jonë dhe janë të shpërndara në të gjitha rrugët të cilat përshkojnë fondin pyjor të Bashkisë Patos.

Janë përpiluar gjithashtu edhe tabela orientuese dhe sinjalizuese për monumentet e natyrës të cilat janë vendosur në të gjitha monumentet që ndodhen në territorin e Bashkisë Patos, si Rrepet e Peshkëpijve, Rrapi i Zhugrit dhe Kanionet e Siqecës.

**3- Hartimi dhe zbatimi i projektit të pyllëzimit të ish-gropes së grumbullimit te mbetjeve në Sheqishte. Është hartuar dhe po zbatohet projekti i pyllëzimit të gropes së mbetjeve në Sheqishte.**

##### **4-Inventari i pyjeve dhe përpilimi i hartave pyjore.**

Gjatë vitit 2022 janë kontrolluar dhe inventarizuar të gjitha parcelat pyjore gjithashtu janë ballafaquar hartat pyjore të transferuara nga ish Drejtoritë e Shërbimit Pyjor me hartën kadastrale të ardhur nga Ministria e Mjedisit dhe ndryshimet janë dërguar për miratim Ministrisë së Turizmit e Mjedisit.

##### **5-Mbrojtja ngazjarri.**

Pë rmbrojtjen nga zjarri është hartuar plani i masave si Bashki, shtabi i mbrojtjes nga zjarri si dhe shtabet për Njësitë Administrative. Janë ngritur skuadrat zjarrfikëse dhe për secilin fshat është kryer instruktimi i tyre si dhe njohja dhe përcaktimi i rrugëve dhe metodave për fikjen e zjarreve si dhe parandalimin e tyre. Eshtë rritur bashkëpunimi dhe me punonjësit e policies së rendit. Janë dërguar programet e punës për mbrojtjen nga zjarri pranë shtabit të rrethit dhe Ministrisë së Rendit. Vlera për realizimin e këtij funksioni është **3,845,809 lekë** të ndara në shpenzimet për personelin bashkë me fondin e veçantë në vlerën 3,408,709 lekë dhe shpenzime per mirembajtje ne vlerën 437,100 lekë.

**PROGRAM I UJITJE DHE KULLIM**

<b>Përshkrimi I programit</b>	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit
<b>Qëllimi I Politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmbytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë grante, dhe financime për punime të tilla.</li> </ul>
<b>Ojektivat e politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Pastrimin e kanaleve kullues të dyta dhe të treta , si dhe kanaleve vaditëse të dyta dhe të treta.</li> <li>❖ Ujita me ngritje mekanike ne Fshatin Beline duke vene ne funksion kanalet e veshur me beton nga projekti i finalizuar pergjate vitit 2019.</li> <li>❖ Relabilitimi 100% i rrjetit kullues ekzistues i tokave bujqesore ne njesi.</li> </ul>
<b>Buxheti 2023</b>	<p>Bashkia Patos finançon programin për vitin 2021 me <b>16,088,000 lekë</b>.</p> <p>Buxheti i akorduar nga Pushteti Qendoror si transferte Pakushtezuar Sektoriale.</p> <p>Ky program zë 3 % të totalit të shpenzimeve pergjithshme.</p>
<b>Njësitë shpenzuese,menaxhueze</b>	Bashkia Patos

<b>Programi Ujite Kullim</b>	<b>Plani 2022</b>	<b>Plani 2023</b>
<i>Shpenzime Korrente</i>	<b>8,978,709</b>	<b>11,147,000</b>
<i>Shpenzime Kapitale</i>	<b>7,388,467</b>	<b>4,941,000</b>
<b>Totali</b>	<b>16,376,176</b>	<b>16,088,000</b>

Vlera për realizimin e këtij funksioni është 16,088,000 lekë nga e cila të përballohen shpenzimet për personelin në vlerën 3,325,776 lekë ,dhe 7,821,224 lekë shpenzime operative dhe 4,941,000 lekë për investime.

- **Në tabelën e mëposhtme paraqiten shpenzimet operative dhe kapitale për programin:**

Shpenzime operative dhe kapitale	Plani 2023	Pesha specifike (%)
Karburant	4,338,400	58.04%
Shpenzime për pjese kembimi dhe mirembajtje	1,180,824	15.80%
Sigurim mjetesh	90,000	1.20%
Graso,boje,vegla pune per portat ndarese te ujit	100,000	1.34%
Baze materiale per permiresimin e rrjetit ujites dhe kullues	1,565,000	20.94%
Baze materiale per Mirembajtje e pompes ujit ne fshatin Beline dhe portave dalese te rezervuarit te Zharrezes	100,000	1.34%
Benzine,vaj mishel,fije per mirembajtje te rrjetit vadites me motokorrese me fuqi punetore	100,000	1.34%
<b>SHUMA SHPENZIMET OPERATIVE</b>	<b>7,474,224</b>	<b>100%</b>
Permiresimi i teknikave ujitjes dhe kullim ,skemave te reja	3,000,000	61%
Studim projektim per ujitje kullim	1,941,000	39%
<b>SHUMA SHPENZIMET KAPITALE</b>	<b>4,941,000</b>	<b>100%</b>

Projektet:	Ndërhyrjet dhe problematikat:
1.“ Përmirësimi i teknikave të ujitjes dhe kullimit, skemat e reja”	<p>Projekti “Skemë ujitëse me tubacion me burim uji Kolektorin Roskovec- Hoxharë” do të zhvillohet në fshatin Sheqishte, Njësia Administrative Zharrez</p> <p>Ai synon rritjen e sipërfaqes së ujitur me 20 Ha. Domosdoshmëria e zhvillimit të këtij projekti konsiston në problematikën e hasur me ujitjen nga Rezervuari i Kurjanit. Duke qenë se Kolektori Roskovec-Hoxharë është një burim ujor i sigurt, efektivitetit i këtij projekti do të jetë 100 %, si dhe duke qenë me tubacion do të shmangen humbjet si dhe faturimi i ujit do të jetë më menaxhueshmë.</p>

<b>PROGRAMI RRUGË RURALE “INSFRASTRUKTURA” BASHKIA</b>	
<b>Përshkrimi i programit</b>	Ky program parashikon ndërtim, rikonstruksion, blerje dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve kryesore, segmenteve rrugore dhe nyjeve si dhe rehabilitimin e blloqeve të banimit, ndërtim lulishte, planifikime urbane, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për komunitetin, ofrimin e një shërbimi të transportit publik cilësor për qytetarët, një menaxhim më të mirë të trafikut nëpërmjet rregullimit dhe përmirësimit të të gjithë instrumentave dhe elementëve të sinjalistikës rrugore në qytet si dhe blerje asete për kryerjen e shërbimeve funksionale të Bashkisë.
<b>Qëllimi i Politikës së programit</b>	Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një infrastrukturë sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë qytetin, me qëllim që t’iu mundësojë qytetarëve qarkullim normal si dhe komoditet në ecjen e këmbësorëve dhe njerëzve me aftësi të kufizuara. Gjithashtu ky program konsiston ne ofrimin e një sistemi të transportit me qëllim zhvillimin e ekuilibruar të jetës dhe lëvizjes në qytetin e Patosit, duke marrë në konsideratë impaktin për nevojën e mbështetjes së ruajtjes së ambientit përkundrejt zhvillimit të sektorit të transportit.
<b>Objektivat e politikës së programit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>❖ Ndërhyrje komplekse të cilat synojnë krijimin e një infrastrukturë rrugore bashkëkohore mbi dhe nëntokësore.</li> <li>❖ Rikonstruksioni i plotë i rrjetit rrugor ekzistues nëpërmjet zgjerimit, asfaltimit, rikonstruksionit të trotuareve, infrastrukturës nën e mbitokësore, të të gjitha rrugëve ekzistuese kryesore dhe sekondare,</li> <li>❖ Ndërtimi i Rrugëve të reja,</li> <li>❖ Ndërhyrjet në blloqe banimi, rrugë parësore dhe dytësore, nyje dhe ura,</li> <li>❖ Studime dhe projekte për objekte të reja apo dhe për rikonstruksione,</li> <li>❖ Mirëmbajtje e infrastrukturës rrugore(asfaltim, shtrim trotuaresh, vendosje bordurash)</li> <li>❖ Shërbimi i ndriçimit dhe mirëmbajtjes së tij</li> <li>❖ Qarkullim i shpejtë, komod e sigurt,</li> <li>❖ Zgjerim i rrjetit të transportit publik në të gjithë territorin e qytetit,</li> <li>❖ Rritje të kapaciteteve transportuese,</li> <li>❖ Përmirësim i infrastrukturës ndihmëse të transportit</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>publik,</li> <li>❖ Plotësim i të gjitha rrugëve me sinjalistikë vertikale e horizontale me lehtësira për qytetarë dhe personat me aftësi të kufizuar,</li> <li>❖ Edukimi e informimi i qytetarëve mbi rregullat e qarkullimit.</li> <li>❖ Garantimin e shërbimit zjarrëfikes ne nivel lokal dhe administrimi i strukturave përkatëse.</li> </ul>
<b>Buxheti 2023</b>	<p>Bashkia Patos financon programin për vitin 2023 me <b>83,956,393 lekë</b>. Ky program zë 15 % të totalit të shpenzimeve.</p>
<b>Njësitë shpenzuese</b>	<p>Bashkia e Patos Drejtoria e Politikave dhe Monitorimit të Shërbimeve.</p>

<b>Programi i Rrugë Rurale Infrastruktura Bashkia</b>	<b>Plani 2022</b>	<b>Plani 2023</b>
<b>Shpenzime Korrente</b>	12,985,614	12,479,048
<b>Shpenzime Kapitale</b>	74,861,727	71,477,345
<b>Total</b>	<b>87,967,941</b>	<b>83,956,393</b>

### **Shpenzimet operative për vitin 2023**

#### **Mirëmbajtja e rrugëve**

Bashkia e Patos nëpërmjet Drejtorisë së Sherbimeve dhe Agjensinë e Shërbimeve Publike, realizon:

- mirëmbajtjen e rrugëve qytetase,
- mirëmbajtjen e sistemit të ndriçimit rrugor të qytetit,
- mirembajtjen e shkollave,

#### **Mirembajtja e rrugëve**

Ky shërbim synon mirëmbajtjen e rrugëve parësore dhe dytësore, trotuareve, mirëmbajtjen e sinjalistikës rrugore,mirëmbatje te shkollave,kopshteve e cerdhes,punime të tjera punime keto që kryehen dhe në bashkëpunim me Agjensinë e Shërbimeve Publike .

#### **Ndriçimi i qytetit, Dekori**

Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit rrugor të qytetit, nëpërmjet blerjes së bazës materiale për ndriçim, duke realizuar:

- Eliminimin e te gjitha dëmtimeve,vjedhjeve që kanë ndodhur në rrjetin e ndriçimit rrugor,
- Përmirësimin e ndriçimit në disa blloqe banimi në qytetin e Patosit,
- Uljen e shpenzimeve për energji elektrike,

- Vazhdimin e projektit për montimin e panelevë te kontrollit te fluksit të ndriçimit në rrugët e qytetit.

**Shpenzimet operative për vitin 2023**

Shpenzimet operative për këtë funksion paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Infrastruktura	Plani 2023	Pesha specifie (%)
1.Shpenzime per dekor	1.000.000	18%
2.Shpronesime: 1)Sistemim rikonstruksioni i ujesjellesit,objekte te reja	4,325,326	82 %
<b>TOTALI</b>	<b>5,325,326</b>	<b>100%</b>

**Shpenzimet kapitale të Programit për vitin 2023:**

Në buxhetin e viti 2023 paraqiten investime me vlerë totale 71,477,345 lekë të pasqyruara sipas fishave të objekteve si më poshtë.

**FISHAT E PROJEKTEVE PËR BUXHETIN 2023-2025**

Projektet:	Ndërhyrjet dhe problematikat:
<b>1. Rehabilitim i shtresave të mbuleses se Pallatit te Kultures</b>	<p>Konsiston ne blerje baze materiale per rehabilitimin e mbuleses se Pallatit te Kultures per eleminimin e lageshtires . Siperfaqja totale e nderhydrjes eshte 160 m<sup>2</sup>. Do te behet nivelimi me shtrese nivelimi (rere e lare+cimento) mbulimi i shtreses se parapetit do te behet me karton katrama me 2 shtresa guajne e ngjitur me gas.</p> <p><b>Perfituesit nga ky projekt jane:</b></p> <p>-Punonjesit ne objektin e pallatit</p> <p><b>Vlera totale e parashikuar per kete projekt: 6,810,00 leke me financim si meposhte:</b></p> <p>-Ne 2023: 5,800,000 leke</p> <p>-Ne 2025: 1,010,000 leke</p> <p><b>Kohezgjatja e Investimit: 2-Vite.</b></p>

<b>2. Rikonstruk. i rruges Dukas Anes Perroit</b>	<p>Ky segment ndodhet ne Dukas, kalon perbri perroit te Dukasit dhe sherben si ure lidhese midis rruges Sotir Xoxe dhe rruges Dhori Tanaka. Gjatesia e ketij segmenti eshte 460 ml dhe ka nje gjeresi prej 4 m. Investimi parashikon ne rikonstruksionin e pote te rruges dhe pajisjen me paketen e pote te shtresa rrugore si cakell, stabilizant dhe binder.</p> <p><b>Perfituesit nga ky projekt jane:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Rreth 800 banore (banoret e zones ku kalon rruga si dhe banoret e 2 zonave qe lidh ky segment.</li> </ul> <p><b>Vlera totale e parashikuar per kete projekt se bashku me mbikqyrje dhe kolaudim:</b> 3,000,000 leke me financim si meposhte:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Ne 2024: 3,000,000 leke</li> </ul> <p><b>Kohezgjatja e Projektit:</b> 1 vit</p>
